



(1) MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

si Autoriteti Kontraktor

dhe

(2)

si Koncesionari

dhe

(3)

si Shoqëria Koncesionare

KONTRATË KONCESIONI

Për

**Projektimin, Ndërtimin, Operimin, Mirëmbajtjen, Rehabilitimin dhe Transferimin
e segmentit rrugor**

“MILOT - BALLDRE”

Kjo draft kontratë do të ndryshohet, me qëllim përshtatjen me ofertën fituese dhe në vijim mund të ndryshohet pas negociatave midis Autoritetit Kontraktues dhe ofertuesit të përzgjedhur si më i suksesshmi si dhe/ose pas mendimit të institucioneve të cilave i përcillet për mendim.

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRSHKRIME PARAPRAKE.....	
KREU 1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME.....	
Neni 1.Përkufizimi i termave.....	
Neni 2.Interpretimi i Kontratës.....	
Neni 3. Objekti i Kontratës.....	
Neni 4.Dhënia e Koncesionit/Ekskluziviteti.....	
Neni 5.Periudha e Koncesionit.....	
Neni 6.Kushtet paraprake.....	
Neni 7.Mospërbushja e kushteve paraprake.....	
Neni 8.Mbyllja Financiare.....	
KREU 2 DEKLARIMET, TË DREJTAT, DETYRIMET E PALËVE.....	
Neni 9.Detyrimet e përgjithshme.....	
Neni 10.E drejta e Nënkontraktimit.....	
Neni 11.Vendshërbimet.....	
Neni 12.E Drejta e Monitorimit nga Autoriteti Kontraktor.....	
Neni 13.E drejta e ndërhyrjes nga Autoritetit Kontraktor.....	
Neni 14.Garancia e Kontratës.....	
Neni 15. Deklarimet e Koncesionarit dhe Shoqërisë Koncesionare.....	
Neni 16. Angazhimet e Shoqërisë Koncesionare.....	
Neni 17. Deklarimet e Autoritetit Kontraktor	
Neni 18. Angazhimet e Autoritetit Kontraktor.....	
Neni 19. Dhënia e Informacionit nga Autoriteti Kontraktor.....	
Neni 20. Bashkëpunimi dhe dokumentacioni.....	
Neni 21. Përfaqësuesit e Palëve.....	
Neni 22. Njësia e Zbatimit të Projektit.....	
KREU 3 PRONËSIA DHE PËRDORIMI I PRONËS.....	
Neni 23.Territori i Projektit.....	
Neni 24.Trulli Shtesë dhe Trulli Ekstra.....	
KREU 4 INXHINIERI I PAVARUR.....	
Neni 25.Përzgjedhja e Inxhinierit të Pavarur.....	

Neni 26.Kontrata me Inxhinierin e Pavarur.....	
Neni 27.Inspektimet e Inxhinierit të Pavarur.....	
Neni 28.Mosdakordësimi me Qëndrimet e Inxhinierit të Pavarur.....	
Neni 29.Zëvendësimi i Inxhinierit të Pavarur.....	
KREU 5 NDËRTIMI, TERRITORI I PUNIMEVE TË PROJEKTIT DHE KUSHTET E TOKËS.....	
Neni 30.Inspektimi i Territorit të Projektit.....	
Neni 31.Objektet arkeologjike ose objektet e trashëgimisë kulturore.....	
Neni 32.Veprimet në përputhje me Ligjin.....	
Neni 33.Lejet ekzistuese dhe Miratimet e Nevojshme të Autoritetit Kontraktor.....	
Neni 34.Dokumentacioni i Projektit.....	
Neni 35.Ndërtimi.....	
Neni 36.Rrethana të veçanta gjatë fazës së ndërtimit, zgjatja e afatit të përfundimit të punimeve.....	
Neni 37.Materiallet e Rrezikshme.....	
Neni 38.Rrjetet e infrastrukturës publike.....	
Neni 39.Miratimet e nevojshme.....	
Neni 40.Menaxhimi i cilësisë.....	
Neni 41.Kontrolli i cilësisë.....	
Neni 42.Bashkërendimi i projektimit, ndërtimit dhe sigurisë.....	
Neni 43.Përfundimi i Punimeve/Segmenteve.....	
Neni 44.Dorëzimi teknik.....	
Neni 45.Marrja e Certifikatës së Përfundimit.....	
Neni 46.Marrja e Certifikatave të Përdorimit.....	
Neni 47.Përgjegjësia për Defektet.....	
Neni 48.Procedura për riparimin e Defekteve.....	
KREU 6 NDRYSHIMET.....	
Neni 49.Ndryshime të Kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.....	
Neni 50.Ndryshime të kërkuara nga Shoqëria Koncesionare.....	
KREU 7 SHËRBIMET E OPERIMIT.....	
Neni 51.Shërbimi i Operimit.....	
Neni 52.Data e fillimit të Operimit nga Shoqëria Koncesionare.....	

Neni 53.Ndërtimi i Shesheve të Tarifës dhe Qendrës së Operimit dhe Krijimi mirëmbajtja e Infrastrukturës së Monitorimit, Koordinimit të Shërbimit të Operimit.....	
Neni 54.Monitorimi, Koordinimi i Shërbimit të Operimit nga Enti Kombëtar i Operimit Rrugor	
Neni 55.Ushtrimi i Shërbimit të Operimit nga Shoqëria Koncesionare.....	
Neni 56.Procedurat e Bashkërendimit të Operimit.....	
Neni 57.Plani i Operimit të Rrugës.....	
Neni 58.Përputhshmëria me Procedurat dhe Planin e Operimit.....	
Neni 59.Përgjegjësia mbi Infrastrukturën e Operimit.....	
KREU 8 SHËRBIMET E MIRËMBAJTJES.....	
Neni 60.Përgjegjësia për Mirëmbajtjen.....	
Neni 61.Mirëmbajtja, përgatitja e Planit, Periudha e Mirëmbajtjes.....	
Neni 62.Procedurat e bashkërendimit të mirëmbajtjes.....	
Neni 63.Ndryshimet në Manualin e Mirëmbajtjes dhe/ ose Planin e Mirëmbajtjes së Rrugës.....	
Neni 64.Qendra e Mirëmbajtjes.....	
Neni 65.Detyrimet e Shoqërisë Koncesionare në kuadër të Mirëmbajtjes.....	
KREU 9 NDËRHYRJET URGJENTE.....	
Neni 66.Ndërhyrjet Urgjente të Shoqërisë Koncesionare.....	
Neni 67.Kostot në lidhje me Ndërhyrjet Urgjente.....	
Neni 68.Shërbime shtesë dhe alternative.....	
Neni 69.Kostot e lidhura me shërbimet shtesë.....	
KREU 10 TARIFA.....	
Neni 70.E drejta për Tarifën.....	
Neni 71.Vjelja e të ardhurave nga Tarifa.....	
Neni 72.Shkalla e Tarifës.....	
Neni 73.Klasifikimi i Automjeteve.....	
Neni 74.Metoda e pagesës së Tarifës nga Përdoruesit, TVSH-ja.....	
Neni 75.Regjistrimi i informacionit për Tarifat.....	
Neni 76.Përdoruesit e përjashtuar.....	
Neni 77.E drejta për të nxjerrë të Ardhura Shtesë.....	
Neni 78.Evazioni i Tarifës.....	
KREU 11 NGJARJE TË VEÇANTA.....	

Neni 79. Forca Madhore.....	
Neni 80. Shkaku i Lehtësimit.....	
Neni 81. Veprimi Shtetëror Thelbësisht në Kundëstim me Kontratën.....	
Neni 82. Ndryshimet në Ligj.....	
Neni 83. Efektet e Ndryshimit Cilësues në Ligj.....	
KREU 12 PËRGJEGJËSIA, PENALITETET, PALËT E TRETA.....	
Neni 84. Përgjegjësi solidare.....	
Neni 85. Penalitetet.....	
Neni 86. Dëmshpërblimi ndaj Autoritetit Kontraktor në lidhje me Palët e Treta.....	
KREU 13 SIGURIMET.....	
Neni 87. Sigurimet.....	
Neni 88. Kushtet dhe afatet e Sigurimeve.....	
Neni 89. Dokumentacioni lidhur me Sigurimet.....	
Neni 90. Risku i Pasigurueshëm.....	
Neni 91. Mosblerja dhe mosmbajtja e Sigurimeve.....	
Neni 92. Përdorimi i të ardhurave nga Sigurimet.....	
KREU 14 TRANSFERIMI I OBJEKTIT TË KONTRATËS.....	
Neni 93. Procedura për transferimin në fund të Periudhës së Koncesionit.....	
Neni 94. Transferimi i parakohshëm.....	
Neni 95. Të drejtat pas transferimit.....	
KREU 15 ZGJIDHJA E PARAKOHSHME E KONTRATËS.....	
Neni 96. Zgjidhja e parakohshme.....	
Neni 97. Zgjidhja e Kontratës si pasojë e Mospërmbushjes së Detyrimeve nga Shoqëria Koncesionare.....	
Neni 98. Zgjidhja e Kontratës si pasojë e Mospërmbushjes së Detyrimeve nga Autoriteti Kontraktor.....	
Neni 99. Zgjidhja e Kontratës për shkak të Ngjarjes së Forcës Madhore.....	
Neni 100. Njoftimi i zgjidhjes së Kontratës.....	
Neni 101. Zgjidhja e Kontratës me konsensus.....	
KREU 16 KOMPENSIMI PËR ZGJIDHJEN E KONTRATËS.....	
Neni 102. Të përgjithshme.....	
Neni 103. Kompensimi për zgjidhje të Kontratës për Mospërmbushje të Shoqërisë Koncesionare.....	

Neni 104. Kompensimi i zgjidhjes së Kontratës për shkak Mospërmbushjeje nga ana e Autoritetit Kontraktor.....	
Neni 105. Kompensimi i zgjidhjes së Kontratës për Shkak të Ngjarjes së Forcës Madhore....	
KREU 17 PAGESAT.....	
Neni 106. Pagesa për Rakordimin e të Ardhurave Vjetore nga Tarifa.....	
Neni 107. Pasqyrat vjetore të pagesave.....	
Neni 108. Pagesat Vjetore.....	
Neni 109. Kërkesa për Pagesë për Kompensim nga Zgjidhja e Kontratës.....	
Neni 110. Informacioni i kërkuar për përcaktimin e shumës së kompensimit për Zgjidhjen e Kontratës.....	
Neni 111. Modalitetet e pagesës së Kompensimit për Zgjidhjen e Kontratës.....	
Neni 112. Tatimi mbi vlerën e shtuar.....	
Neni 113. Pagesa e Plotë.....	
Neni 114. Monedha e kryerjes së Pagesave.....	
Neni 115. Shumat e kundërshtuara.....	
Neni 116. Përgjigjja e Shoqërisë Koncesionare në lidhje me shumat e kundërshtuara.....	
Neni 117. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në lidhje me Pagesat.....	
KREU 18 TRANSFERIMET.....	
Neni 118. Transferimi i Kontratës nga Shoqëria Koncesionare.....	
Neni 119. Transferimi i Kontratës nga Autoriteti Kontraktor.....	
Neni 120. Transferimi i kuotave të Shoqërisë Koncesionare.....	
Neni 121. Krijimi i Barrëve Siguruese.....	
Neni 122. E Drejta e Zëvendësimit nga Huadhënësit.....	
Neni 123. Kushtet e Zëvendësimit.....	
Neni 124. Koha e Zëvendësimit.....	
KREU 19 DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE.....	
Neni 125. Konfidencialiteti.....	
Neni 126. Të dhënat e shoqërisë koncesionare.....	
Neni 127. Miratimi në Heshtje nga Autoriteti Kontraktor.....	
Neni 128. Njoftimet.....	
Neni 129. Pavlefshmëria e pjesshme.....	

Neni 130. Mbrojtja e të dhënave.....	
Neni 131. Ligji rregullues.....	
Neni 132. Përshkallëzimi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve.....	
Neni 133. Amendamentet e Kontratës.....	
Neni 134. Kostot dhe shpenzimet e palëve.....	
Neni 135. Konflikti i Kontratës kundrejt marrëveshjeve të tjera.....	
Neni 136. Heqja dore nga imuniteti.....	
Neni 137. Vlefshmëria e kësaj Kontrate.....	
Neni 138. Kontrata e Plotë.....	
Neni 139. Pamundësia e heqjes dorë nga Kontrata.....	
Neni 140. Regjistrimi i Kontratës.....	
Neni 141. Gjuha dhe numri i kopjeve të Kontratës.....	
PALËT.....	

SHTOJCA 1	Sigurimet
SHTOJCA 2	Dispozita të Marrëveshjes së Monitorimit Koordinimit të Shërbimit të Operimit
SHTOJCA 3	Lista e miratuar e përdoruesve të përjashtuar
SHTOJCA 4	Pagesat e Autoritetit Kontraktor gjatë periudhës së Garancisë.
SHTOJCA 4/1	Pagesat e Suficitit të të Ardhurave nga Shoqëria Koncesionare
SHTOJCA 5	Detyrat Kryesore të Inxhinierit të Pavarur
SHTOJCA 6.	Pasqyra e Aktiviteteve të Shërbimit të Mirëmbajtjes
SHTOJCA 7	Informacioni i kërkuar rreth Koncesionarit
SHTOJCA 8	Dokumentacioni i Ofertës
SHTOJCA 9	Të Dhënat e Vëna në Dispozicion nga Autoriteti Kontraktor
SHTOJCA 10	Projekt-Ideja, skicat, planimetritë, dhe Grafiku i Punimeve
SHTOJCA 11	Territori i Projektit
SHTOJCA 12	Garancia e Kontratës

KONTRATË PËR DHËNIEN ME KONCESION PËR PROJEKTIMIN, NDËRTIMIN, OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN, REHABILITIMIN DHE TRANSFERIMIN E SEGMENTIT RRUGOR MILOT - BALLDRE

PALET:

1- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si ministria përgjegjëse për infrastrukturën (në vijim “**Autoriteti Kontraktor**”), përfaqësuar nga _____; dhe

2- _____ (në vijim “**Koncesionari**”)

_____ shoqëri e themeluar sipas Ligjit, me seli në : _____, dhe adresë kryesore në: _____ me NUIS _____, përfaqësuar nga _____, identifikuar me Leternjoftimin Nr. _____, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar; si dhe

3- _____, shoqëria e themeluar sipas Ligjit për realizimin e këtij projekti, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS _____, me adresë _____, përfaqësuar nga _____, identifikuar me Leternjoftim Nr. _____, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

(në vijim “**Shoqëria Koncesionare**”);

Autoriteti Kontraktor, Koncesionari dhe Shoqëria Koncesionare do të referohen në këtë Kontratë secili si “**Pala**” dhe së bashku “**Palët**”, sipas varianteve të tyre gjuhësore në njëjës ose në shumës, siç mund ta kërkojë herë pas here konteksti i kësaj Kontrate.

PËRSHKRIME PARAPRAKE

MEQENËSE, në bazë të Ligjit me Nr. 125/2013 “*Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat*” të ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 575 datë 10.07.2013 “*Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me Koncesion/Partneritet Publik Privat*” të ndryshuar; dhe dokumentacionit të tenderit, të datës _____, Autoriteti Kontraktor ftoi ofertuesit për të paraqitur ofertat e tyre për Projektimin, Ndërtimin, Operimin, Mirëmbajtjen, Rehabilitimin dhe Transferimin e Segmentit Rrugor Milot -Balldre;

MEQENËSE, si rrjedhojë e vlerësimeve të Autoriteti Kontraktor ky i fundit vendosi që Koncesionari është ofertuesi më i mirë dhe përzgjidhet për të realizuar Projektin sipas kushteve të dakordësuara mes Palëve;

ATËHERË, Palët bien dakord që në këtë Kontratë pasqyrohen të drejtat dhe detyrimet reciproke në lidhje me dhënien me koncesion të Objektivit (siç përkufizohet më poshtë).

KREU 1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1. Përkufizimi i termave

“Afati i Paraqitjes së Pasqyrave Vjetore të Pagesave” ka kuptimin që i është dhënë te Neni Neni 107 (*Pasqyrat Vjetore të Pagesave*) i kësaj Kontrate.

“ASHK” është aktualisht Agjencia Shtetërore e Kadastrës si institucioni publik që organizohet dhe funksionon në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 111/2018 *“Për Kadastrën”*, i ndryshuar, ose çdo institucion që e zëvendëson atë në të ardhmen.

“Autoritet Kontraktor” është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, apo në rast riorganizimi, ministria përgjegjëse për infrastrukturën.

“Autoritet Përkatës” janë entet, agjencitë, autoritetet, organizmat ose Personat shtetërorë, bashkiakë, kombëtarë, rajonalë ose vendorë që ushtrojnë aktivitet në Republikën e Shqipërisë dhe/ose kanë juridiksion dhe kompetencë për të ushtruar tagrat zyrtarë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

“Banka” ka kuptimin e një banke të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë, e përzgjedhur nga palët e Marrëveshjes së Monitorimit dhe Koordinimit të Përbashkët (MMKP) referuar shërbimit të Operimit, në përputhje me parashikimet e Marrëveshjes.

“Borxh i Pasiguruar” ka kuptimin e kredisë apo huamarrjes, që nuk është mbuluar me kolateral, që i jepet Shoqërisë Koncesionare nga Huadhënësit.

“Braktisje” ka kuptimin e (i) ndërprerjes së Punimeve të parashikuara në Kontratë, përgjatë një periudhe prej 3 (tre) muaj të njëpasnjëshme, (ii) mosfillimit të Punimeve brenda 3 (tre) muaj pas përfundimit të një Ngjarjeje të Forcës Madhore, për sa kohë Kontrata nuk është zgjidhur në përputhje me dispozitat e Neni 99 (Zgjidhja e Kontratës për shkak të Ngjarjes së Forcës Madhore). Data e Braktisjes do të konsiderohet data në të cilën është marrë njoftimi nga Shoqëria Koncesionare për rastet si më sipër. Në rast se Shoqëria Koncesionare nuk njofton Autoritetin Kontraktor për rastet si më sipër datë e braktisjes do të konsiderohet data e konstatimit nga Autoriteti Kontraktor të ndërprerjes apo mosfillimit të këtyre Punimeve Dështimi për të kryer Punimet ose një pjesë të Punimeve brenda afateve të përcaktuara në Kontratë, për shkak të veprimeve ose mosveprimeve të Autoritetit Kontraktor apo gjatë një Ngjarjeje të Forcës Madhore, nuk do të konsiderohet si Braktisje.

“Çertifikatat e Përdorimit” janë një dokument zyrtar i lëshuar nga autoriteti përgjegjës në miratim të kërkesës nga Koncesionari apo Shoqëria Koncesionare, i cili vërteton se ndërtimi i Veprës apo një pjese të saj, është në përputhje me kushtet e lejes së ndërtimit dhe se punimet e kryera dhe ndërtimi janë të përshtatshme për përdorim.

“Çertifikata e Përfundimit” është një dokument zyrtar, (përfshirë certifikatat apo vërtetimet paraprake), që vërteton mundësinë e përdorimit nga automjetet të Veprës apo Segment të saj, të lëshuara sipas parashikimeve të bëra te Neni 45 (*Marrja e Certifikatës së Përfundimit*) i kësaj Kontrate.

“Data e Fillimit të Operimit të Shoqërisë Koncesionare” ka kuptimin e dhënë te Neni 52 (*Data*

e Fillimit të Operimit nga Shoqëria Koncesionare) i kësaj Kontrate.

“Data e Fillimit të Punimeve” është data kur Shoqëria Koncesionare njofton Autoritetin Kontraktor për fillimin e Punimeve në zbatim të kësaj Kontrate.

“Data e Hyrjes në Fuqi” ka kuptimin e dhënë te Neni 6 (*Kushtet Paraprake*).

“Data e Nënshkrimit” do të jetë data e nënshkrimit të kësaj Kontrate.

“Data e Përfundimit të Kontratës” është data në të cilën vërtetohet e para një nga ngjarjet e mëposhtme:

1. Data e fundit e mbarimit të Periudhës së Koncesionit; ose
2. Data e Përfundimit të kësaj Kontrate e përcaktuar në përputhje me parashikimet e bëra te KREU 15 (*Zgjidhja e Parakohshme e Kontratës*) i kësaj Kontrate.

“Data e Përfundimit të Punimeve” është data në të cilën do të lëshohet Certifikata e Përfundimit për ndërtimin e Veprës .

“Defekt” është një defekt i Rrugës që vjen si rezultat i mospërbushjes me faj të detyrimeve të Shoqërisë Koncesionare në lidhje me Standardet.

“Dëm” do të thotë Humbje Direkte dhe Fitimi i Munguar.

“Ditë Pune” është çdo ditë jave pa përfshirë të shtunën, të dielën dhe ditët e festave zyrtare në Republikën e Shqipërisë.

“Ditë” është çdo ditë kalendarike.

“Dokumentacioni i Ofertës” është dokumentacioni që Koncesionari ka paraqitur si pjesë e ofertës gjatë procedurës konkurruese të Autoritetit Kontraktor të datës _____ në lidhje me projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen, rehabilitimin dhe transferimin e Rrugës “Milot – Balldre”.

“Dokumentacioni i Projektit” ka kuptimin e dhënë te Neni 34 (*Dokumentacioni i Projektit*) i kësaj Kontrate.

“Dokumentacioni i Tenderit” janë dokumentat e procedurës konkurruese të hartuara nga Autoriteti Kontraktor në lidhje me projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen, rehabilitimin dhe transferimin e Rrugës “Milot – Balldre”, të publikuara në faqen elektronike të Agjencisë së Prokurimit Publik.

“Dorëzimi i Territorit të Projektit” do të thotë dorëzimi i Territorit të Projektit nga Autoriteti Kontraktor te Shoqëria Koncesionare, në çdo rast të çliruar nga (i) të gjitha pengesat për të kryer Punimet, përfshirë shpronësimet dhe Shembjen e Objekteve si dhe largimin e Personave prej tyre dhe prej Territorit të Projektit apo (ii) nga të gjitha pretendimet e Palëve të Treta.

“EKORR” është Enti Kombëtar i Operimit Rrugor, shoqëri aksionare, me kapital 100 (njëqind)% shtetëror që organizohet dhe funksionon në përputhje me parashikimet e VKM Nr. 684,

datë 6.11.2024 “Për krijimin e shoqërisë aksionare “Enti Kombëtar i Operimit Rrugor”sha”.

“**Euro**” është monedha e ligjshme e Bashkimit Ekonomik dhe Monetar Europian, apo çdo monedhë tjetër me të cilën Bashkimi Ekonomik dhe Monetar Europian mund ta zëvendësojë atë.

“**Evazion Tarife**” është kalimi i Përdoruesit nëpër Sheshin e Tarifës pa paguar Tarifën përkatëse me mjete të pranueshme pagese.

“**Garancia e Kontratës**” ka kuptimin që i jepet te Neni 14 (*Garancia e Kontratës*) i kësaj Kontrate.

“**Gëzim i Qetë**” do të thotë e drejta ekskluzive për të përdorur dhe gëzuar Sheshin dhe/ose Veprën (duke përfshirë objektet ekzistuese) dhe e drejta për të kaluar mbi dhe nën Shesh, dhe në çdo pjesë të tij, si dhe për të hyrë dhe për të dalë në të, me qëllim zbatimin e kësaj Kontrate, gjatë afatit, pa ndërhyrje të pajustificuar nga Autoriteti Kontraktor ose nga ndonjë Autoritet Përkatës.

“**Grafiku i Punimeve**” është kalendari i detajuar i Punimeve për tu realizuar nga Shoqëria Koncesionare, që i bashkëlidhet kësaj Kontrate si Shtojca 10 (*Projekt-Ideja, skicat, planimetritë dhe Grafiku i Punimeve*), dhe ndryshimet e miratuara në Lejen e Ndërtimit, nëse ka.

“**Huadhënës**” janë institucione krediti ose financiare ose organizma të tjerë të ngjashëm financiarë të angazhuar profesionalisht në dhënien hua të parave, që mund të jenë palë në Marrëveshjet për Financimin, ose mund të kenë të drejta në bazë të Marrëveshjeve për Financimin, dhe/ose i japin Shoqërisë Koncesionare financim në formë linje financimi me obligacione, borxhi me përparësi ose borxhi me të drejtë kthimi në kapital apo të ngjashëm (dhe marrëveshje mbrojtëse “hedging”) në përputhje me Marrëveshje të tilla për Financimin dhe do të përfshijnë edhe siguruesit që lëshojnë dorëzani apo sigurime të ngjashme për këto linja financimi apo Palë të Treta që bien dakord të kryejnë Punime pa pagesë, me kusht që shuma e papaguar t’u kthehet në borxh apo Persona që blejnë dhe zotërojnë obligacione për të financuar Projektin.

“**Humbje Direkte**” do të thotë:

a) për Shoqërinë Koncesionare:

çdo humbje e të ardhurave, ose dëm tjetër efektiv që vjen si rezultat i shkeljes ose mospërbushjes së detyrimeve të kësaj Kontrate nga Autoriteti Kontraktor ose nga një Veprim Shtetëror Thelbësisht në Kundërshtim me Kontratën dhe/ose çdo kosto shtesë e shkaktuar si rezultat i shkeljes ose mospërbushjes së detyrimeve të kësaj Kontrate nga Autoriteti Kontraktor ose nga Veprimi Shtetëror Thelbësisht në Kundërshtim me Kontratën; dhe

çdo humbje apo dëm i pësuar nga Shoqëria Koncesionare si rezultat i dëmtimeve të pronës apo dëmtimeve personale;

b) për Autoritetin Kontraktues çdo humbje ose dëm i pësuar si rezultat i dëmtimit të pronës apo dëmtimeve personale si dhe çdo kosto shtesë e shkaktuar si rezultat i shkeljes ose mospërbushjes së detyrimeve të kësaj Kontrate nga Shoqëria Koncesionare.

“**Identifikimi i Objekteve për Shpronësim**” do të thotë përpilimi dhe dorëzimi në Autoritetin Përkatës për Shpronësimin (ASHSH) nga Shoqëria Koncesionare të: (i) një liste të pronave dhe

pronarëve të tyre brenda Territorit të Projektit, të cilat në Datën e Nënshkrimit ndodhen të regjistruara në ASHK dhe që duhen Shpronësuar nga Autoriteti Përkatës për Shpronësimin, (ii) i një liste të objekteve të paregjistruara në ASHK dhe që duhen prishur nga Autoritetit Përkates si pjesë e Dorëzimit të Territorit të Projektit, si dhe (iii) kërkesën për Shpronësim, e cila duhet të shoqërohet me dokumentacionin përkatës sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999 *“Per shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”*, i ndryshuar.

“Infrastruktura e Operimit” ka kuptimin që i jepet te Neni 51 (*Shërbimi i Operimit*) i kësaj Kontrate.

“Infrastrukturë e Paparashikuar Publike” ka kuptimin që i jepet te Neni 38 (*Rrjetet e Infrastrukturës Publike*) i kësaj Kontrate.

“Inxhinieri i Pavarur” është Personi ose Personat e pavarur me përvojë, të huaj dhe/ose shqiptarë, të cilët kontraktohen nga Autoriteti Kontraktor, në përputhje me këtë Kontratë, për të mbikëqyrur ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e Veprës, segmentit rrugor Milot-Balldre në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate dhe të Kontratës me Inxhinierin e Pavarur dhe të cilët kryejnë detyrat e Inxhinierit të Pavarur në aspektin teknik, ligjor, ekonomiko-financiar, në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate dhe të Kontratës me Inxhinierin e Pavarur. Detyrat kryesore të Inxhinierit të Pavarur jepen të renditura në Shtojcën 5 (*Detyrat Kryesore të Inxhinierit të Pavarur*) të Kontratës.

“Indeksi i çmimeve në Euro” është indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit i Eurozonës (me përbërje të ndryshueshme), publikuar nga Eurostat-i ose nëse ky indeks nuk publikohet më, çdo indeks tjetër i harmonizuar i çmimeve të konsumit i Eurozonës që e zëvendëson këtë indeks.

“Indeksi i çmimeve të konsumit në lekë” është indeksi i çmimeve të konsumit për Shqipërinë, i publikuar nga Instituti i Statistikave i Shqipërisë.

“Indeksi i çmimeve të prodhimit i BE-së” është indeksi i çmimeve të prodhimit industrial publikuar nga Eurostat-i ose, nëse ky indeks nuk publikohet më, çdo indeks tjetër që e zëvendëson këtë indeks të kostove industriale të prodhimit të BE-së.

“Kapital i Investuar” janë shumat që Ortakët e Koncesionarit apo Shoqërisë Koncesionare i investojnë në funksion të përmbushjes së kësaj Kontrate si Kapital Neto.

“Kapital Neto” është kapitali i Shoqërisë Koncesionare, përfshirë të gjitha vlerat monetare/të pagueshme si rezultat i nënshkrimit/pagimit të kuotave/aksioneve, nga kontributet e dhëna nga Ortakët e tij, Shoqëritë e Lidhura ose kontrolluese të Shoqërisë Koncesionare (drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë), të cilat nuk rezultojnë si borxh i paguar, si dhe të gjitha asetet e Shoqërisë Koncesionare.

“Kërkesa për Pagesë” ka kuptimin e dhënë te Neni 109 (*Kërkesa për Pagesë për Kompensim nga Zgjidhja e Kontratës*) i kësaj Kontrate.

“Kohëzgjatja e Kontratës” është periudha kohore që fillon me Datën e Hyrjes në Fuqi të Kontratës dhe përfundon me Datën e Përfundimit të Kontratës.

“Kompensimi për Evazion Tarife” është shuma e barabartë me shumën që Përdoruesi që ka kryer një Evazion Tarife do të duhej të paguante në përputhje me Shkallët e Tarifës të zbatueshme në momentin e Evazionit të Tarifës.

“Kompensimi i Zgjidhjes së Kontratës” do të thotë sipas kontekstit, veç e veç ose së bashku, Kompensimi i Zgjidhjes së Kontratës për Shkak të Mospërmbushjes nga Autoriteti Kontraktor, Kompensimi i Zgjidhjes së Kontratës për Shkak të Mospërmbushjes nga Shoqëria Koncesionare, dhe/ose Kompensimi për Zgjidhje të Kontratës për Shkak të Ngjarjes së Forcës Madhore.

“Kompensimi i Zgjidhjes së Kontratës për Shkak të Mospërmbushjes nga Autoriteti Kontraktor” ka kuptimin e dhënë te Neni 104.1 (*Kompensim i Zgjidhjes së Kontratës për Shkak të Mospërmbushjes nga Autoriteti Kontraktor*) i kësaj Kontrate.

“Kompensimi i Zgjidhjes së Kontratës për Shkak të Mospërmbushjes nga Shoqëria Koncesionare” ka kuptimin e dhënë te Neni 103 (*Kompensimi për Zgjidhje të Kontratës për Mospërmbushje të Shoqërisë Koncesionare*) i kësaj Kontrate.

“Kompensimi për Zgjidhje të Kontratës për Shkak të Ngjarjes së Forcës Madhore” ka kuptimin e dhënë te Neni 105 (*Kompensimi i Zgjidhjes së Kontratës për shkak të Ngjarjes së Forcës Madhore*) i kësaj Kontrate.

“Koncesionari” ka kuptimin e dhënë në hyrje të kësaj Kontrate.

“Kontrata e Inxhinierit të Pavarur” është kontrata e lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të Pavarur, në lidhje me realizimin e detyrave të Inxhinierit të Pavarur për mbikëqyrjen dhe kontrollin e Punimeve të ndërtimit, mirëmbajtjes dhe rehabilitimit të Rrugës në përputhje me këtë Kontratë.

“Kontrata” është kjo kontratë koncesioni dhe Shtojcat e saj.

“Kontroll” i një Personi nga një Person tjetër është kur ky Person i fundit (i vetëm ose me të tjerë dhe drejtpërdrejt tërthorazi) ka shumicën e kapitalit të Personit të parë ose nëpërmjet zotërimit të kapitalit aksione/kuotave ose ka shumicën e votave apo ka të drejtën e përcaktimit të vendimmarrjes te Personi i parë, apo çdo të drejtë tjetër që ka ose mund të ketë apo sjell të njëjtën pasojë si secili rast sa më lart.

“Korridor” ka kuptimin e segmenteve rrugore të parashikuara për t’u ndërtuar në Territorin e Republikës së Shqipërisë në bazë të kontratave koncesionare ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe shoqërive të shpallura fituese në procedurat konkurruese të organizuara për këtë qëllim, të cilat koordinohen dhe monitorohen referuar Shërbimit të Operimit nga Enti i Kombëtar i Operimit Rrugor.

“Lek” është monedha zyrtare e Republikës së Shqipërisë, siç ajo mund të ndryshojë në bazë të Ligjit.

“Leje Ndërtimi” është akti i miratimit të kërkesës për leje ndërtimi dhe lejimit të punimeve përkatëse i lëshuar nga Autoriteti Përkatës në përputhje me Ligjin Nr. 107/2014 *“Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”* i ndryshuar, për zhvillimin dhe ndërtimin e të gjithë Projektit në tërësi dhe në çdo fazë të tij, ashtu siç përcaktohet në Projektin e Zbatimit.

“Ligj” është çdo akt i zbatueshëm pavarësisht organit që e miraton atë, kombëtar ose vendor, ligj, marrëveshje, konventë, urdhëresë, dekret ose akt tjetër, rregullore, akt nënligjor ose çdo rregull, kod ose udhëzim apo licensë, miratim, leje, autorizim ose aprovim tjetër i Republikës së Shqipërisë ose i çdo entiteti ose nënndarjeje të saj, ose të një Personi i krijuar me Ligj (i pavarur ose jo), që ka juridiksionin e duhur, në masën që një akt i tillë është publikuar dhe që disponohet publikisht, dhe që është objekt i zbatimit të vendimeve të gjykatave të ndryshme dhe të trupave të ngjashme gjyqësorë të Republikës së Shqipërisë, të urdhrave, udhëzimeve a vendimeve të ministrave, të udhëzimeve a qarkoreve të departamenteve të ndryshme të Autoriteteve Përkatëse, si dhe interpretimet e organeve zyrtare të Republikës së Shqipërisë, që kanë juridiksion mbi çështjen në fjalë, siç mund të ndryshohen hera-herës gjatë afatit të Kontratës.

“Lista e Përdoruesve të Përfashtuar” ka kuptimin e listës bashkëngjitur si Shtojca 3 (*Lista e Përdoruesve të Përfashtuar*) e kësaj Kontrate.

“Llogari Escrow” ka kuptimin e llogarisë të llojit escrow të administruar nga Banka, në të cilën palët e Marrëveshjes së Monitorimit dhe Koordinimit të Përbashkët, referuar Shërbimit të Operimit do të depozitojnë të Ardhurat e mbledhura nga Tarifa.

“Manuallet e Mirëmbajtjes” ka kuptimin e manualit të mirëmbajtjes së Rrugës sipas Shtojcës 8 (*Dokumentacioni i Ofertës*).

“Marrëveshje e Drejtpërdrejtë” është marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor, Koncesionarit, Shoqërisë Koncesionare dhe Huadhënësve.

“Marrëveshja e Monitorimit Koordinimit të Përbashkët, referuar Shërbimit të Operimit” ka kuptimin e dhënë të Neni 54 (*Monitorimi, Koordinimi i Shërbimit të Operimit nga Enti Kombëtar i Operimit Rrugor*) i kësaj Kontrate.

“Marrëveshje Financimi” janë çdo marrëveshje huaje, premtim-pagesë, obligacion, marrëveshje sigurimi apo titujsh, hipotekat, marrëveshjet e kredive, nota ose marrëveshjet për blerje obligacionesh, marrëveshje pjesëmarrjeje, Marrëveshja e Drejtpërdrejtë, si dhe çdo dokument tjetër në lidhje me financimin e projektimit, ndërtimit, operimit, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e Projektit të Rrugës, për ushtrimin e të drejtave të koncesionit, përfshirë çdo ndryshim, shtesë, zgjatje kohore dhe zëvendësim për financime të tilla, dhe çdo marrëveshje mbrojtjeje “hedging” për interesin, në përputhje me Modelin Financiar sipas rastit.

“Materiale të Rrezikshme” ka kuptimin që i jepet të Neni 37 (*Materialet e Rrezikshme*) i kësaj Kontrate.

“Mbyllja Financiare” është data kur Shoqëria Koncesionare i konfirmon me shkrim Autoritetit Kontraktor që ka siguruar mbështetjen financiare nga Huadhënësit, apo Palët Financuese, apo që ka fondet e nevojshme për realizimin e Projektit.

“Miratim i Nevojshëm” është çdo Certifikatë Përdorimi, miratim, licensë, aprovim, lejim ose autorizim, i përkohshëm apo përfundimtar, që është i nevojshëm në lidhje me Projektin dhe që duhet lëshuar nga Autoriteti Përkatës, duke përfashtuar Miratimin e Nevojshëm nga Autoriteti Kontraktor.

“Miratimi i Nevojshëm i Autoritetit Kontraktor” është çdo Certifikatë Përfundimi, miratim, licensë, aprovim, lejim ose autorizim, i përkohshëm apo përfundimtar, që është i nevojshëm në lidhje me Projektin dhe që duhet lëshuar nga Autoriteti Kontraktor, duke përjashtuar Miratimin e Nevojshëm.

“Mirëmbajtja Dimërore” janë Punimet e mirëmbajtjes në lidhje me parandalimin e formimit të akullit dhe largimin e dëborës dhe të akullit, sipas specifikimeve të detajuara në Shtojcës 8 (Dokumentacioni i Ofertës).

“Mirëmbajtje Rutinë” janë Punimet e mirëmbajtjes gjatë Periudhës së Operimit, e përcaktuar në Projekt-Zbatim, vlera e të cilave do jetë e indeksuar çdo vit, në përputhje me formulën në nenin 72.2 të kësaj kontrate. Punimet e mirëmbajtjes rutine kanë natyrë afatshkurtër ose ciklike dhe janë të nevojshme për ta mbajtur Rugën në gjendje funksionale, të mirë dhe të parrezikshme pune, ku përfshihen riparimet e vogla të të gjitha elementeve të Rugës, pastrimi, mirëmbajtja e zonës përreth dhe kontrollet e kryera së bashku me vrojtimet që shoqërojnë çdo punim sa më lart sipas specifikimeve të detajuara në Shtojcën 6 (Pasqyra e Aktiveve të Shërbimit të Mirëmbajtjes).

“Modeli Financiar” është në Datën e Nënshkrimit, modeli financiar i paraqitur në Dokumentacionin e Ofertës të Koncesionarit dhe pas Datës së Nënshkrimit, modeli financiar i përditësuar në përputhje me këtë Kontratë.

“Mospërbushje nga Autoriteti Kontraktor” ka kuptimin e dhënë te Neni 98.1 (*Zgjidhja e Kontratës si Pasojë e Mospërbushjes së Detyrimeve nga Autoriteti Kontraktor*) i kësaj Kontrate.

“Mospërbushje nga Shoqëria Koncesionare” ka kuptimin e dhënë te Neni 97.1 (*Zgjidhja si Pasojë e Mospërbushjes së Detyrimeve nga Shoqëria Koncesionare*) i kësaj Kontrate.

“Muaj” është një muaj kalendarik gjatë Periudhës së Koncesionit. Një “Muaj” i referohet një periudhe që fillon në një ditë të një Muaji kalendarik dhe që përfundon në ditën që korrespondon numerikisht në Muajin e ardhshëm kalendarik (pa e përfshirë atë ditë), me përjashtim të rastit që, nëse nuk ka ditë që korrespondon numerikisht në Muajin në të cilin ajo periudhë përfundon, ajo periudhë do të përfundojë ditën e fundit në atë Muaj kalendarik.

“Ndërhyrje/t Urgjente” kanë kuptimin e dhënë te Neni 66 (*Ndërhyrjet Urgjente të Shoqërisë Koncesionare*) i kësaj Kontrate.

“Ndryshim Cilësues i Ligjit” ka kuptimin e dhënë te Neni 82.2 (*Ndryshimet në Ligj*) i kësaj Kontrate.

“Ndryshim Diskriminues i Ligjit” ka kuptimin e dhënë te Neni 82.3 (*Ndryshimet në Ligj*) i kësaj Kontrate.

“Ndryshim në Ligj” është ndryshimi i Ligjit që ndodh pas datës së nënshkrimit të kësaj Kontrate.

“Ndryshim i Kërkuar nga Autoriteti Kontraktor” është ndryshimi i kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në bazë të parashikimeve të bëra te Neni 49 (*Ndryshime të Kërkuara nga Autoriteti Kontraktor*) i kësaj Kontrate.

“Ndryshim Specifik i Ligjit” ka kuptimin e dhënë te Neni 82.4 (*Ndryshimet në Ligj*) i kësaj Kontrate.

“Nënkontraktor” ka kuptimin e Nënkontraktorit të Mirëmbajtjes, Nënkontraktorit Ndërtimor dhe çdo nënkontraktor tjetër me të cilin lidhet një nënkontratë për realizimin e Projektit.

“Nënkontraktori i Mirëmbajtjes” është një subjekt i regjistruar sipas Ligjit, me seli në adresën e deklaruar në QKB dhe i përfaqësuar nga administratori apo përfaqësuesi i tij ligjor, si përfaqësues i caktuar dhe autorizuar rregullisht në bazë të një Nënkontrate Mirëmbajtjeje.

“Nënkontraktori Ndërtimor” është një subjekt i regjistruar sipas Ligjit, me seli në adresën e deklaruar në QKB dhe i përfaqësuar nga administratori apo përfaqësuesi i tij ligjor, si përfaqësues i caktuar dhe autorizuar rregullisht në bazë të një Nënkontrate Ndërtimi.

“Nënkontratat” janë Nënkontrata e Ndërtimit dhe Nënkontrata e Mirëmbajtjes.

“Nënkontratë e Mirëmbajtjes” është çdo Nënkontratë e lidhur për kryerjen e Punimeve të mirëmbajtjes apo një pjese të tyre, me ndryshimet dhe zëvendësimet përkatëse të bëra herë pas here në përputhje me këtë Kontratë.

“Nënkontratë Ndërtimi” është çdo nënkontratë e lidhur ndërmjet Shoqërisë Koncesionare dhe një Nënkontraktori Ndërtimor për kryerjen e Punimeve apo një pjese të tyre, me ndryshimet dhe zëvendësimet përkatëse të bëra herë pas here në përputhje me këtë Kontratë.

“Njësia e Zbatimit të Projektit” ose **“NjZP”** nënkupton njësinë që krijohet nga Autoriteti Kontraktor për monitorimin e zbatimit të kësaj Kontrate.

“Norma e Brendshme e Kthimit të Kapitalit” është norma e brendshme e kthimit të Kapitalit të Investuar të Koncesionarit, sipas përlllogaritjeve të Modelit Financiar, përfshirë ndryshimet që ai mund të ketë sipas dispozitave të kësaj Kontrate.

“Ngjarje e Forcës Madhore” ka kuptimin e dhënë te Neni 79 (*Forca Madhore*) i kësaj Kontrate.

“Njoftimi për Korrigjim” ka kuptimin që i jepet te Neni 97.3 (*Zgjidhja si Pasojë e Mospërmbushjes së Detyrimeve nga Shoqëria Koncesionare*) i kësaj Kontrate dhe/ose te Neni 98.3 (*Zgjidhja e Kontratës si pasojë e Mospërmbushjes së Detyrimeve nga Autoriteti Kontraktor*), sipas rastit.

“Njoftimi për Mospërmbushje nga ana e Autoritetit Kontraktor” ka kuptimin e dhënë te Neni 98.2 (*Zgjidhja e Kontratës si pasojë e Mospërmbushjes së Detyrimeve nga Autoriteti Kontraktor*) i kësaj Kontrate.

“Njoftimi për Mospërmbushje të Detyrimeve nga Shoqëria Koncesionare” ka kuptimin që i jepet te Neni 97.2 (*Zgjidhja si Pasojë e Mospërmbushjes së Detyrimeve nga Shoqëria Koncesionare*) i kësaj Kontrate.

“Njoftim për Ndryshime nga Autoriteti Kontraktor” ka kuptimin e dhënë te Neni 49 (*Ndryshime të Kërkuara nga Autoriteti Kontraktor*) i kësaj Kontrate.

“Njoftim për Ndryshime nga Koncesionari” ka kuptimin e dhënë te Neni 50 (*Ndryshime të Kërkuara nga Shoqëria Koncesionare*) i kësaj Kontrate.

“Objekte Arkeologjike” ka kuptimin e dhënë në përkufizimin “pasuri arkeologjike” të Ligjit

Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”.

“**Objekte të Përkohshme**” janë të gjitha strukturat dhe instalimet e përkohshme, të cilat nevojiten për ndërtimin e Rugës.

“**Objekte të Trashëgimisë Kulturore**” ka kuptimin e dhënë në përkufizimin “pasuri kulturore materiale” të Ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”.

“**Objekti**” ka kuptimin e dhënë në Neni 3 (*Objekti i Kontratës*) i kësaj Kontrate.

“**Ortak**” ka kuptimin që jepet sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar apo sipas përcaktimeve të Ligjit të zbatueshëm të vendit ku është regjistruar shoqëria.

“**Pagesa nga Autoriteti Kontraktor**” është çdo pagesë që Autoriteti Kontraktor ose ndonjë Palë e Autoritetit Kontraktor i detyrohet Shoqërisë Koncesionare apo Koncesionarit sipas dispozitave të kësaj Kontrate, apo Marrëveshjes së Monitorimit dhe Koordinimit të Përbashkët referuar Shërbimit të Operimit.

“**Pagesat e Shërbimit të Borxhit**” do të thotë ato pagesa siç kërkohen të bëhen nga Koncesionari apo Shoqëria Koncesionare për financuesit e saj sipas Marrëveshjeve të Financimit në secilin Vit Kontrate. Për shmangien e dyshimeve, ky term do të nënkuptojë pagesat e principalit, ato të interesave si dhe shpenzime të tjera, të parashikuara në Marrëveshjen e Financimit.

“**Pagesë e Suficitit të të Ardhurave**” është pagesa që Shoqëria Koncesionare mund t’i bëjë për çdo Vit Autoritetit Kontraktor gjatë Periudhës së Operimit, nëqoftëse tejkalohej të Ardhurat Bazë, dhe e barabartë me vlerën që del nga aplikimi i formulës si vijon: diferenca që del nga Të Ardhurat nga Tarifa të arkëtuara për atë Vit minus Të Ardhurat Bazë të parashikuara për të njëjtin Vit, e shumëzuar me(..... përqind). Për të shmangur çdo keqkuptim, Të Ardhurat nga Tarifa janë të barazvlefshme me të Ardhurat Bazë, apo nëse diferenca që del nga Të Ardhurat nga Tarifa minus Të Ardhurat Bazë është një numër negativ, Shoqëria Koncesionare nuk do të bëjë asnjë Pagesë të Suficitit të të Ardhurave. Për efekt të llogaritjes së Pagesës së Suficitit të të Ardhurave, të Ardhurat nga Tarifat të arkëtuara në Lekë do të konvertohen në Euro me kursin mesatar vjetor të këmbimit Euro/Lekë të publikuar nga Banka e Shqipërisë për vitin objekt rakordimi.

“**Pagesë për Rakordim të të Ardhurave**” është Pagesa për Rakordim të Deficitit të të Ardhurave ose Pagesa për Rakordim të Suficitit të të Ardhurave, sipas rastit.

“**Pagesë për Rakordim të Deficitit të të Ardhurave**” është pagesa që Autoriteti Kontraktor mund t’i bëjë Shoqërisë Koncesionare për çdo Vit të Kontratës përgjatë Periudhës së Garancisë, nëse është e aplikueshme. Kjo pagesë do të jetë e barabartë me vlerën që del nga llogaritja e diferencës midis Të Ardhurave Bazë të parashikuara për atë Vit minus të Ardhurat nga Tarifa të arkëtuara për atë Vit, gjithnjë e kufizuar deri në Pagesën Tavan për Vitin përkatës. Për të shmangur çdo keqkuptim, nëse diferenca më lart del një numër negativ (pra të Ardhurat nga Tarifa janë më të larta se të Ardhurat Bazë), Autoriteti Kontraktor nuk do të bëjë asnjë Pagesë për Rakordim të Deficitit të të Ardhurave.

“**Pagesa Tavan**” është pagesa maksimale që Autoriteti Kontraktor mund të bëjë në një Vit të Kontratës gjatë Periudhës së Garancisë, sipas Shtojcës 4 (*Pagesat e Autoritetit Kontraktor gjatë*

Periudhës së Garancisë).

“Palë e Autoritetit Kontraktor” është veçmas Autoriteti Kontraktor dhe nëpunësit, punëmarrësit dhe agjentët e tij dhe çdo Nënkontraktor apo Person i punësuar ose i angazhuar nga secili prej tyre (ku përfshihen edhe Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor, por pa përfshirë Palët Koncesionare) si dhe Autoritetet Përkatese të tjera që sipas rastit asistojnë Autoritetin Kontraktor për zbatimin e Kontratës, përfshirë, pa u kufizuar në, Entin Kombëtar të Operimit Rrugor.

“Palë e Dëmtuar” është pala që ka pësuar një dëm ose që pretendon të jetë dëmtuar nga një Ngjarje e Forcës Madhore ose nga shkaqe të tjera gjatë zbatimit të kësaj Kontrate.

“Palë Koncesionare” është veçmas Koncesionari, Shoqëria Koncesionare, Nënkontraktori, Përfaqësuesi i Shoqërisë Koncesionare, dhe personat e punësuar ose angazhuar nga secili prej tyre, në lidhje me realizimin e Objektivit të kësaj Kontrate.

“Palë” ka kuptimin e dhënë në hyrje të Kontratës.

“Palë e Tretë” do të kuptohet çdo individ, person fizik, juridik, shoqëri tregtare, ortakëri apo organizatë e çdo lloj forme organizimi e parashikuar nga Ligji ose ligji i një vendi tjetër, publike apo private pa përfshirë Autoritetin Kontraktor dhe Shoqërinë Koncesionare.

“Pasqyra Vjetore e Pagesave” ka kuptimin që i jepet te Neni 107.1 (*Pasqyrat Vjetore të Pagesave*) i kësaj Kontrate.

“Periudha e Garancisë” është periudha _____ vjeçare që fillon më 1 janar të Vitit pas Datës së Fillimit të Operimit, përveç rastit kur Data e Fillimit të Operimit është 1 janar, me ç’rast fillon në atë datë dhe jo në Vitin e ardhshëm.

“Periudha e Koncesionit” ka kuptimin e dhënë te Neni 5 (*Periudha e Koncesionit*) i kësaj Kontrate.

“Periudha e Monitorimit, Koordinimit të Përbashkët, referuar Shërbimit të Operimit” ka kuptimin që i jepet te Neni 54 (*Monitorimi, Koordinimi i Shërbimit të Operimit nga Enti Kombëtar i Operimit Rrugor*) i kësaj Kontrate.

“Periudha e Operimit të Shoqërisë Koncesionare” ka kuptimin që i jepet te Neni 52.2 (*Data e Fillimit të Operimit nga Shoqëria Koncesionare*) i kësaj Kontrate.

“Periudha e Përgjegjësisë së Defekteve” në lidhje me një Segment të Rrugës, ka kuptimin e periudhës prej 12 (dymbëdhjetë) Muajsh nga data e marrjes së Certifikatës së Përfundimit për atë Segment.

“Periudha Ndërtimore” është periudha 30 mujore që fillon nga Data e Fillimit të Punimeve gjatë së cilës realizohen Punimet ndërtimore të fazës së ndërtimit dhe përfundimit të Veprës segmentit rrugor Milot - Balldre sipas Dokumentacionit të Ofertës dhe Projektit të Zbatimit.

“Person” do të kuptohet çdo individ, person fizik, juridik, shoqëri tregtare, ortakëri apo organizatë e çdo lloj forme organizimi e parashikuar nga Ligji ose ligji i një vendi tjetër, përfshirë Autoritetin Kontraktor dhe Autoritetet Përkatese.

“Personi Përgjegjës për Shërbimin e Operimit” është Shoqëria Koncesionare, e cila në vazhdimësi duhet të bashkëpunojë dhe koordinojë me Entin Kombëtar të Operimit të Rrugës, për shërbimin e operimit të rrugës Milot-Balldre.

“Përdorues” janë përdoruesit e Rrugës.

“Përfaqësues i Autoritetit Kontraktor” është Personi i autorizuar për të vepruar si përfaqësues i Autoritetit Kontraktor në bazë të Kontratës.

“Përfaqësues i Shoqërisë Koncesionare” është një Person i autorizuar me shkrim për përfaqësimin e tij.

“Plani i Menaxhimit Mjedisor” ka kuptimin e planit të menaxhimit mjedisor pjesë e Dokumentacionit të Ofertës, siç mund të ndryshohet herë pas here me miratimin e Palëve.

“Plani i Mirëmbajtjes së Rrugës”, është plani i vënë në dispozicion në përputhje me Shtojcën 6 (Pasqyra e Aktiviteteve të Shërbimit të Mirëmbajtjes).

“Plani i Operimit të Rrugës” është plani i vënë në dispozicion në përputhje me Nenin 57 (*Plani i Operimit të Rrugës*) i kësaj Kontrate.

“Praktika e Mirë e Industrisë” është ushtrimi i shkallës së zotësisë, korrektesës, maturisë dhe largpamësisë që do të pritej në mënyrë të arsyeshme dhe të zakonshme nga një palë kontraktore e aftë dhe me përvojë në sektorin e ndërtimit të rrugëve në Shqipëri dhe e cila kërkon të përmbushë me mirëbesim detyrimet e veta kontraktore, në respekt të të gjitha Ligjeve, e angazhuar në të njëjtën lloj ndërmarrjeje dhe duke punuar në rrethana dhe kushte të njëjta ose të ngjashme.

“Problem i Mbartur” është çdo pretendim, kërkesë apo përgjegjësi e parashikuar me Ligj që ka ardhur nga një veprim ose mosveprim në lidhje me pjesët e Sheshit përpara Datës së Hyrjes në Fuqi të Kontratës.

“Procedurat e Bashkërendimit të Operimit” ka kuptimin e dhënë te Neni 56 (*Procedurat e Bashkërendimit të Operimit*) i kësaj Kontrate.

“Programi i Riparimit Kapital” është programi i riparimit kapital, i miratuar ose përcaktuar, përkatësisht, në përputhje me Kontratën dhe Projektin.

“Projekt-Ideja” ka kuptimin që i jepet te Neni 34 (*Dokumentacioni i Projektit*) i kësaj Kontrate.

“Projekt-Zbatimi” ka kuptimin që i jepet te Neni 34 (*Dokumentacioni i Projektit*) i kësaj Kontrate.

“Projekti” është tërësia e aktiviteteve të përcaktuar në Objektin e kësaj Kontrate dhe kryerja e çdo pjese të Punimeve dhe Shërbimeve në Shesh dhe/ose Veprës gjatë Kohëzgjatjes së Kontratës si dhe financimi, sipas Dokumentacionit të Ofertës të paraqitur nga Shoqëria Koncesionare dhe kësaj Kontrate.

“Propozimi” ka kuptimin që i jepet te Neni 54 (*Monitorimi, Koordinimi i Shërbimit të Operimit nga Enti Kombëtar i Operimit Rrugor*) i kësaj Kontrate.

“Punime” janë punimet ndërtimore, punimet gjeoteknike dhe çdo punim tjetër që mund të

nevojitet në lidhje me projektimin, ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e Veprës segmentit rrugor Milot-Balldre dhe të Objekteve të Përkohshme nga Shoqëria Koncesionare sipas Projekt-Zbatimit.

“**Punime Kapitale**” janë punimet ndërtimore, të cilat janë të nevojshme në lidhje me Veprën si (i) Punime gjeoteknike fillestare; (ii) Punime rehabilituese dhe (iii) Punime në mbikalime dhe degëzime/kryqëzime.

“**Qendra e Mirëmbajtjes**” ka kuptimin e godinës/godinave ku qëndron personeli përgjegjës për mbikëqyrjen dhe koordinimin e realizimit të Shërbimit të Mirëmbajtjes, sipas kësaj Kontrate.

“**Qendra e Operimit**” ka kuptimin e godinës/godinave ku qëndron personeli përgjegjës për mbikëqyrjen dhe koordinimin e realizimit të Shërbimit të Operimit, përfshirë menaxhimin e trafikut dhe arkëtimin e Tarifës.

“**QKB**” është aktualisht Qendra Kombëtare e Biznesit, si institucioni publik që organizohet dhe funksionon në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 131/2015 “*Për Qendrën Kombëtare të Biznesit*”.

“**Raporti Përfundimtar**” është raporti i përfundimit të Punimeve i cili hartohet nga Shoqëria Koncesionare dhe i dorëzohet Autoritetit në përfundim të punimeve të objektit të Kontratës.

“**Riparim Kapital**” është shërbimi i mirëmbajtjes të Rrugës (i cili nuk është Mirëmbajtje Rutinë apo Mirëmbajtje Dimërore) i kryer nga Shoqëria Koncesionare çdo 10 (dhjetë) vjet duke filluar nga Data e Përfundimit të Punimeve, në përputhje me rregullat teknike të projektimit të rrugëve dhe Dokumentacionin e Ofertës. Vlera e Riparimit Kapital, që do të investohet nga Shoqëria Koncesionare çdo 10 (dhjetë) vjet do të jetë jo më pak se në shumën _____ Euro, e indeksuar çdo vit referuar pikës 72.2 të kësaj kontrate.

“**Risk i Pasigurueshëm**” do të thotë një ngjarje apo situatë, e cila nuk mbulohet apo është e përjashtuar në kushtet e përgjithshme të kontratave të policave të sigurimit që ofrohen në tregun shqiptar të sigurimeve nga kompanitë sigurorese të licencuara nga Autoriteti Përkatës.

“**Rrugë**” ka kuptimin e rrugës “Milot – Balldre” (Kategoria A), sipas kuptimit që i jepet autostradës në Nenin 2 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë.

“**Segmentet**” janë pozicione gjeografike brenda gjurmës së Territorit të Projektit ose Rrugës, të ndara skematikisht, mbi të cilat do të kryhen Punimet apo Shërbimet.

“**Sigurimet**” ka kuptimin që i jepet te Neni 87.1 (*Sigurimet*) i kësaj Kontrate.

“**Sigurimi i Përgjegjësisë ndaj Palëve të Treta**” është sigurimi i përgjegjësisë ndaj Palëve të Treta, që është pjesë e Sigurimeve që duhen blerë dhe mbajtur në bazë të parashikimeve të bëra te Neni 87 (*Sigurimet*) i kësaj Kontrate.

“**Sistemet e Cilësisë**” janë sistemet e menaxhimit të cilësisë të vëna në dispozicion në përputhje me Shtojcën 6 (*Pasqyra e Aktiviteteve të Shërbimit të Mirëmbajtjes*).

“**Situacioni**” janë evidencat faktike të miratuara nga Inxhinieri i Pavarur të Punimeve, të cilat pasqyrojnë vendndodhjet, madhësitë, materialet e ndërtimit dhe hollësi të tjera të Punimeve të

realizuara, shoqëruar me të gjitha skicat, llogaritjet, raportet, specifikimet etj.

“Situatë e Jashtëzakonshme Gjeoteknike” është ngjarja e një fenomeni gjeoteknik të paparashikuar (si për shembull shkarje dheu që bllokun pjesërisht ose plotësisht karrexhatën), i cili mund të ndikojë negativisht në Punimet dhe Shërbimet.

“Skicat e Ndërtimit” janë skicat që janë realizuar nga llogaritjet e hartuara në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktor dhe Ligjit, në të cilat paraqiten të gjitha dimensionet, llogaritjet dhe hollësitë e nevojshme për t’i dhënë mundësi Shoqërisë Koncesionare të realizojë Punimet.

“Standarde” janë standardet e identifikuara në Projekt-Zbatim në lidhje me Punimet dhe Shërbimet në Rrugë, në përputhje me Ligjin.

“Shembja e Objekteve” do të thotë prishja nga ana e Autoriteteve Përkatëse e objekteve të shpronësuara apo objekteve pa leje që ndodhen në Territorin e Projektit duke përfshirë kostot e transportit dhe depozitimit të mbetjeve pas shembjes, të cilat në çdo rast mbulohen nga Autoriteti Kontraktor.

“Shesh i Tarifës” është zona e përcaktuar e Rrugës, e projektuar dhe ndërtuar enkas për të vendosur objektet e arkëtimit të Tarifës dhe operacionet përkatëse.

“Shesh” ka kuptimin e tokës (pavarësisht statusit të saj) mbi të cilën do të kryhen Punimet që mund të jetë pjesë e Territorit të Projektit dhe/ose Truallit Ekstra.

“Shërbime” janë Shërbimet e Mirëmbajtjes dhe Shërbimet e Operimit të Rrugës të parashikuara në Shtojcën 8 (*Dokumentacioni i Ofertës*).

“Shërbimet e Mirëmbajtjes” janë shërbimet e Mirëmbajtjes Dimërore dhe shërbimet e Mirëmbajtjes Rutinë të Rrugës sipas dispozitave të kësaj Kontrate.

“Shërbimi i Operimit” ka kuptimin që i jepet te Neni 51 (*Shërbimi i Operimit*) i kësaj Kontrate.

“Shkak Lehtësimi” ka kuptimin e dhënë te Neni 80.1 (*Shkaku i Lehtësimit*) i kësaj Kontrate.

“Shkallët e Tarifës” janë shkallët faktike të Tarifës që zbaton Shoqëria Koncesionare, sipas dispozitave të kësaj Kontrate, në raport me llojin e mjetit me motor, që përdor Rrugën.

“Shoqëri e Lidhur” ka kuptimin e çdo shoqërie që zotëron Kontrollin e asaj shoqërie, çdo shoqëri që është nën Kontrollin e asaj shoqërie, ose çdo shoqëri e varur, e cila ka Kontrollin mbi atë shoqëri.

“Shoqëria Koncesionare” ka kuptimin e dhënë në hyrjen e kësaj Kontrate.

“Shoqëritë e Tjera Koncesionare” ka kuptimin e secilës prej shoqërive koncesionare që kanë ndërtuar apo do të ndërtojnë segmente të tjera të Korridorit.

“Shpenzime Kapitale” nënkupton shpenzimet që klasifikohen nga Ligji apo parimet e përgjithshme të pranura të kontabilitetit, si investime kapitale ose shpenzime kapitale.

“Shpronësim” në kontekstin e kësaj Kontrate do të nënkuptojë procedurën e shpronësimit, ose

çdo masë apo veprim i cili, i marrë veç e veç apo së bashku, ka efekt të barasvlershëm me shpronësimin, me fondet dhe shpenzimet e Autoritetit Kontraktor, apo çdo Autoriteti tjetër Përkatës në përputhje me ligjin përkatës, për të gjithë pronarët ligjorë dhe Palët e Treta që gëzojnë të drejta mbi sipërfaqet që do të përdoren për përmbushjen e Objektivit të Kontratës.

“Shtojcë” është çdo shtojcë, deklaratë, vërtetim, autorizim, vendim, urdhër ose dokument tjetër i nënshkruar nga palët që i bashkëlidhet kësaj Kontrate, si pjesë përbërëse dhe e pandarë e saj, tani apo në të ardhmen.

“Tarifa” është tarifa që paguajnë Përdoruesit e Rrugës.

“Tatim” apo “Taksë” ka përkatësisht kuptimin e dhënë në legjislacionin tatimor dhe doganor në fuqi.

“Territori i Projektit” ka kuptimin e dhënë te Neni 23 (*Territori i Projektit*) i kësaj Kontrate.

“Të Ardhurat Bazë” ka, për çdo Vit të Kontratës, kuptimin e shumave të përcaktuara në kolonën “të ardhurat bazë” në Shtojcën 4 (*Pagesat e Suficitit të të Ardhurave nga Shoqëria Koncesionare*).

“Të Ardhurat nga Tarifa” janë tarifat e arkëtuara nga Përdoruesit për llogari të Shoqërisë Koncesionare.

“Të Ardhurat Shtesë” do të thotë çdo e ardhur shtesë që lidhet me përdorimin e Rrugës, përveç Të Ardhurave nga Tarifa dhe të ardhurave nga Vendshërbimet.

“Të Drejtat e Autoritetit Kontraktor” janë të gjitha të drejtat e dhëna Autoritetit Kontraktor sipas kësaj Kontrate si dhe ato të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

“Të Drejtat e Shoqërisë Koncesionare” janë të gjitha të drejtat e dhëna Shoqërisë Koncesionare sipas Objektivit të Kontratës, përfshirë të drejtën për të projektuar, ndërtuar, operuar, mirëmbajtur, rehabilituar dhe për t'i financuar këto aktivitete në Rrugë në përputhje me Ligjin dhe me këtë Kontratë; e drejta e çdo pagese, financimi, kompensimi, shtese në kohë, nga ana e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate.

“Të Dhënat e Vëna në Dispozicion” ka kuptimin që i jepet te Neni 19 (*Dhënia e Informacionit nga Autoriteti Kontraktor*) i kësaj Kontrate.

“Truall Ekstra” është toka (pavarësisht statusit të saj) që i nevojitet në mënyrë të përkohshme Shoqërisë Koncesionare krahas Territorit të Projektit dhe/ose Truallit Shtesë, në mënyrë që të realizojë Punimet dhe/ose Shërbimet, në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate.

“Truall Shtesë” është toka (pavarësisht statusit të saj) që i nevojitet në mënyrë të përhershme Shoqërisë Koncesionare krahas elementeve të tjera që përbëjnë Territorin e Projektit në mënyrë që të realizojë Punimet dhe/ose Shërbimet në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate. Kur Truall Shtesë aprovet, konsiderohet si pjesë e Territorit të Projektit për efekt të kësaj Kontrate.

“TVSH” është tatimi mbi vlerën e shtuar, siç parashikohet në Ligjin Nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, apo cildo Ligj që e zëvendëson atë gjatë zbatimit të kësaj Kontrate.

“Vendshërbimet” janë vendet në apo përgjatë Rrugës që sipas rastit, duhen ndërtuar ose

mirëmbajtur, për t'iu ofruar Përdoruesve si: vend për pushim (përfshirë ndërtesat e destinuar për çlodhje); vend për parkim; pika shërbimi, duke përfshirë por pa u kufizuar në ofrimin e pijeve, ushqimeve dhe furnizimit të automjetit me lëndë djegëse; si dhe shërbime të tjera të nevojshme. Vendshërbimet do të përfshijnë edhe vendet me instalime të karakterit të përkohshëm, të cilat mund të përdoren për realizimin e shërbimeve të ndryshme nga Shoqëria Koncesionare.

“Vepra” ka kuptimin e Rrugës, Shesheve të Tarifës, Qendrës së Mirëmbajtjes, Qendrës së Operimit, të marra së bashku. Për qartësi, territori i Vendshërbimeve nuk do të konsiderohet si pjesë e Veprës segmentit rrugor “Milot - Balldre”, për efekt të kësaj Kontrate.

“Veprim Shtetëror Thelbësisht në Kundërshtim me Kontratën” ka kuptimin e dhënë te Neni 81.1 (*Veprimi Shtetëror Thelbësisht në Kundërshtim me Kontratën*) i kësaj Kontrate.

“Vlera e Tregut e Projektit” ka kuptimin e dhënë te Neni 103 (*Kompensimi për zgjidhje të Kontratës për mospërbushje të Shoqërisë Koncesionare*) i kësaj Kontrate.

“Vlerë Investimi” është vlera monetare e investimeve të Veprës dhe tërë komponentët e tij, në përputhje me Dokumentacionin e Ofertës të dorëzuar nga Koncesionari, në shumën prej _____ EUR, pa përfshirë TVSH-në.

“Vlerë Ndërtimi” është vlera monetare e ndërtimit të Veprës në përputhje me Dokumentacionin e Ofertës të dorëzuar nga Koncesionari në shumën _____ EUR, pa përfshirë TVSH-në.

“Vlerë e mbetur e Kontratës” është vlera monetare për operimin dhe mirëmbajtjen e Veprës në përputhje me Dokumentacionin e Ofertës të dorëzuar nga Koncesionari në shumën prej _____ EUR, pa përfshirë TVSH-në.

“Vit i Kontratës” është viti i plotë kalendarik gjatë Kohëzgjatjes së Kontratës me kusht ku do të konsiderohet se:

- 1) Viti i parë i Kontratës është periudha kohore nga Data e Hyrjes në Fuqi të kësaj Kontrate deri më 31 dhjetorin e ardhshëm; dhe
- 2) Viti i fundit i Kontratës është periudha kohore nga 1 janari i fundit përpara Datës së Përfundimit të Kontratës deri në Datën e Përfundimit të Kontratës.

Neni 2. Interpretimi i Kontratës

Në këtë Kontratë, përveçse kur konteksti e kërkon ndryshe, do të përdoren interpretimet e mëposhtme:

2.1 një fjalë e përdorur në numrin njëjës përfshin dhe numrin shumës dhe anasjelltas. Referimi të njëra gjini përfshin edhe gjininë tjetër;

2.2 referenca për një Person përfshin pasardhësit e tij apo Personat e autorizuar nga ai në bazë të Ligjit;

2.3 referenca ndaj çdo Neni, paragrafi ose Shtojce, përveç kur deklarohet shprehimisht për të kundërtën, është referencë ndaj atij Neni, paragrafi ose Shtojce të kësaj Kontrate;

2.4 referenca për këtë Kontratë ose ndonjë dokument tjetër të përfshirë në të, nënkupton një referencë ndaj çdo ndryshimi/amendimi ose shtese të kësaj Kontrate, siç mund të ndodhë herë pas here;

2.5 titujt dhe renditja numerike e përdorur për Nenet, paragrafët, nënparagrafët, Shtojcat dhe tabela e përmbajtjes janë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e kësaj Kontrate;

2.6 një referim te secili institucion apo organ vendimmarrës i referohet institucionit dhe organit vendimmarrës ekzistues si dhe nëse ai institucion apo organ vendimmarrës pushon së ekzistuari, ristrukturohet apo ndan përgjegjësitë me institucione apo organe të tjera, i referohet institucionit apo organit vendimmarrës pasardhës apo institucionit apo organit që trashëgon përgjegjësitë ekzistuese apo që shërben për të kryer funksione dhe qëllime të ngjashme apo të njëjta si institucioni apo organi ekzistues;

2.7 Shtojcat e kësaj Kontrate përbëjnë pjesë integrale të kësaj Kontrate;

2.8 fjalët “përfshin” ose “duke përfshirë” do të konsiderohet se pasohen nga fjalët “pa kufizim” ose “duke mos u kufizuar në”, edhe nëse ato ndiqen ose jo nga fraza ose fjalë të tilla të ngjashme;

2.9 çdo fjalë, term, frazë dhe shkurtime që fillon me shkronjë të madhe e përdorur specifikisht në këtë Kontratë ose në ndonjë Shtojcë apo dokument tjetër bashkëngjitur do të ketë kuptimin e përcaktuar në këtë Kontratë nëse është e përkufizuar në Neni 1 (*Përkufizimi i termave*) më lart ose në Shtojcën ose dokumentin përkatës nëse është përkufizuar aty;

2.10 përveç rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë Kontratë, në rast të një konflikti të drejtpërdrejtë midis ndonjë dispozite të pjesës kryesore të Kontratës, të ndonjë Shtojce apo të ndonjë dokumenti që i referohemi në këtë Kontratë apo Shtojcë, radha e përparësisë do të jetë si më poshtë:

- 1) kjo Kontratë;
- 2) Shtojcat e saj;
- 3) çdo dokument tjetër të cilit i referohemi në këtë Kontratë ose çdo dokument tjetër bashkëlidhur kësaj Kontrate.

Neni 3. Objekti i Kontratës

Me anë të kësaj Kontrate, Autoriteti Kontraktor, i autorizuar nga legjislacioni në fuqi i jep Shoqërisë Koncesionare koncesion të formës DBFOMT (“Design – Build – Finance – Operate – Maintain – Transfer”) për projektimin, financimin, ndërtimin, rehabilitimin, vënien në punë, administrimin, operimin, përfshirë, pa u kufizuar, të drejtat ekskluzive të Shoqërisë Koncesionare për të përfituar pagesë nga Përdoruesit e Rrugës dhe mirëmbajtjen e Rrugës “*Milot- Balldre*” për një Afat 35 vjeçar, (në vijim “**Objekti**”), si dhe transferimin e tij në përfundim të Kontratës nga Shoqëria Koncesionare tek Autoriteti Kontraktor, në përputhje me kushtet dhe afatet e kësaj Kontrate.

Neni 4. Dhënia e Koncesionit/Ekskluziviteti

4.1 Në përputhje me parashikimet te Neni 3 (*Objekti i Kontratës*) më lart, duke filluar nga Data e Hyrjes në Fuqi, Autoriteti Kontraktor i jep Shoqërisë Koncesionare, e cila pranon:

- a) të gjitha të drejtat ekskluzive sipas parashikimeve të kësaj Kontrate, në lidhje me Objektin, për të gjithë Periudhën e Koncesionit;
- b) të drejtën për Gëzim të Qetë brenda afateve të përcaktuara në këtë Kontratë, me qëllim realizimin e Projektit;
- c) gjithë të drejtat që i jepen mbi Veprën, në përputhje me Ligjin dhe këtë Kontratë;
- d) t'i kalojë Autoritetit Kontraktor, në mbarim të Kohëzgjatjes së Kontratës gjithë të drejtat mbi Veprën si dhe të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për këtë qëllim, siç parashikohet në këtë Kontratë.

4.2 Kjo Kontratë Koncesioni është një projekt DBFOMT (“*Design – Build – Finance – Operate – Maintain – Transfer*”). Koncesionari, me miratim të Autoritetit Kontraktues vendos si garanci për financim në institucionet financiare vetëm të drejtat e tij që rrjedhin Kontrata e Koncesionit.

4.3 Për të shmangur çdo keqkuptim, Palët bien dakord që Autoriteti Kontraktor do të mbajë të drejtën e pronësisë mbi Sheshin dhe Rugën gjatë gjithë Kohëzgjatjes së Kontratës. Shoqëria Koncesionare gëzon të drejtën e regjistrimit të pronësisë në emër të saj të Qendrës së Mirëmbajtjes. Shoqëria Koncesionare gjithashtu bie dakord se e drejta e pronësisë së Shoqërisë Koncesionare mbi Qendrën e Mirëmbajtjes është e kufizuar nga detyrimi i Shoqërisë Koncesionare për të mos tjetërsuar (shitur, dhuruar ose transferuar në çfarëdo mënyre) ato, pjesërisht ose plotësisht, në favor të Palëve të Treta. Ky kufizim si dhe detyrimi i Shoqërisë Koncesionare për të transferuar të drejtën e pronësisë dhe dorëzimin e Qendrës së Mirëmbajtjes në favor të Autoritetit Kontraktor do të regjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

4.4 Përgjatë të gjithë Kohëzgjatjes së kësaj Kontrate, Autoriteti Kontraktor dhe as ndonjë Autoritet tjetër Përkates, qoftë ky në nivel qëndror, apo vendor, nuk do t'i japë askujt të drejta, me ose pa shpërblim, të operojë, përdorë, administrojë, apo të mirëmbajë Veprën Segmentin rrugor Milot - Balldre dhe/ose Vendshërbimet, përveçse në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate. Në rast se Autoriteti Kontraktor ndërmerret ndonjë veprim në shkelje të këtij Neni, kjo rrethanë konsiderohet si shkelje e dispozitave të kësaj Kontrate dhe Shoqërisë Koncesionare i lind e drejta ta zgjidhë atë dhe të kërkojë Dëmet.

Neni 5. Periudha e Koncesionit

5.1 Përveçse në rastet e përfundimit të parakohshëm të kësaj Kontrate, apo zgjatjes së kësaj Kontrate në përputhje me kushtet e saj, përfshirë, pa u kufizuar në Nenin 5.2 më poshtë, Periudha e Koncesionit do të jetë 35 (tridhjetë e pesë) vjet, duke filluar nga Data e Hyrjes në Fuqi të Kontratës dhe përfundon në përvjetorin e 35-të të kësaj date (“**Periudha e Koncesionit**”).

5.2 Periudha e Koncesionit nëse zbatimi i kësaj Kontrate është vonuar për shkak të Shkakut të Lehtësimit dhe Veprimit Shtetëror Thelbësisht në Kundërshtim me Kontratën, ose për çdo shkak tjetër që parashikohet si i tillë sipas kësaj Kontrate, ose për shkak të ndryshimeve të tjera të Kontratës mund të zgjatet në përputhje me dispozitat ligjore siç parashikohet në Nenet 31, 32 dhe 33 të Ligjit Nr.125/2013 “*Për koncesionet dhe partneritetin publik privat*”, të ndryshuar, sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate.

Neni 6. Kushtet paraprake

6.1 Pas nënshkrimit të saj nga Palët, kjo Kontratë hyn në fuqi me miratimin e saj nga Këshilli i

Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe botimin e vendimit të miratimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë (në vijim **“Data e Hyrjes në Fuqi”**).

6.2 Pas Datës së Hyrjes në Fuqi, duke marrë në konsideratë dhe parashikimet e Nenit 6.4 më poshtë, detyrimi i Shoqërisë Koncesionare për të filluar Punimet bëhet efektiv në datën në të cilën përmbushet i fundit nga kushtet e përmendura më poshtë (**“Data e Fillimit të Punimeve”**):

- a) Dorëzimi nga ana e Shoqërisë Koncesionare e Garancisë së Kontratës në përputhje me këtë Kontratë;
- b) Paraqitja nga ana e Shoqërisë Koncesionare tek Autoriteti Kontraktor i Projekt-Zbatimit brenda _____ Muajsh nga Data e Hyrjes në Fuqi;
- c) Miratimi i Projekt-Zbatimit nga Autoriteti Kontraktor brenda afateve dhe në përputhje me Neni 34 (*Dokumentacioni i Projektit*);
- d) Lëshimi i Miratimeve të Nevojshme nga ana e Autoritetit Kontraktor dhe Autoriteteve Përkatëse të tjera, me qëllim mundësimin e fillimit të punës në lidhje me një Segment apo Vepër sipas Projekt-Zbatimit;
- e) Përzgjedhja e Inxhinierit të Pavarur nga ana e Autoritetit Kontraktor, sipas dispozitave të kësaj Kontrate;
- f) Identifikimi i Objekteve për Shpronësim nga Shoqëria Koncesionare dhe përfundimi i procedurave të Shpronësimeve nga Autoriteti Kontraktor nëpërmjet Autoritetit Përkatës, të cilat lidhen me zbatimin e Projekt Zbatimit, me qëllim mundësimin e fillimit të punës në lidhje me një Segment, Rrugën apo Vepër tjetër;
- g) Dorëzimi i Territorit të Projektit nga ana e Autoritetit Kontraktor te Shoqëria Koncesionare;
- h) Dorëzimi i një dokumenti mbi financimin e Projektit, që do të sigurohet nga Huadhënësit, apo Palët Financuese apo Koncesionari lidhur me fondet e nevojshme për realizimin e Projektit.

6.3 Afati maksimal për përmbushjen e kushteve të mësipërme nga Palët do të jetë jo më shumë se _____ Muaj nga Data e Hyrjes në Fuqi të Kontratës, përveç rasteve të përcaktuara te Neni 7 (*Mospërmbushja e Kushteve Paraprake*) i kësaj Kontrate.

6.4 Pas Datës së Hyrjes në Fuqi, Shoqëria Koncesionare në diskrecionin e saj të plotë mund të zgjedhë të heqë dorë nga e drejta e saj për të kërkuar përmbushjen e ndonjërit prej kushteve paraprake sa më lart nga Autoriteti Kontraktor dhe/ose Autoritet Përkatës, apo duke lejuar përmbushjen e tij me vonesë. Kjo nuk do të konsiderohet heqje dorë e Shoqërisë Koncesionare nga të drejtat që ajo ka në bazë të kësaj Kontrate. Në çdo rast, kur Shoqëria Koncesionare vendos heqjen dorë për të kërkuar përmbushjen e ndonjërit prej kushteve paraprake sa më lart nga Autoriteti Kontraktor dhe/ose lejon përmbushjen e tij me vonesë, ky vendim i njoftohet Autoritetit Kontraktor në formë të shkruar.

Neni 7. Mospërmbushja e kushteve paraprake

7.1 Në rastin se kushtet paraprake të përcaktuara te Neni 6 (*Kushtet Paraprake*) më sipër nuk janë

përbushur brenda _____ Muajve nga Data e Hyrjes në Fuqi të kësaj Kontrate, Palët do të takohen për të vendosur për një rrugëzgjidhje për plotësimin e kushteve paraprake të mbetura.

7.2 Në rast se kushtet paraprake të mbetura nuk janë përbushur ende edhe pas përfundimit të një afati shtesë prej 3 (tre) Muajsh nga përbushja e afatit të _____ Muajve nga Data e Hyrjes në Fuqi të kësaj Kontrate, Shoqëria Koncesionare i propozon Autoritetit Kontraktor një plan të ri veprimi, ku janë përcaktuar afatet e reja të plotësimit të kushteve paraprake të përcaktuara në këtë Nen, veprimet konkrete për secilën Palë, me qëllim miratimin e tij brenda 10 (dhjetë) ditëve nga Autoriteti Kontraktor. Në rast të mungesës së komunikimit për miratim, kjo do të konsiderohet miratim në heshtje i planit të ri të veprimit.

7.3 Në rast se kushtet paraprake të mbetura nuk janë përbushur ende, edhe pas përfundimit të afatit të dakordësuar në planin e ri të veprimit:

- a) Në rastin e mospërbushjes nga Autoriteti Kontraktor të kushteve paraprake që lidhen me të, Shoqërisë Koncesionare i lind e drejta ose të (i) kërkojë përbushjen e detyrimit përkatës, ose (ii) të zgjidhë Kontratën dhe me paraqitjen e kërkesës të shoqëruar nga dokumentacioni mbështetës të marrë si kompensim i rënë dakord paraprakisht, kostot e pjesëmarrjes në zhvillimin e procedurave konkurruese/të tenderit si dhe zhbllokimin dhe kthimin e Garancisë së Kontratës, nëse kjo e fundit është dorëzuar. Autoriteti Kontraktor duhet të bëjë pagesat përkatëse brenda 30 (tridhjetë) Ditë Pune nga marrja e kërkesës së Shoqërisë Koncesionare. Dispozitat e këtij paragrafi nuk e përjashtojnë Shoqërinë Koncesionare nga e drejta për të pretenduar Dëme të tjera të cilat do të vendosen në perputhje me Nenin 132 (*Përshkallëzimi dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve*) të kësaj Kontrate.
- b) Në rastin e mospërbushjeve nga Shoqëria Koncesionare të kushteve paraprake për faj të Shoqërisë Koncesionare, Autoritetit Kontraktor i lind e drejta ose të (i) kërkojë përbushjen e detyrimit përkatës, ose (ii) të zgjidhë Kontratën dhe të mbajë Garancinë e Kontratës, si kompensim i rënë dakord paraprakisht. Dispozitat e këtij paragrafi nuk e përjashtojnë Autoritetin Kontraktor nga e drejta për të pretenduar Dëme të tjera të cilat do të vendosen në perputhje me Nenin 132 (*Përshkallëzimi dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve*) të kësaj Kontrate.

7.4 Në rast se (i) edhe Shoqëria Koncesionare edhe Autoriteti Kontraktor nuk kanë përbushur ndonjë nga Kushtet Paraprake që i takon në përfundim të afateve përkatëse sipas Kontratës, dhe kjo mospërbushje ka ardhur si rrjedhojë e veprimeve ose mosveprimeve me faj të Palës në lidhje me kushtin përkatës që i takonte asaj Pale për ta përbushur, dhe (ii) në rast se njëra nga Palët zgjedh që ta zgjidhë këtë Kontratë sipas dispozitave të nenit 7.3 më lart, atëherë kjo Kontratë përfundon me efekt të menjëhershëm dhe:

- a) Asnjëra Palë nuk i detyrohet Palës tjetër ndonjë pagesë në lidhje me një përfundim të tillë; dhe
- b) Autoriteti Kontraktor do të kthejë Garancinë e Kontratës.

Neni 8. Mbyllja Financiare

8.1 Palët bien dakord që (i) Shoqëria Koncesionare do ta përfundojë Mbylljen Financiare dhe do ti dërgojë Autoritetit Kontraktor një njoftim në lidhje me këtë jo më vonë se data e përbushjes

së kushteve paraprake të specifikuara te Neni 6 (*Kushtet Paraprake*) dhe nenin 7 ”Mospërbushja e kushteve paraprake” më sipër; dhe (ii) Shoqëria Koncesionare mund të fillojë Punimet dhe të vijojë me zbatimin e detyrimeve dhe gëzimin e të drejtave që ka në bazë të kësaj Kontrate edhe para përfundimit të afatit për kryerjen e Mbylljes Financiare në mënyrë që t’i mundësojë Shoqërisë Koncesionare përfundimin e Punimeve brenda afatit dhe sipas kushteve të përcaktuara në këtë Kontratë. Autoriteti Kontraktor sipas gjykimit të tij të arsyeshëm mund të bjerë dakord ta zgjasë këtë periudhë, pas një propozimi me shkrim nga Shoqëria Koncesionare.

8.2 Nëse brenda kësaj periudhe Shoqëria Koncesionare nuk arrin të bëjë Mbylljen Financiare, përveçse rasteve të adresuara në Nenin 8.3 më poshtë, atëherë kjo Kontratë përfundon me efekt të menjëhershëm dhe:

- a) Asnjëra Palë nuk i detyrohet Palës tjetër ndonjë pagesë në lidhje me një përfundim të tillë; dhe
- b) Autoriteti Kontraktor do të mbajë Garancinë e Kontratës.

8.3 Në rast se Shoqëria Koncesionare nuk arrin të bëjë Mbylljen Financiare si pasojë e një veprimi ose mosveprimi të Autoritetit Kontraktor apo një Autoriteti Përkates, apo një Veprim Shtetëror Thelbësisht në Kundërshtim me Kontratën që prek tregjet financiare, atëherë pavarësisht se Autoriteti Kontraktor zhblokon Garancinë e Kontratës, kjo nuk përjashton të drejtën e Shoqërisë Koncesionare për të pretenduar dëmshpërblim për Dëmet e pësuar.

8.4 Në rast se Kontrata zgjidhet në përputhje me nenin 8.2 më lart, Shoqëria Koncesionare është plotësisht përgjegjëse për të gjitha kostot e largimit të pajisjeve nga Territori i Projektit.

KREU 2 DEKLARIMET, TË DREJTAT, DETYRIMET E PALËVE

Neni 9. Detyrimet e përgjithshme

9.1 Shoqëria Koncesionare ka detyrimin ekskluziv, në përputhje me parashikimet e kësaj Kontrate:

- a) të hartojë Dokumentacionin e Projektit përfundimtar të Projekt-Zbatimit të Rrugës;
- b) të realizojë Punimet brenda afatit 30 muaj sipas Projektit përfundimtar të Projekt-Zbatimit pas miratimit nga Autoriteti Kontraktor (duke i dhënë përparësi fillimit dhe përfundimit të rrugës alternative);
- c) të sigurojë financimin për zbatimin e Projekt-Zbatimit;
- d) të realizojë operimin dhe mirëmbajtjen e Veprës (në shkallën e përcaktuar në këtë Kontratë) si dhe Projekt-Zbatimin e miratuar nga Autoriteti Kontraktor, i cili është hartuar në bazë të Dokumentacionit të Ofertës pjesë e kësaj Kontrate; si dhe
- e) të realizojë Identifikimin në mënyrë të plotë të Objekteve për Shpronësim të cilat lidhen me zbatimin e Projekt Zbatimit, brenda afatit të përcaktuar në nenin 7.2 të kësaj Kontrate.
- f) do të plotësojë të gjitha detyrimet e parashikuara në këtë Kontratë.

9.2 Autoriteti Kontraktor:

- a) do t'i vendosë në dispozicion Shoqërisë Koncesionare të Dhënat e Vëna në Dispozicion dhe të gjitha informacionet, dokumentacionet, për qëllimet e hartimit të Projekt-Zbatimit dhe të ndërtimit, rehabilitimit, përfundimit, operimit dhe mirëmbajtjes së Rrugës;
- b) do të angazhohet për aplikimin dhe marrjen e të gjitha Miratimeve të Nevojshme në lidhje me Projektin, aplikimi dhe marrja e të cilave i takojnë Autoritetit Kontraktor sipas legjislacionit në fuqi;
- c) do të përfundojë në mënyrë të plotë, nëpërmjet Autoritetit Përkatës, procedurat e Shpronësimeve, të cilat lidhen me zbatimin e Projekt Zbatimit, brenda afatit të përcaktuar në nenin 7.2 të kësaj Kontrate.
- d) do të marrë të gjitha masat përkatëse administrative dhe financiare për mundësimin e kryerjes në kohë (i) të Pagesave nga Autoriteti Kontraktor sipas përcaktimeve në këtë Kontratë dhe në **Marrëveshjen e Monitorimit Koordinimit të Përbashkët, referuar Shërbimit të Operimit** (ii) për Shpronësimet dhe (iii) Dëmin; si dhe
- e) do të plotësojë të gjitha detyrimet e parashikuara në këtë Kontratë.

Neni 10. E drejta e Nënkontraktimit

10.1 Shoqëria Koncesionare ka të drejtë të lidhë Nënkontrata për zbatimin e Punimeve të Projektit dhe çdo lloj kontrate tjetër, me qëllim realizimin e Objektit të kësaj Kontrate në përputhje me rregullat e nënkontraktimit të parashikuara nga ligji nr. 125/2013 “*Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat*”, i ndryshuar. Në të gjitha kontratat, Shoqëria Koncesionare është e detyruar të respektojë kushtet e kësaj Kontrate.

10.2 Shoqëria Koncesionare duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor informacionin e mëposhtëm për Nënkontraktorin e përzgjedhur:

- 1) emrin e tij dhe adresën;
- 2) qëllimet për të cilat Nënkontraktori i propozuar do të kontraktohet, duke përfshirë çdo shërbim që do të ofrohet nga Nënkontraktori i propozuar;
- 3) vlerën e Nënkontratës; dhe
- 4) çdo informacion i mëtejshëm i kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktor.

10.3 Shoqëria Koncesionare do të përzgjedhë si Nënkontraktorë Persona që dëshmojnë eksperiencë në objektin e punës apo shërbimit të nënkontraktuar. Shoqëria Koncesionare është përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate, pavarësisht faktit nëse Punimet e ndërtimit apo mirëmbajtjes janë realizuar nga vetë Shoqëria Koncesionare ose Nënkontraktorët e Ndërtimit apo Mirëmbajtjes.

10.4 Për të shmangur çdo keqkuptim, në kuptim të kufizimeve të vendosura në nenin 10.1 më lart, (i) nëse Punimet kryhen nga Konkensionari, ky i fundit nuk do të konsiderohet si Nënkontraktor, dhe nuk do të ketë nevojë që, për të, të merret miratim nga Autoriteti Kontraktor dhe (ii) Enti i Kombëtar i Operimit Rrugor nuk do të konsiderohet Nënkontraktor.

10.5 Mospërmbushja e kontratës nga nënkontraktorët, apo përshkallëzimi i çdo konflikti midis Nënkontraktorëve dhe Shoqërisë Koncesionare, nuk përbën kusht për moszbatimin e kontratës dhe nuk do të pengojë zbatimin e kontratës nga kjo e fundit.

10.6 Nënkontraktimi, një asnjë rast nuk duhet të bëhet pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor” dhe se Shoqëria Koncesionare mbetet plotësisht përgjegjëse për realizimin e kontratës pavarësisht nga sjellja e nënkontraktorit.

Neni 11. Vendshërbimet

11.1 Gjatë Periudhës Koncesionare, Autoriteti Kontraktor mund të japë leje për zhvillimin dhe operimin e vendshërbimeve.

11.2 Kur vendshërbimet ekzistojnë në Datën e Nënshkrimit të kësaj Kontrate:

- a) Përpara datës së përmbushjes së kushteve paraprake të specifikuara te Neni 6 (*Kushtet Paraprake*) më sipër, Autoriteti Kontraktor përcakton se cilat Vendshërbime do të vazhdojnë të funksionojnë dhe cilat do të hiqen. Në marrjen e një vendimi të tillë, Autoriteti Kontraktor duhet të ketë parasysh se në mënyrë që Vendshërbimet ekzistuese të vazhdojnë aktivitetin, ato duhet që të përmbushin kërkesat e legjislacionit shqiptar dhe në rastet kur standardet shqiptare nuk i trajtojnë sa duhet ato elemente të veprimtarisë përkatëse, ato evropiane. Autoriteti Kontraktor do të diskutojë me Shoqërinë Koncesionare dhe për aq sa do të jetë e mundur do të marrë në konsideratë vërejtjet dhe kërkesat e Shoqërisë Koncesionare, përpara se të vendosë për një përcaktim të tillë;
- b) Autoriteti Kontraktor vetë ose përmes Autoriteteve Përkatëse do të jetë përgjegjës për heqjen e ndonjë Vendshërbimi ekzistues. Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor duhet të heqë Vendshërbimet (nëse është rasti) brenda 3 (tre) muajve nga data e marrjes së vendimit për heqjen e Vendshërbimeve ekzistuese sipas nenit 11.3 gërma a.;
- c) Brenda 3 (tre) muajve nga data e përmbushjes së kushteve paraprake të kësaj Kontrate, Autoriteti Kontraktor u kërkon të gjithë pronarëve të Vendshërbimeve ekzistuese që do të mbeten në territoret ekzistuese:
 - 1) Të marrin të gjitha Miratimet e Nevojshme brenda 1 (një) viti nga data e përmbushjes së kushteve paraprake të kësaj Kontrate.
 - 2) Të sigurojnë gjatë Periudhës Koncesionare që Vendshërbimet të vazhdojnë të përmbushin standardet shqiptare dhe në rastet kur standardet shqiptare nuk i trajtojnë sa duhet ato elemente të ushtrimit të veprimtarisë, ato evropiane.

11.3 Nëse Autoriteti Kontraktor apo Autoriteti Përkatës nuk zbaton planin e masave dhe afatet e dispozitave të përcaktuara te neni 11.3 më lart, dhe kjo pengon mbarëvajtjen e Punimeve dhe/ose Shërbimeve do të konsiderohet si Shkak Lehtësimi.

Neni 12. E Drejta e Monitorimit nga Autoriteti Kontraktor

Në çdo kohë gjatë Periudhës së Koncesionit, Autoriteti Kontraktor ose sipas rastit Autoriteti Përkatës përgjegjës për rrugët mund t'i bëjë kontrollë Shoqërisë Koncesionare, duke përfshirë kontrollin e cilësisë së ofrimit të Shërbimeve dhe të Standardit të Punimeve, në përputhje me këtë Kontratë. Shoqëria Koncesionare i ofron Autoritetit Kontraktor çdo bashkëpunim që mund të kërkohej nga ky i fundit në mënyrë të arsyeshme (të tillë si ai i ofrimit të të dhënave sipas kërkesës, mundësisë që Autoriteti Kontraktor të marrë pjesë në monitorimin e ecurisë së punëve etj). Autoriteti Kontraktor e informon Shoqërinë Koncesionare për rezultatet e këtyre kontrolleve.

Neni 13. E drejta e ndërhyrjes nga Autoriteti Kontraktor

13.1 Nëse Autoriteti Kontraktor ka të dhëna të arsyeshme se ka:

- 1) një rrezik serioz për jetën apo shëndetin dhe sigurinë e Personave apo sigurinë e Rrugës;
- 2) një rrezik serioz ndaj pronës apo mjedisit; ose
- 3) një shpërdorim të detyrës së parashikuar me Ligj;

në lidhje me Punimet, operimin dhe mirëmbajtjen e Rrugës ose ofrimin e Shërbimeve, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ndërhyjë në mënyrë të arsyeshme në Punimet, operimin e Rrugës ose ofrimin e Shërbimeve për të larguar një rrezik të tillë duke lajmëruar më parë Shoqërinë Koncesionare sa më shpejt të jetë e mundur përpara ndërhyrjes.

13.2 Në rast të një ndërprerjeje të paarsyeshme apo të paautorizuar nga ana e Autoritetit Kontraktor ose një Autoriteti Përkatës, ose në rastin e një ndërprerjeje të autorizuar në rastin e një Ndërhyrjeje Urgjente (me kusht që kjo Ndërhyrje Urgjente nuk është shkaktuar me faj nga ana e Shoqërisë Koncesionare), e cila shkakton vonesa në Punime, mbylljen ose pezullimin e operimit të Veprës dhe/apo kosto të tjera për të, atëherë kjo do të jetë Shkak Lehtësimi.

Neni 14. Garancia e Kontratës

14.1 Para nënshkrimit të kontratës, autoriteti kontraktues merr nga ofertuesi më i suksesshëm garancitë e kërkuara për realizimin e kontratës dhe instrumentet e sigurisë si kompensim për dëmin që mund të shkaktohet si pasojë e dështimit të koncesionarëve/partnerëve privatë për të përmbushur detyrimet e parashikuara në kontratë (premtim për pagesë, garanci bankare, garanci të korporatës, kambiale etj.).

- a) Sigurimi i kontratës do të jetë 5 % të vlerës së ndërtimit ndërsa pas periudhës së ndërtimit, do të jetë deri në 5% të vlerës së mbetur të kontratës.

Neni 15. Deklarimet e Koncesionarit dhe Shoqërisë Koncesionare

15.1 Koncesionari dhe Shoqëria Koncesionare deklarojnë, garantojnë, dhe marrin përsipër përpara Autoritetit Kontraktor se:

- a) janë themeluar dhe veprojnë në përputhje me Ligjin;
- b) në dijeninë e tyre, nuk ka ndodhur asnjë ngjarje që do të bënte Koncesionarin dhe Shoqërinë Koncesionare të mos ishin në gjendje të përmbushnin detyrimet e tyre dhe nuk ekziston asnjë fakt ose ngjarje që mund të shpinte në mospërmbushjen e detyrimeve të Koncesionarit apo Shoqërisë Koncesionare; dhe
- c) me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Koncesionari apo Shoqëria Koncesionare nuk kanë kryer asnjë veprim të ndaluar nga Ligji.

15.2 Koncesionari dhe Shoqëria Koncesionare më tej garantojnë, deklarojnë dhe marrin përsipër përpara Autoritetit Kontraktor se, duke filluar nga Data e Hyrjes në Fuqi:

- a) çdo angazhim që buron nga Dokumentacioni i Projektit përfaqëson një angazhim të vlefshëm dhe të zbatueshëm të Koncesionarit dhe Shoqërisë Koncesionare, dhe Dokumentacioni i Projektit është në formën që kërkohet nga Ligji; dhe
- b) Përgatitja e Dokumentacionit të Projektit, zbatimi i tij dhe kryerja e punës nga Koncesionari dhe Shoqëria Koncesionare nuk bien ndesh me Ligjin ose me aktin e themelimit apo dokumente të tjera të brendshme të Shoqërisë Koncesionare.

Neni 16. Angazhimet e Shoqërisë Koncesionare

16.1 Shoqëria Koncesionare angazhohet se do të vihet në dijeni për të drejtat që do të përfitojë dhe natyrën dhe shkallën e rreziqeve që do të ndërmerren sipas kësaj Kontrate.

16.2 Shoqëria Koncesionare do të mbledhë informacionin e nevojshëm ligjërisht të disponueshëm dhe të aksesueshëm brenda mundësive të saj për plotësimin e detyrimeve të saj, sipas kësaj Kontrate, nëse ky informacion është i mundshëm për t'u gjetur ose është vënë në dispozicion nga Autoriteti Kontraktor dhe/ose Autoritetet Përkatëse, pasi të jetë kërkuar në mënyrë të rregullt, duke përfshirë:

- a) informacionin në lidhje me natyrën, vendndodhjen dhe gjendjen e Territorit të Projektit; dhe
- b) informacionin që lidhet me Objektet Arkeologjike ose Objektet e Trashëgimisë Kulturore, zonat me interes arkeologjik, shkencor ose natyror, kushtet dhe mundësitë që ofron vendi dhe cilësinë e strukturave ekzistuese.

16.3 Shoqëria Koncesionare angazhohet për aplikimin pranë Autoritetit Kontraktor dhe Autoriteteve Përkatëse kompetente në përputhje me kushtet dhe afatet ligjore për marrjen e Miratimeve të Nevojshme dhe Miratimeve të Nevojshme të Autoritetit Kontraktor për zbatimin e Projektit në rast se miratimet e lartpërmendura do të dalin në emër të Shoqërisë Koncesionare. Në rastet kur ato do të dalin në emër të Autoritetit Kontraktor, atëherë Shoqëria Koncesionare angazhohet që t'i vërë në dispozicion sa më parë Autoritetit Kontraktor të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në mënyrë që ky i fundit të bëjë aplikimin tek Autoritetet Përkatëse në përputhje me Ligjin.

16.4 Shoqëria Koncesionare angazhohet se do të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme sipas Ligjit që të mbrojë mjedisin në Sheshe dhe/ose në Vepër dhe për të kufizuar sa të jetë e mundur dëmet e mundshme pasurore, si pasojë e ndotjes dhe/ose shkaqeve të tjera të dëmshme mjedisore që lidhen me zbatimin e kësaj Kontrate, në përputhje me Planin e Menaxhimit Mjedisor. Shoqëria Koncesionare do të sigurohet (për aq sa është në kontrollin e saj) që emetimet në ajër, sipërfaqe dhe shkarkimet nëntokësore dhe shkarkimi dhe trajtimi i mbetjeve që krijohen nga veprimtaria e Shoqërisë Koncesionare në Sheshe dhe/ose në Vepër përgjatë Kohëzgjatjes së Kontratës do të kryhen në përputhje me Ligjin dhe Planin e Menaxhimit Mjedisor. Për shmangien e çdo dyshimi, Shoqëria Koncesionare nuk është përgjegjëse për ndotjen akustike dhe emetimet e shkaktuara nga realizimi i Punimeve dhe/ose Shërbimeve.

16.5 Shoqëria Koncesionare bie dakord se Projekt-Zbatimi i propozuar nga Shoqëria Koncesionare do t'i nënshtrohet procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis në përputhje me

Ligjin Nr. 10440, date 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar.

16.6 Shoqëria Koncesionare angazhohet që Nënkontraktorët e saj të respektojnë legjislacionin në fuqi që rregullon sigurinë në punë dhe që të plotësohen kërkesat në lidhje me të.

16.7 Shoqëria Koncesionare angazhohet që do të bashkëpunojë në çdo hetim të kryer nga Autoriteti Kontraktor, ose në emër të këtij të fundit, në lidhje me shkeljen e sigurisë në punë, ose të sigurisë së veprimtarisë për kryerjen e Punimeve ose Shërbimeve.

Neni 17. Deklarimet e Autoritetit Kontraktor

17.1 Autoriteti Kontraktor deklaron dhe garanton se:

- a) Ka ndjekur të gjitha procedurat ligjore në lidhje me organizimin e procedurave konkurruese, përzgjedhjes së Koncesionarit, negocimit dhe nënshkrimit të Kontratës.
- b) Përmbajtja e Kontratës nuk rezulton në ndonjë shkelje të ndonjë marrëveshjeje me Palë të Treta, të ndonjë Ligji tjetër të sektorëve të veçantë, të manualeve dhe rekomandimeve të dhëna nga autoritete të tjera sipas Ligjeve të veçanta, të ndonjë marrëveshjeje ndërkombëtare, traktati apo konvente, ku Autoriteti Kontraktor dhe Republika e Shqipërisë janë palë ose në bazë të të cilave kanë marrë angazhim.

17.2 Në lidhje me përshtatshmërinë e Të Dhënave të Vëna në Dispozicion të Koncesionarit dhe Shoqërisë Koncesionare, si dhe për çdo informacion tjetër që i është dhënë Koncesionarit apo Shoqërisë Koncesionare, Autoriteti Kontraktor do të marrë në kohë të gjitha masat e nevojshme, në lidhje me planifikimet buxhetore të financimeve që janë detyrim i Autoritetit Kontraktor apo që lindin si detyrime të tij, si rezultat i zbatimit të kësaj Kontrate.

17.3 Autoriteti Kontraktor nuk do të ngarkojë me përgjegjësi Shoqërinë Koncesionare për asnjë dëm që mund të ndodhë në Territorin e Projektit përpara datës kur bëhet marrja në Dorëzim e Territorit të Projektit. Shoqëria Koncesionare nuk do të mbajë asnjë përgjegjësi në lidhje me ndryshime të Projekt-Zbatimit, apo vonesa të zbatimit të Punimeve, që do të bëhen të nevojshme dhe do të lindin si rezultat i të metave të Territorit të Projektit që kanë ndodhur gjatë periudhës kur Autoriteti Kontraktor ka pasur administrimin dhe mirëmbajtjen e Territorit të Projektit dhe që nuk mund të zbuloheshin në përputhje me parashikimet e Neni 30 (*Inspektimi i Territorit të Projektit*).

17.4 Nëse Autoriteti Kontraktor ka dhënë pëlqimin apo ka rënë dakord për nënshkrimin apo ndryshimin e Dokumentacionit të Projektit, për ndjekjen e një plani të caktuar veprimi, apo kur ka hequr dorë me shkrim shprehimisht nga një dispozitë, Autoriteti Kontraktor deklaron se nuk do të ketë të drejtë të ngrejë pretendime kundër Koncesionarit apo Shoqërisë Koncesionare për shkak se Koncesionari apo Shoqëria Koncesionare ka vepruar duke respektuar vendimet e Autoritetit Kontraktor lidhur me dhënien e pëlqimit apo heqjen dorë nga ndonjë e drejtë e këtij të fundit.

Neni 18. Angazhimet e Autoritetit Kontraktor

18.1 Autoriteti Kontraktor angazhohet se do të ndërmarrë të gjithë hapat e duhur dhe do të japë të gjithë asistencën e nevojshme konkrete si dhe do të mbajë kontakte të vazhdueshme me Autoritetet Përkatëse kompetente, qendrore ose vendore, të cilat kanë kompetencë për lëshimin e Miratimeve të Nevojshme përkatëse kundrejt Shoqërisë Koncesionare në mënyrë që Autoritetet Përkatëse të

pajisin Koncesionarin/Shoqërinë Koncesionare me Miratimet e Nevojshme përkatëse, në kohë dhe pa vonesë në lidhje me zbatimin e Kontratës, për sa kohë që ky i fundit ka përmbushur detyrimet e tij për aplikim në përputhje me Ligjin.

18.2 Nga Data e Hyrjes në Fuqi e kësaj Kontrate dhe brenda një periudhe prej 12 (dymbëdhjetë) Muajsh, Autoriteti Kontraktor angazhohet për të siguruar me shpenzimet e veta nëpërmjet Autoritetit Përkatës për shpronësimet, përfundimin e procesit të Shpronësimeve me qëllim mundësimin e fillimit të punës në lidhje me një Segment, Rugën apo Vepër tjetër menjëherë dhe pa vonesa nga Shoqëria Koncesionare, në përputhje me afatet e përcaktuara në këtë Kontratë. Autoriteti Kontraktor do të ketë siguruar me shpenzimet e veta nëpërmjet Autoritetit Përkatës për shpronësimet, përfundimin e plotë të procesit të Shpronësimeve të parcelave, pronave brenda Shesheve, pa asnjë të metë, brenda afatit të përcaktuar në nenin 7.2 të kësaj Kontrate.

18.3 Autoriteti Kontraktor gjatë gjithë Kohëzgjatjes së kësaj Kontrate do të sigurojë mosçenimin nga Palë të Treta të aktivitetit të Shoqërisë Koncesionare si dhe do të ndërmarrë të gjitha masat për të zgjidhur problemet që Palë të Treta do të kenë në lidhje me zbatimin e kësaj Kontrate, sidomos lidhur me çështje të Shpronësimeve, shembjeve të objekteve në Shesh, apo të pretendimeve të tjera nga Palë të Treta, si dhe mbulimin e shpenzimeve që lidhen me to.

18.4 Autoriteti Kontraktor garanton se do të kryejë pa vonesë dhe në kohë, të gjitha Pagesat nga Autoriteti Kontraktor dhe detyrimet e tjera financiare kundrejt Shoqërisë Koncesionare, të parashikuara në këtë Kontratë. Po ashtu, Autoriteti Kontraktor garanton se do të ndërmarrë të gjitha masat për mbulimin e kostove përkatëse që sipas parashikimeve të kësaj Kontrate, i përkasin Autoritetit Kontraktor.

18.5 Autoriteti Kontraktor angazhohet se do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme dhe do të bashkëpunojë me mirëbesim me Shoqërinë Koncesionare dhe/ose Koncesionarin në mënyrë që ata të përmbushin kërkesat e Huadhënësve në lidhje me arritjen e Mbylljes Financiare, përfshirë hyrjen në Marrëveshjen e Drejtpërdrejtë nëse kërkohet nga Shoqëria Koncesionare, në përputhje me Modelin Financiar sipas rastit. Angazhimi sipas kësaj pike, nuk konsiston në angazhim për marrjen përsipër apo garantimin nga Autoriteti Kontraktor të detyrimeve financiare kundrejt Huadhënësve për financimin e Projektit.

18.6 Autoriteti Kontraktor do t'i garantojë Shoqërisë Koncesionare, vetë apo kur është rasti në bashkëpunim me Autoritetet e tjera Përkatëse, Gëzimin e Qetë dhe aksesin në Shesh gjatë gjithë Kohëzgjatjes së kësaj Kontrate, përfshirë, të drejtën për të hapur, ndërtuar, përdorur rrugët kombëtare apo lokale të aksesit për në Shesh dhe/apo lëvizjen në këto rrugë apo në rrugët e tjera për në Shesh të mjeteve të Shoqërisë Koncesionare pa pagesë, me përjashtim të rrugëve kombëtare me pagesë ("toll") për të cilat do bëjë pagesat përkatëse.

18.7 Autoriteti Kontraktor merr përsipër që, gjatë Kohëzgjatjes së Kontratës, të bëjë përpjekjet e tij më të mira për të ndihmuar Shoqërinë Koncesionare në përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Kontrate dhe në përputhje me të, si dhe të mos krijojë asnjë pengesë kundrejt Shoqërisë Koncesionare në lidhje me zbatimin e Kontratës.

18.8 Autoriteti Kontraktor do të marrë të gjitha masat që në bashkëpunim me Autoritetet Përkatëse t'i sigurojë Shoqërisë Koncesionare venddepozitime për mbetjet në lidhje me Punimet që do të kryhen në Shesh dhe do të bëjë përpjekjet e tij më të mira për të ndihmuar Shoqërinë Koncesionare për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshjeje me Palë të Treta në lidhje me to. Autoriteti Kontraktor do të bashkëpunojë me Shoqërinë Koncesionare për përzgjedhjen e këtyre venddepozitimeve në

mënyrë që (i) ato të jenë në distancë të arsyeshme nga Territori i Projektit, në mënyrë që Shoqëria Koncesionare të mos ketë kosto të paarsyeshme shtesë për transportin e mbetjeve (inerte, dhëra etj.) dhe (ii) të mos pengojë planet e zhvillimit të miratuara të Autoriteteve Përkatëse që kanë pronësinë e truallit ku planifikohet të bëhet venddepozitimi. Kostoja e transportit do të jetë në ngarkim të Shoqërisë Koncesionare.

Neni 19. Dhënia e Informacionit nga Autoriteti Kontraktor

19.1 Në Dokumentacionin e Tenderit, Autoriteti Kontraktor, brenda mundësisë së tij, ka vënë në dispozicion të Shoqërisë Koncesionare materiale dhe dokumente të cilat lidhen me Projektin dhe Territorin e Projektit ("**Të Dhënat e Vëna në Dispozicion**").

19.2 Autoriteti Kontraktor bën përpjekjet e tij të arsyeshme për të vënë në dispozicion të Shoqërisë Koncesionare çdo material tjetër, që mund të bjerë në dorë të tij gjatë Kohëzgjatjes së Kontratës dhe që është i llojit që do të ishte bërë i njohur në rast se do ekzistonte në kohën e vënies në dispozicion të të dhënave të disponueshme dhe që ka efekt për zbatimin e Kontratës së Koncesionit nga Shoqëria Koncesionare. Materiale të tilla shtesë konsiderohen Të Dhëna Të Vëna në Dispozicion në kohën që jepen (por jo më parë).

Neni 20. Bashkëpunimi dhe dokumentacioni

20.1 Shoqëria Koncesionare ka detyrimin të bashkëpunojë me Autoritetin Kontraktor dhe të zbatojë Punimet si dhe të gjitha angazhimet përkatëse të marra përsipër sipas Dokumentacionit të Ofertës, siç këto të fundit janë pasqyruar në mënyrë përfundimtare në Projekt-Zbatimin e dorëzuar pranë Autoritetit Kontraktor.

20.2 Përveç rasteve kur është parashikuar ndryshe në këtë Kontratë si dhe/ose kur veprimi dhe mosveprimi i Shoqërisë Koncesionare varet drejtpërdrejt dhe/ose vjen si rezultat i një veprimi dhe/ose mosveprimi të Autoritetit Kontraktor, Shoqëria Koncesionare nuk do të kryejë asnjë veprim me anë të të cilit një pjesë e Projektit përfundimtar do të bëhej i pavlefshëm ose do të ndryshohej (duke hequr dorë prej tij, duke mosvepruar, duke dhënë njoftim për përfundimin e tij, ose në çdo formë tjetër), pa pëlqimin e shprehur me shkrim të Autoritetit Kontraktor.

20.3 Autoriteti Kontraktor në të gjitha rastet bashkëpunon me mirëbesim dhe i ofron bashkëpunim dhe asistencë Koncesionarit apo Shoqërisë Koncesionare.

20.4 Nëse ndonjë veprim që kërkohet të kryhet nga Shoqëria Koncesionare në bazë të kësaj Kontrate, mund të kryhet vetëm nga Autoriteti Kontraktor dhe/ose ndonjë Autoritet Përkatës përfshirë por pa u kufizuar në devijimin dhe/apo kufizimin e trafikut në (i) Rrugë apo (ii) për në Shesh, Autoriteti Kontraktor bie dakord që, pas kërkesës me shkrim të Shoqërisë Koncesionare, ose ta kryejë vetë një veprim të tillë për llogari të Shoqërisë Koncesionare, ose t'i japë Shoqërisë Koncesionare një prokurë ose ndonjë të drejtë tjetër, nëse një gjë e tillë lejohet nga Ligji, për të bërë të mundur që Shoqëria Koncesionare të kryejë vetë një veprim të tillë. Në veçanti, për të garantuar sigurinë në Rrugë të Personave dhe ecurinë në kohë të Punimeve, Autoriteti Kontraktor do të marrë të gjitha masat që në bashkëpunim me Autoritetet Përkatëse, t'i mundësojë Shoqërisë Koncesionare akses të pakufizuar duke përfshirë, aty ku është e mundur dhe në bashkëpunim me Autoritetet Përkatëse, kufizimin e trafikut në segmentet e nevojshme për ndërtimin e rrugës Milot-Balldre. Mos kryerja e këtyre veprimeve nga Autoriteti Kontraktor, që do të shoqërohet me vonesa në zbatimin e detyrimeve të Shoqërisë Koncesionare dhe/apo kosto për të, do të konsiderohet një

Shkak Lehtësimi.

Neni 21. Përfaqësuesit e Palëve

21.1 Për efekt të kësaj Kontrate, Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor është një Person i autorizuar për të përfaqësuar Autoritetin Kontraktor në lidhje me realizimin e kësaj Kontrate, i njoftuar Shoqërisë Koncesionare me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

21.2 Veprimet ose udhëzimet e Përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktor, për aq sa parashikohen këtu, konsiderohen veprime ose udhëzime të Autoritetit Kontraktor, përveçse kur Autoriteti Kontraktor e njofton Shoqërinë Koncesionare paraprakisht me shkrim të paktën 10 (dhjetë) Ditë Pune më parë, që një veprim ose udhëzim i caktuar nuk është veprim ose udhëzim i Autoritetit Kontraktor.

21.3 Çdo kërkesë për t'i dhënë informacion ose dokumente Autoritetit Kontraktor, sipas Kontratës, është një kërkesë që dokumente të tilla t'i bëhen të njohura Përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktor, përveçse kur Autoriteti Kontraktor e vë në dijeni Shoqërinë Koncesionare për një Person tjetër, ose institucion, të cilit i duhen dërguar dokumente të tilla.

21.4 Përfaqësuesi i Shoqërisë Koncesionare është një Person i autorizuar për të përfaqësuar Shoqërinë Koncesionare në lidhje me zbatimin e kësaj Kontrate.

21.5 Veprimet ose udhëzimet e Përfaqësuesit të Shoqërisë Koncesionare, për aq sa ato parashikohen këtu, konsiderohen veprime ose udhëzime të Shoqërisë Koncesionare, përveçse kur Shoqëria Koncesionare e njofton Autoritetin Kontraktor që një veprim ose udhëzim i caktuar nuk është veprimi ose udhëzimi i saj.

21.6 Secila nga Palët mund ta zëvendësojë Përfaqësuesin respektiv duke i dërguar një njoftim me shkrim Palës tjetër të paktën 10 (dhjetë) Ditë Pune më përpara.

Neni 22. Njësia e Zbatimit të Projektit

22.1 Autoriteti Kontraktor do të krijojë Njësinë e Zbatimit të Projektit e cila do të kujdeset për zbatimin e suksesshëm të Projektit. Autoriteti Kontraktor do të plotësojë personelin e NJZP-së me personel të përshtatshëm teknik dhe administrativ.

22.2 Kreu i Njesisë së Zbatimit të Projektit mund të jetë Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor ose një Person tjetër, që caktohet nga Autoriteti Kontraktor në bazë të këtij Neni. Nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor apo Njësia e Zbatimit të Projektit Autoriteti Përkatës për rrugët mund të kryejë monitorimin e zbatimit në terren të Punimeve dhe Shërbimeve të kësaj Kontrate, për të cilat do t'i relatojë përkatësisht Autoritetit Kontraktor apo Njesisë së Zbatimit të Projektit që ka paraqitur kërkesën.

KREU 3 PRONËSIA DHE PËRDORIMI I PRONËS

Neni 23. Territori i Projektit

23.1 "Territori i Projektit" është:

- a) Toka (pavarësisht statusit të saj, truall, tokë bujqësore, livadh, etj.) mbi të cilën do të bëhet realizimi i Veprës, sipërfaqet për hyrje dhe dalje dhe rrugët lidhëse me Rrugën, territori i rrugës alternative sipas kuptimit të nenit 34.3 të Kontratës, zona ose zonat në të cilën do të

vendosen dhe në të cilën do të kryhen aktivitetet dhe Shërbimet e lidhura me ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Veprës; dhe

b) Trualli Shtesë.

23.2 Autoriteti Kontraktor deklaron se do të ndërmarrë masat e nevojshme për të qenë poseduesi i ligjshëm i Territorit të Projektit ku do të shtrihet Rruga, si dhe do t'i Dorëzojë Territorin e Projektit Shoqërisë Koncesionare, në përputhje me afatet e parashikuara në këtë Kontratë dhe, gjithsesi, përpara Datës së Fillimit Punimeve. Pavarësisht përcaktimit në këtë paragraf, Autoriteti Kontraktor do ta lejojë Shoqërinë Koncesionare që të futet në të gjitha pjesët e Territorit të Projektit me qëllim për të kontrolluar kushtet e tij, duke filluar nga Data e Nënshkrimit.

23.3 Autoriteti Kontraktor garanton se do të kryejë Dorëzimin e Territorit të Projektit të Shoqëria Koncesionare të lirë nga çdo barrë apo të drejta të Palëve të Treta. Në përputhje me parashikimet të Neni 7 (*Mospërbushja e Kushteve Paraprake*) të Kontratës, çdo shkelje nga Autoriteti Kontraktor e kësaj dispozite ose ekzistenca e të drejtave të Palëve të Treta, do të konsiderohet sipas rastit si Shkak Lehtësimi.

23.4 Autoriteti Kontraktor i jep mundësi Shoqërisë Koncesionare të hyjë e të dalë në Territorin e Projektit dhe e lejon ta përdorë atë territor, përfshirë të drejtat mbi tokën dhe servitutet për linjat e transmetimit dhe rrjetet e infrastrukturës publike apo të transportit, pa e penguar gjatë gjithë Kohëzgjatjes së Kontratës.

23.5 Autoriteti Kontraktor pranon që gjatë gjithë Kohëzgjatjes së Kontratës, nuk do të transferojë Territorin e Projektit apo ndonjë pjesë të tij, apo ndonjë interes të lidhur me të, përveçse në përputhje me këtë Kontratë.

23.6 Kostot dhe shpenzimet e Dorëzimit të Territorit të Projektit përballohen nga Autoriteti Kontraktor. Autoriteti Kontraktor është dakord se çdo kosto, dëm, pengesë apo vonesë në zbatimin e kësaj Kontrate nga ana e Shoqërisë Koncesionare, pasi vërtetohet nga ana e Inxhinierit të Pavarur, për arsye që lidhen me Shpronësimet apo marrjen në kontroll të Territorit të Projektit, nga Autoritetet Përkatëse ose Palët e Treta do të jetë një Shkak Lehtësimi, përveç rasteve kur kjo vonesë është shkaktuar nga veprimet apo mosveprimet me faj të Shoqërisë Koncesionare.

23.7 Të gjitha shpenzimet apo Taksat (nëse mund të ketë të tilla), për regjistrimin e pronësisë së Autoritetit Kontraktor mbi Veprën ose pjesë të saj në ASHK dhe/ose kosto të tjera që rrjedhin nga aktet ligjore apo nënligjore në lidhje me regjistrimin e kontratës do të përballohen nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 24. Trualli Shtesë dhe Trualli Ekstra

24.1 Nëse Shoqëria Koncesionare kërkon ndonjë Truall Shtesë për Territorin e Projektit, me qëllim përmbushjen e ndonjërit prej detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate, truall i cili më pas jo detyrimisht bëhet pjesë e Rugës, për aq sa Inxhinieri i Pavarur vërteton se një Truall i tillë Shtesë kërkohet nga Shoqëria Koncesionare për plotësimin e detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate (dhe se detyrimet përkatëse nuk mund të respektohen përmes përdorimit vetëm të Territorit të Projektit, ose të tokës që aktualisht zotërohet dhe/apo është në administrim nga shteti), atëherë Autoriteti Kontraktor ofron një Truall Shtesë sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur. Të gjitha kostot e kërkuara gjatë procesit të përfutimit të Truallit Shtesë me anë të Shpronësimeve, do të paguhën nga Autoriteti Kontraktor. Vonesat e Autoritetit Kontraktor për të zbatuar detyrimet e këtij Neni do të

jenë Shkak Lehtësimi.

24.2 Me marrjen e të drejtave ose miratimit për të përdorur Truallin Shtesë nga Shoqëria Koncesionare, të drejtat ose një përfitim i tillë për të përdorur Truallin Shtesë, i cili i mbetet Shoqërisë Koncesionare deri në Datën e Përfundimit të Kontratës, përveçse kur është rënë dakord paraprakisht për një datë tjetër, do t'i transferohen Autoritetit Kontraktor në Datën e Përfundimit të Kontratës ose në datën tjetër të dakordësuar midis Palëve.

24.3 Kur Shoqëria Koncesionare kërkon të përdorë përkohësisht Truall Ekstra, përveç Territorit të Projektit, me qëllim përmbytjen e ndonjërit prej detyrimeve të saj, sipas kësaj Kontrate, për aq sa Inxhinieri i Pavarur vërteton se një Truall i tillë Ekstra kërkohet për plotësimin e detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate, (dhe se detyrimet përkatëse nuk mund të respektohen përmes përdorimit vetëm të Territorit të Projektit, ose të tokës që aktualisht zotërohet nga shteti, apo të Truallit Shtesë), Autoriteti Kontraktor nëpërmjet Autoritetit Përkatës, me shpenzimet e tij, kryen procedurën e marrjes në përdorim të përkohshëm të këtij Truall Ekstra sipas legjislacionit në fuqi për Shpronësimet. Vonesat e Autoritetit Kontraktor për të zbatuar detyrimet e këtij Neni do të jenë Shkak Lehtësimi.

KREU 4 INXHINIERI I PAVARUR

Neni 25. Përzgjedhja e Inxhinierit të Pavarur

25.1 Autoriteti Kontraktor do të përgatisë dokumentacionin e prokurimit publik që kërkohet për përzgjedhjen e Inxhinierit të Pavarur. Një dokumentacion i tillë do të përmbajë por nuk do të kufizohet me:

- a) Objektin e punës së Inxhinierit të Pavarur, i cili do të bazohet në dispozitat që përmbahen në Shtojcën 5 (*Detyrat Kryesore të Inxhinierit të Pavarur*) siç amendohet dhe zgjerohet nga Palët;
- b) Kriteret, mbi të cilat do të përzgjidhet Inxhinieri i Pavarur; dhe
- c) Dispozitat thelbësore të kontratës për emërimin dhe detyrat e Inxhinierit të Pavarur, sipas detyrave kyç, të përcaktuara në Shtojcën 5 (*Detyrat Kryesore të Inxhinierit të Pavarur*).

25.2 Autoriteti Kontraktor do të bëjë të gjithë përpjekjet e mundshme për të kontraktuar Inxhinierin e Pavarur brenda 12 (dymbëdhjetë) Muajsh nga Data e Hyrjes në Fuqi e kësaj Kontrate, por gjithsesi brenda afateve të zgjatura në përputhje me përcaktimet e dhëna te Neni 7 (*Mospërmbytja e Kushteve Paraprake*). Përzgjedhja e Inxhinierit të Pavarur do të bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, bazuar në dokumentacionin e miratuar në përputhje me Nenin 25 (*Përzgjedhja e Inxhinierit të Pavarur*). Palët bien dakort që Inxhinieri i pavarur do të ushtrojë funksionet e tij përgjatë të gjithë Periudhës së Koncesionit. Marreveshja fillestare e Inxhinierit të Pavarur bëhet të paktën për një kohë deri në mbarimin e Periudhës së Përgjegjësisë së Defekteve.

25.3 Në rast se Inxhinieri i Pavarur nuk emërohet në kohën e përcaktuar në këtë Nen, apo në rast se veprimtaria e tij në funksion të zbatimit të kësaj Kontrate dhe Kontratës së Inxhinierit të Pavarur pezullohet, ndalohet apo braktiset për çfarëdolloj arsye, Palët bien dakord që Autoriteti Kontraktor

apo ndonjë Person i autorizuar/emëruar nga ai (Inxhinier/Supervizor i Përkohshëm), do të kryejë funksionin e Inxhinierit të Pavarur deri në emërimin e Inxhinierit të Pavarur apo zëvendësimin e tij.

25.4 Autoriteti Kontraktor detyrohet të emërojë dhe/ose zëvendësojë Inxhinierin e Pavarur brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga njoftimi që Shoqëria Koncesionare do t'i dërgojë Autoritetit Kontraktor për emërimin apo zëvendësimin e Inxhinierit të Pavarur. Në rast të vonesave të pajustificuara nga ana e Autoritetit Kontraktor në emërimin ose zëvendësimin e Inxhinierit të Pavarur të cilat shkaktojnë vonesa në afatet e kryerjes së Punimeve nga ana e Shoqërisë Koncesionare, atëherë kjo e fundit do të përfitojë shtyrje të këtyre afateve përkatëse në të njëjtën kohëzgjatje të vonesave.

25.5 Inxhinieri i Pavarur i kryen detyrimet e tij në përputhje me dispozitat e Shtojcës 5 (*Detyrat Kryesore të Inxhinierit të Pavarur*) të kësaj Kontrate. Ndër të tjera, Autoriteti Kontraktor lidh një Kontratë me Inxhinierin e Pavarur, me objekt, të drejtat dhe detyrimet e Inxhinierit të Pavarur.

Neni 26. Kontrata me Inxhinierin e Pavarur

Kontrata e Inxhinierit të Pavarur përmban (ndër të tjera) kushtet e mëposhtme:

- a) Kostot e lindura në lidhje me përzgjedhjen, emërimin dhe punën e Inxhinierit të Pavarur përballohen nga Autoriteti Kontraktor;
- b) Inxhinieri i Pavarur i plotëson detyrimet e tij për raportim tek Autoriteti Kontraktor dhe të Shoqëria Koncesionare drejtpërdrejt dhe njëkohësisht;
- c) Objekti i shërbimeve dhe tërësia e të drejtave dhe e detyrimeve të Inxhinierit të Pavarur janë në përputhje me Kontratën, e cila përmban detyrimet kryesore të Inxhinierit të Pavarur të përcaktuara në Shtojcën 5 (*Detyrat Kryesore të Inxhinierit të Pavarur*);
- d) Përpara zgjidhjes së një mosmarrëveshjeje, Inxhinieri i Pavarur u jep Autoritetit Kontraktor dhe Shoqërisë Koncesionare mundësinë që të shprehin mendimet e tyre në lidhje me çështjen përkatëse;
- e) Inxhinieri i Pavarur i ofron shërbimet e tij, në çdo kohë dhe në të gjitha rrethanat, në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate si dhe Kontratës së Inxhinierit të Pavarur dhe këtë e bën në mënyrë të paanshme e të pavarur;
- f) Shoqëria Koncesionare ka të drejtë të konsultohet me Inxhinierin e Pavarur në lidhje me të gjitha aspektet e çdo çështjeje që ka të bëjë me Punimet ose me ndonjë Riparim Kapital si dhe përlllogaritjes vjetore të Tarifës në përputhje me Nenin 72;
- g) Shoqëria Koncesionare ka të drejtë të kërkojë tek Autoriteti Kontraktor fillimin e procedurave për zgjidhjen e Kontratës së Inxhinierit të Pavarur, ose zëvendësimin e Inxhinierit të Pavarur në rast të shkeljeve të dispozitave të Kontratës apo të Kontratës së Inxhinierit të Pavarur nga ana e këtij të fundit, si dhe në rast të pengesave të pajustificuara dhe të përsëritura të Inxhinierit të Pavarur kundrejt Shoqërisë Koncesionare, në përmbushjen e detyrimeve të këtij të fundit sipas kësaj Kontrate;
- h) Në rast të zgjidhjes së parakohshme të Kontratës së Inxhinierit të Pavarur nga ana e Autoritetit Kontraktor, ky i fundit do ta njoftojë Shoqërinë Koncesionare paraprakisht

brenda 30 (tridhjetë) Ditë Pune, duke paraqitur së bashku me njoftimin me shkrim edhe arsyet e zgjidhjes së parakohshme të Kontratës me Inxhinierin e Pavarur.

Neni 27. Inspektimet e Inxhinierit të Pavarur

27.1 Inxhinieri i Pavarur kryen inspektime për të verifikuar dhe ndjekur kryerjen e Punimeve nga ana e Shoqërisë Koncesionare sipas Projekt-Zbatimit.

27.2 Gjatë Periudhës Ndërtimore Inxhinieri i Pavarur do të kontrollojë dhe mbikëqyrë Punimet. Një kontroll i tillë përfshin ndjekjen e aktivitetit në çdo fazë të punës, me qëllim për të siguruar që Punimet po kryhen në përputhje me kërkesat e cilësisë së Autoritetit Kontraktor, Standardet, si dhe në përputhje me Projekt-Zbatimin e miratuar.

27.3 Inxhinieri i Pavarur ka të drejtë të ndjekë takimet për ecurinë e Punimeve, të cilat zhvillohen ndërmjet Shoqërisë Koncesionare dhe Nënkontraktorëve Ndërtimorë, dhe të marrë njoftimet përkatëse për kohën dhe vendin e takimeve të tilla.

Neni 28. Mosdakordësimi me Qëndrimet e Inxhinierit të Pavarur

28.1 Nëse ndonjëra nga Palët është e pakënaqur me qëndrimet/punën e Inxhinierit të Pavarur, atëherë kjo Palë e njofton Palën tjetër brenda 15 (pesëmbëdhjetë) Ditësh Pune nga marrja e njoftimit përkatës nga Inxhinieri i Pavarur, me kusht që në asnjë rrethanë Shoqëria Koncesionare të mos ketë të drejtë të pezullojë, ndalojë ose ndërpresë në ndonjë mënyrë tjetër Punimet gjatë procesit të zgjidhjes së një mosmarrëveshjeje të tillë, me përjashtim të punëve që preken drejtpërdrejt nga mosmarrëveshja, si dhe të punëve përfundimi apo kryerja e të cilave varet drejtpërdrejt nga rezultati i zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Në rast se njëra Palë është e pakënaqur me vendimin e Inxhinierit të Pavarur, aplikohet Neni 132 (*Përshkallëzimi dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve*) i kësaj Kontrate, me përjashtim të rasteve që lidhen me vendime për një Shkak Lehtësimi, rast në të cilin do të zbatohen parashikimet te Neni 80.1 (*Shkaku i Lehtësimit*).

28.2 Për shmangien e çdo dyshimi, Shoqëria Koncesionare nuk mban përgjegjësi për mospërmbyshjen e ndonjë detyrimi ose përgjegjësie të saj, në rast se kjo mospërmbyshje vjen për shkak të mospërmbyshjes së detyrimeve nga Inxhinieri i Pavarur, në përputhje me këtë Kontratë si dhe Kontratën e Inxhinierit të Pavarur.

Neni 29. Zëvendësimi i Inxhinierit të Pavarur

Në rast se veprimtaria e Inxhinierit të Pavarur në funksion të zbatimit të kësaj Kontrate dhe Kontratës së Inxhinierit të Pavarur pezullohet, ndalohet apo braktiset për çfarëdolloj arsye, Shoqëria Koncesionare dhe Autoriteti Kontraktor përsërisin procesin e përshkruar te Neni 25 (*Përzgjedhja e Inxhinierit të Pavarur*) për zëvendësimin e tij.

KREU 5 NDËRTIMI, TERRITORI I PUNIMEVE TË PROJEKTIT DHE KUSHTET E TOKËS

Neni 30. Inspektimi i Territorit të Projektit

30.1 Pa cenuar përfitimet apo Të Drejtat e Shoqërisë Koncesionare sipas kësaj Kontrate, Shoqëria Koncesionare garanton se:

- a) aq sa ishte e mundur ka inspektuar dhe kontrolluar Territorin e Projektit dhe mjediset përreth dhe, sipas rastit, të gjitha strukturat që gjenden në gjithë hapësirën e Territorit të Projektit;
- b) aq sa është e mundur, duke marrë në konsideratë dhe përdorur kujdesin e zakonshëm profesional si dhe Praktikën e Mirë të Industrisë, është njohur dhe ka marrë dijeni për (i) natyrën e kushteve klimatike, hidrologjike, gjeologjike, ekologjike, mjedisore dhe të përgjithshme të Territorit të Projektit dhe rrethinat e tij, (ii) natyrën e tokës dhe nëntokës, duke përfshirë të gjitha kushtet nënsipërfaqësore (iii) formën dhe natyrën e Territorit të Projektit, (iv) rrezikun e dëmtimit apo të dëmit ndaj pronave pranë tij, apo rreziqet që prekin Territorin e Projektit dhe pronarët e atyre pronave, (v) natyrën e materialeve (natyrore ose jo) që do të gërmohen, dhe (vi) natyrën e Projektit, punën, impiantet dhe materialet e nevojshme për Projektin.

30.2 Autoriteti Kontraktor nuk është përgjegjës para Shoqërisë Koncesionare për ndonjë pasaktësi, mosveprim, papërshtatshmëri për ndonjë qëllim, apo për pamjaftueshmëri të ndonjë lloji, cilado qoftë, të ndonjë vrojtimi topografik, që Autoriteti Kontraktor i paraqet dhe i vendos në dispozicion apo i miraton Shoqërisë Koncesionare, kur konstatimi i këtyre mangësive me efekte negative ndaj Shoqërisë Koncesionare do të ishte lehtësisht i mundshëm për t'u evidentuar nga Koncesionari/Shoqëria Koncesionare duke ushtruar kujdes të zakonshëm profesional si dhe në respekt të Praktikave të Mirë të Industrisë.

Neni 31. Objektet Arkeologjike ose Objektet e Trashëgimisë Kulturore

31.1 Gjatë fazës së hartimit të tij, Projekt-Zbatimi duhet të paraqitet për shqyrtim dhe vendimmarje në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale.

31.2 Në rastin e zbulimit të ndonjë Objekti Arkeologjik ose Objekti Trashëgimie Kulturore në Territorin e Projektit, pas datës në të cilën Autoriteti Kontraktor i ka Dorëzuar Shoqërisë Koncesionare Territorin e Projektit, apo në raste kur gërmimi për Objekte Arkeologjike ose Objekte të Trashëgimisë Kulturore ka filluar përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe nuk është përfunduar në kohën e Dorëzimit të Territorit të Projektit, Shoqëria Koncesionare, sipas rastit kryen veprimet e mëposhtme:

- a) njofton menjëherë Autoritetin Kontraktor si dhe Autoritetet e tjera Përkatese si dhe ndërmerr të gjitha hapat e nevojshëm që i kërkojnë nga Ligji një operatori që kryen punime në lidhje me Objektin Arkeologjik ose Objektet e Trashëgimisë Kulturore;
- b) ndërmerr hapa të tillë që mund të kërkojnë me Ligj nga çdo Autoritet Përkates, të cilët mund të përfshijnë ndërprerjen dhe moskryerjen e Punimeve që mund të pengojnë gërmimet e Objektit Arkeologjik ose Objektet e Trashëgimisë Kulturore, ose që mund të kenë ndonjë pasojë mbi Objektin Arkeologjik ose Objektet e Trashëgimisë Kulturore në ndonjë mënyrë; dhe
- c) ndërmerr të gjithë hapat e arsyeshëm për të ruajtur Objektin Arkeologjik ose Objektet e Trashëgimisë Kulturore në të njëjtin pozicion dhe gjendje në të cilën janë gjetur.

31.3 Pas njoftimit të Shoqërisë Koncesionare, Autoriteti Kontraktor do të informojë Autoritetet Përkatese dhe do bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të siguruar që ata në mënyrë të shpejtë e të koordinuar të hulumtojnë Objektet Arkeologjike dhe Objektet e Trashëgimisë Kulturore në

lidhje me këto Sheshe.

31.4 Në rast se raporti i Autoriteteve Përkatëse tregon mundësinë e heqjes së Objekteve Arkeologjike ose Objekteve të Trashëgimisë Kulturore nga Sheshet, Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë të gjitha shpenzimet e heqjes së Objekteve Arkeologjike dhe/apo Objekteve të Trashëgimisë Kulturore.

31.5 Në rast se raporti me shkrim i Autoriteteve Përkatëse tregon se Punimet nuk mund të vazhdojnë në Sheshin apo Segmentin në të cilin Objektet Arkeologjike apo Objektet e Trashëgimisë Kulturore u zbuluan, Autoriteti Kontraktor mund të vendosë t'i japë Shoqërisë Koncesionare një truall tjetër (i cili do të kthehet në Truall Shtesë), i cili siguron realizimin praktik të Objektit të Kontratës me karakteristika të ngjashme në një kohë sa më shkurtër, dhe të pezullojë të gjitha afatet deri sa Shoqëria Koncesionare të vihet në të njëjtat kushte siç ishte përpara pezullimit të Punimeve si më sipër.

31.6 Autoriteti Kontraktor dhe/ose Autoriteti Përkatës duhet të paguajë shpenzimet e transferimit të Punimeve për zëvendësimin e Sheshit apo Segmentit përkatës, me kusht, që Shoqëria Koncesionare të sigurojë gjithë ndihmën e arsyeshme për të ndihmuar Autoritetin Kontraktues të minimizojë kostot përkatëse dhe vonesat.

31.7 Nëse ndodh ndonjë vonesë në kryerjen e Punimeve si rezultat i gërmimeve për zbulimin ose largimin e Objekteve Arkeologjike apo Objekteve të Trashëgimisë Kulturore, ose të ndonjë pune tjetër të nevojshme të kryer në lidhje me Objektet Arkeologjike apo Objektet e Trashëgimisë Kulturore të zbuluara ose përpara Dorëzimit të Territorit të Projektit (kur një punë e tillë nuk është përfunduar përpara Dorëzimit të Territorit të Projektit), ose që është zbuluar pas Dorëzimit të Territorit të Projektit, atëherë kjo vonesë do të përbëjë Shkak Lehtësimi.

31.8 Të gjitha Objektet Arkeologjike ose Objektet e Trashëgimisë Kulturore janë pronë e Republikës së Shqipërisë.

Neni 32. Veprimet në përputhje me Ligjin

Gjatë Kohëzgjatjes së Kontratës Shoqëria Koncesionare do të veprojë në përputhje të plotë me Ligjin dhe kërkesat e Miratimeve të Nevojshme si dhe Miratimeve të Nevojshme të Autoritetit Kontraktor.

Neni 33. Lejet ekzistuese dhe Miratimet e Nevojshme të Autoritetit Kontraktor

33.1 Autoriteti Kontraktor i miraton Shoqërisë Koncesionare të gjitha Miratimet e Nevojshme të Autoritetit Kontraktor, të cilat disponohen dhe janë kompetencë e Autoritetit Kontraktor, dhe bën të gjitha përpjekjet që Autoritetet Përkatëse të bëjnë të njëjtën gjë me Miratimet e Nevojshme që janë në kompetencë të tyre, menjëherë pas aplikimit të Shoqërisë Koncesionare, me qëllim që kjo e fundit të fillojë dhe të përfundojë Punimet në përputhje me Projekt-Zbatimin, për sa kohë që Shoqëria Koncesionare ka përmbushur detyrimet për aplikim në përputhje me ligjin..

33.2 Autoriteti Kontraktor angazhohet se do të mbështesë Shoqërinë Koncesionare për dhënien dhe zbardhjen e Lejes së Ndërtimit për të gjithë Projektin, ose pjesë-pjesë për faza të ndara të Punimeve të Ndërtimit, sipas zgjedhjes dhe aplikimit për Miratimet e Nevojshme përkatëse dhe/apo Miratimet e Nevojshme të Autoritetit Kontraktor, përfshirë por pa u kufizuar në Lejen/Lejet e Ndërtimit, me qëllim fillimin e Punimeve menjëherë dhe pa vonesa nga Shoqëria

Koncesionare, si edhe dhënien Shoqërisë Koncesionare të Certifikatës/ave përkatëse të Përdorimit lëshuar nga Autoriteti Përkatës në fushën e zhvillimit të territorit.

33.3 Në rastin kur Miratimet e Nevojshme dhe/apo Miratimet e Nevojshme të Autoritetit Kontraktor, me qëllim fillimin dhe vazhdimin e Punimeve në përputhje me Projekt-Zbatimin, nuk jepen brenda afateve të përcaktuara nga Ligji apo kjo Kontratë, atëherë kjo do të konsiderohet si Shkak Lehtësimi përveç rasteve kur Shoqëria Koncesionare nuk ka përmbushur kërkesat dhe formalitetet ligjore përkatëse.

33.4 Në rastin kur një leje ekzistuese ose Miratimi i Nevojshëm i Autoritetit Kontraktor apo i një Autoriteti Përkatës hiqet, revokohet, ndryshohet (jo me kërkesë të Shoqërisë Koncesionare), pezullohet ose ndryshe deklarohet e pavlefshme, për shkak të një veprimi të gabuar ose të një mosveprimi që nuk ka ardhur si rrjedhojë e veprimeve dhe/apo mosveprimeve të Shoqërisë Koncesionare, atëherë kjo do të konsiderohet si Shkak Lehtësimi.

33.5 Autoriteti Kontraktor do të jetë përgjegjës për aplikimin dhe marrjen e të gjitha Miratimeve të Nevojshme që dalin në emër dhe për llogari të tij. Dokumentacioni ndihmës për këto aplikime përgatitet nga Shoqëria Koncesionare. Shoqëria Koncesionare do të jetë përgjegjëse për aplikimin dhe përmbushjen e të gjitha kërkesave dhe formaliteteve ligjore që duhen për marrjen e të gjitha lejeve dhe miratimeve shtesë (nëse duhen të tilla pas lejeve dhe miratimeve fillestare) të nevojshme pranë Autoritetit Kontraktor apo Autoriteteve Përkatëse, vetëm në rastet kur aplikimi dhe/ose marrja e këtyre lejeve apo miratimeve shtesë bëhet në emër dhe për llogari të Shoqërisë Koncesionare, ose dokumentacioni shtesë duhet të paraqitet edhe në emër të Shoqërisë Koncesionare.

33.6 Autoriteti Kontraktor garanton dhe angazhohet se do të bëjë çdo përpjekje për të mbështetur Shoqërinë Koncesionare në marrjen e të gjitha Miratimeve të Nevojshme, si dhe do të bëjë të gjitha përpjekjet për të siguruar që, në varësi të përmbushjes nga ana e Shoqërisë Koncesionare të të gjitha kërkesave dhe formaliteteve ligjore, Miratimet e Nevojshme të lëshohen dhe miratohen nga ana e Autoriteteve Përkatëse. Në rast të vonesave në zbatimin e detyrimeve të Shoqërisë Koncesionare sipas kësaj Kontrate, të shkaktuara si pasojë e mosdhënies apo vonesave të lëshimit të Miratimeve të Nevojshme nga Autoritetet Përkatëse apo Autoritetit Kontraktor, jo për faj të Shoqërisë Koncesionare, atëherë këto vonesa mund të përbëjnë një Shkak Lehtësimi.

Neni 34. Dokumentacioni i Projektit

34.1 Në Dokumentacionin e Ofertës, Koncesionari i ka vënë në dispozicion Autoritetit Kontraktor gjurmën dhe informacione të tjera në lidhje me Projektin (“**Projekt-Ideja**”). Shoqëria Koncesionare ka të drejtë t’i modifikojë Skicat e Ndërtimit e të projektimit gjatë hartimit të Projekt-Zbatimit.

34.2 Projekti i hollësishëm përfundimtar do të konsiderohet në këtë Kontratë si Projekt-Zbatimi (në vijim “**Projekt-Zbatimi**”) dhe së bashku me Projekt-Idenë dhe Skicat e Zbatimit “**Dokumentacioni i Projektit**”), dhe do të bëhet pjesë integrale e kësaj Kontrate. Në rast të një mospërputhjeje me Projekt-Idenë ka përparësi Projekt-Zbatimi i miratuar.

34.3 Shoqëria Koncesionare harton Projekt-Zbatimin në mënyrë të tillë që të jetë në përputhje me: a) Dokumentacionin e Ofertës dhe b) rrugën alternative të kategorisë C, e cila duhet të jetë e pozicionuar në një distancë prej rreth 1 km, por jo më shumë se 1.5 km nga aksi kryesor i rrugës Milot-Balldre, në rast se Shoqëria Koncesionare zgjedh të shfrytëzojë rrugën ekzistuese.

Nëse Shoqëria Koncesionare vendos të ndërtojë një aks të ri jashtë aksit ekzistues, rruga ekzistuese mund të shfrytëzohet si rrugë alternative pa pagesë, për sa kohë që respektohen parametrat e kategorisë dhe distancës të përcaktuara më sipër, si dhe pas marrjes së dakordësimit nga Autoriteti Kontraktues dhe Autoriteti Përkatës përgjegjës për rrugët. Shoqëria Koncesionare siguron që të gjitha Skicat e Ndërtimit të hollësishme dhe përfundimtare të projektimit në kuadër të Projekt-Zbatimit të jenë në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktor dhe Autoritetin Përkatës përgjegjës për rrugët, si dhe të rregullave të përcaktuara në legjislacionin përkatës për projektimin. Autoriteti Kontraktor angazhohet maksimalisht dhe bën përpjekjet për marrjen e të gjitha Miratimeve të Nevojshme për Projekt-Zbatimin.

34.4 Miratimi i Projekt-Zbatimit, si rregull do të ndjekë këto hapa:

- a) Shoqëria Koncesionare e dorëzon Projekt-Zbatimin tek Autoriteti Kontraktor si rregull brenda 3 (tre) Muajsh nga Data e Hyrjes në Fuqi të Kontratës.
- b) Brenda 20 (njëzetë) Ditësh Pune nga dorëzimi i Projekt-Zbatimit nga ana e Shoqërisë Koncesionare, Autoriteti Kontraktor e dërgon Projekt-Zbatimin për oponencë teknike tek Autoriteti Përkatës. Autoriteti Përkatës brenda 20 (njëzetë) Ditësh Pune do të dërgojë tek Autoriteti Kontraktues oponencën teknike të Projekt – Zbatimit të Shoqërisë Koncesionare. Marrja e oponencës teknike nuk duhet të tejkalojë afatin 45 (dyzetë e pesë) Ditësh Pune nga data e paraqitjes së Projekt Zbatimit të Shoqërisë Koncesionare tek Autoriteti Kontraktor.
- c) Brenda 20 (njëzetë) Ditësh Pune nga marrja e oponencës teknike nga Autoriteti Përkatës, Autoriteti Kontraktor e dërgon Projekt-Zbatimin dhe oponencën teknike për shqyrtim dhe miratim tek Autoriteti Përkatës përgjegjës për rrugët.
- d) Autoriteti Përkatës përgjegjës për rrugët, duhet të shprehet dhe ti dorëzojë komentet e tij në lidhje me Projekt-Zbatimin te Autoriteti Kontraktor brenda 30 (tridhjetë) Ditëve Pune.
- e) Brenda 20 (njëzetë) Ditëve Pune nga marrja e komenteve në lidhje me Projekt-Zbatimin nga Autoriteti Përkatës përgjegjës për rrugët, Autoriteti Kontraktor bën komentet e tij për dokumentacionin e Projekt-Zbatimit, nëse ka, dhe i komunikon ato te Shoqëria Koncesionare. Komentet e Autoritetit Kontraktor lidhen vetëm me rastet kur Projekt-Zbatimi nuk është në përputhje me kërkesat dhe Dokumentacionin e Ofertës të paraqitur nga Koncesionari, si dhe me Ligjin në fuqi. Nëse Autoriteti Kontraktor dhe/ose Autoriteti Përkatës përgjegjës për rrugët, nuk kanë komente në lidhje me Projekt-Zbatimin, atëherë Autoriteti Kontraktor do të dërgojë miratimin e tij brenda të njëjtut afat të përcaktuar në fjalinë pararendëse.
- f) Në rastin kur Autoriteti Kontraktor ose Autoriteti Përkatës përgjegjës për rrugët, paraqet komente në lidhje me Projekt-Zbatimin, atëherë

Palët dhe/ose Autoriteti Përkatës do të takohen brenda 15 (pesëmbëdhjetë) Ditëve Pune nga marrja e komenteve nga ana e Shoqërisë Koncesionare për të diskutuar mbi komentet e paraqitura dhe për të vendosur lidhur me aplikueshmërinë e tyre në Projekt-Zbatim, nëse një gjë e tillë kërkohet nga Shoqëria Koncesionare.

- g) Shoqëria Koncesionare ka afat 30 (tridhjetë) Ditë Pune nga dita e takimit (ose, nëse nuk ka kërkuar takim, nga dita e marrjes së komenteve) për të rregulluar Projekt-Zbatimin në përputhje me komentet dhe për ta dorëzuar Projekt-Zbatimin e rregulluar tek Autoriteti Kontraktor, si dhe tek Autoriteti Përkates përgjegjës për rrugët që ka parashtruar komentet.
- h) Pas dorëzimit nga ana e Shoqërisë Koncesionare, Autoriteti Kontraktor, si dhe Autoriteti përkatës që ka parashtruar komentet, kanë një afat 20 (njëzetë) Ditë Pune nga data e dorëzimit të Projekt-Zbatimit, për të miratuar këtë të fundit. Në rast se Autoriteti Kontraktor nuk shprehet brenda një afati prej 20 (njëzetë) Ditësh Pune, atëherë kjo do të përbëjë Shkak Lehtësimi.

Neni 35. Ndërtimi

35.1 Shoqëria Koncesionare do t'i kryejë Punimet në përputhje me periudhën ndërtimore, Projekt-Zbatimin si dhe në përputhje me Standardet, përveç rasteve të shtyrjeve të afateve që mund të ndodhin në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate.

35.2 Shoqëria Koncesionare do të kryejë dhe përfundojë Punimet:

- a) në varësi të ndryshimeve që mund të ndodhin në bazë të dispozitave të Kontratës, në përputhje me afatet e propozuara në Projekt-Zbatim;
- b) në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate, kërkesat, Standardet, propozimet e saj për Punimet dhe Praktikrat e Mira të Industrisë;
- c) në mënyrë të tillë që mund të sigurojë marrjen e lejeve të shfrytëzimit në lidhje me zbatimin e Projekt-Zbatimit dhe ndërtimit të Rrugës, jo më vonë se data përfundimtare e lejes së shfrytëzimit;
- d) duke përdorur ekskluzivisht materiale dhe pajisje për Punimet, të cilat janë zgjedhur profesionalisht bazuar në Praktikrat e Mira të Industrisë në përputhje me kërkesat dhe Standardet; dhe
- e) në përputhje me rregullat e sigurimit teknik në punë si dhe Kuadrin Ligjor.

Neni 36. Rrethana të veçanta gjatë fazës së ndërtimit, zgjatja e afatit të përfundimit të punimeve

36.1 Palët, pranojnë dhe bien dakord se proceset dhe afatet kohore për detyrimet e parashikuara nga dispozita e mësipërme nuk mund të parashikohen me saktësi që nga Data e Nënshkrimit për shkak të kompleksitetit të këtij Projekti, përfundimit me sukses të proceseve si Shpronësimi, dhënia e Lejes së Ndërtimit, Miratimet e Nevojshme, si dhe të mbivendosjeve të vet proceseve

dhe veprimeve në çdo fazë dhe Segment të Projektit (duke përfshirë edhe pasojat që çdo shtyrje afati i proceseve të tilla, qofshin apo jo të parashikuara nga ligji, mund të ketë mbi proceset e tjera) dhe për këtë arsye:

- a) vendosin se përmbushja e detyrimit nga Shoqëria Koncesionare apo Autoriteti Kontraktor do të gjykohet gjithmonë duke pasur parasysh rrethanat dhe faktet specifike dhe, si rezultat, vonesat e tij nuk do të shkaktojnë zgjidhjen e kësaj Kontrate, vendosjen e penaliteteve në mënyrë joproporcionale, apo masave të tjera, që e vendosin Shoqërinë Koncesionare në vështirësi financiare, apo ndikojnë negativisht në zhvillimin e Projektit, nëse vonesa të tilla janë të justifikuara sipas rrethanave rast pas rasti, dhe
- b) në rast se vonesa të tilla nuk janë pasojë e fajit të Shoqërisë Koncesionare apo Autoritetit Kontraktor, të gjitha afatet kohore për veprimet që pasojnë, të cilat janë logjistikisht të mëpasshme ndaj atyre të sipërpërmendura sipas fazave të Kontratës, do të konsiderohen për të zgjatur Kohëzgjatjen e Kontratës me një periudhë sa zgjat vonesa e përmendur më sipër, në përputhje me procedurat e Shkakut të Lehtësimit.

36.2 Data e Përfundimit të Punimeve që është planifikuar për secilën Vepër veçmas, apo për Projektin në tërësi, do të zgjatet, në lidhje me atë Vepër ose sipas rastit për Projektin në tërësi, pa mbajtur përgjegjës Shoqërinë Koncesionare, në rastet kur ndodh një ngjarje e Forcës Madhore dhe/ose një ngjarje që është Shkak Lehtësimi, dhe/ose një ngjarje që është Një Veprim Shtetëror Thelbësisht në Kundërshtim me Kontratën, në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate, efekti i të cilave ndikon drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë në mënyrë të pafavorshme në lidhje me atë Vepër apo për Projektin në tërësi.

36.3 Në asnjë rast, kur zgjatja e afateve bëhet për shkaqet e renditura në Nenin 36.2 si më sipër, Autoriteti Kontraktor nuk mund të bëjë përgjegjëse Shoqërinë Koncesionare dhe nuk mund të kërkojë apo aplikojë asnjë penaltet, apo kërkesë për dëmshpërblim kundrejt kësaj të fundit.

36.4 Pavarësisht nga çdo parashikim i ndryshëm në këtë Kontratë, Koncesionari apo Shoqëria Koncesionare nuk do të jetë përgjegjës/e për dëmtime, riparime dhe vonesa në zbatimin e Punimeve, të cilat kanë ardhur si rezultat i ndryshimeve të Projekt-Zbatimit të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, kur provohet se Koncesionari apo Shoqëria Koncesionare kanë marrë të gjitha masat për realizimin në kohë dhe cilësi të tyre.

36.5 Në raste të situatave të tilla të parashikuara nga Neni 36.4 më sipër, pas aprovimit nga Inxhinieri i Pavarur, çdo vonesë apo kosto për Shoqërinë Koncesionare, e cila vjen si pasojë e këtyre ngjarjeve dhe elementeve, do të konsiderohet, sipas rastit, si Shkak Lehtësimi.

Neni 37. Materialet e Rrezikshme

37.1 Në rastin e zbulimit të ndonjë materiali apo substance të rrezikshme, toksike, apo të ndotur nën, sipër dhe/ose në Shesh (“**Materiale të Rrezikshme**”), Shoqëria Koncesionare njofton menjëherë Autoritetin Përkatës dhe Autoritetin Kontraktor dhe merr të gjithë hapat e nevojshëm për të garantuar sigurinë e njerëzve dhe të pronës.

37.2 Autoriteti Kontraktor, në bashkëpunim me Shoqërinë Koncesionare, ndërmerr të gjithë hapat e nevojshëm për largimin dhe/ose neutralizimin e materialeve apo substancave të tilla (në përputhje me miratimet, Standardet dhe Ligjin). Për qëllime të largimit dhe/ose neutralizimit të materialeve ose substancave të tilla, Shoqëria Koncesionare e lejon Autoritetin Përkatës që të hyjë

në Territorin e Projektit dhe të zbatojë udhëzimet e Autoritetit Përkatës.

37.3 Nëse gjatë kryerjes së Punimeve, Shoqëria Koncesionare zbulon në Territorin e Projektit Materiale të Rrezikshme, që (i) nuk janë sjellë në Territorin e Projektit nga Shoqëria Koncesionare ose nga ndonjë Palë Koncesionare, apo (ii) Shoqëria Koncesionare nuk kishte mundësi të arsyeshme t'i kishte identifikuar apo zbuluar ato përpara datës së nënshkrimit të kësaj kontrate, si nga Të Dhënat e Vëna në Dispozicion apo nga hetimi me sy i Territorit të Projektit dhe nga hetimi i ndonjë shenje të jashtme në sipërfaqe, atëherë zbulimi në Shesh i materialeve apo substancave të tilla të paparashikueshme, të rrezikshme, toksike ose të ndotura, në rast shkaktimi të dëmeve apo vonesave për Shoqërinë Koncesionare, do të konsiderohet si Shkak Lehtësimi.

Neni 38. Rrjetet e infrastrukturës publike

38.1 Nëse ndonjë rrjet i infrastrukturës publike nën, sipër dhe/ose në Shesh pengon kryerjen e Punimeve ose nëse ndonjë prej aktiviteteve të Punimeve përfaqëson një rrezik real për funksionimin e këtyre rrjeteve, Shoqëria Koncesionare njofton menjëherë Autoritetin Kontraktor, i cili në konsultim dhe me pëlqimin (në rast nevojë), me poseduesin/përdoruesin ose operatorin përkatës të infrastrukturës publike dhe në bashkëpunim me të gjitha Palët dhe Autoritetet Përkatëse, siguron që ajo infrastrukturë të zhvendoset, hiqet, riparohet dhe/ose rivendoset, brenda 3 (tre) Muajsh dhe pa shpenzime nga ana e Shoqërisë Koncesionare për koston e zhvendosjes, heqjes, riparimit dhe/ose rivendosjes të tyre diku tjetër.

38.2 Nëse zhvendosja, heqja, riparimi apo rivendosja e infrastrukturës publike nuk është mundësuar brenda afatit të mësipërm nga data e njoftimit të Autoritetit Kontraktor, kjo do të konsiderohet si Shkak Lehtësimi. Shoqëria Koncesionare mund që, me pëlqimin e Autoritetit Kontraktor dhe pasi të ketë rënë dakord me të dhe me Inxhinierin e Pavarur për kostot, cilësinë dhe afatin e kryerjes së Punimeve, të përballojë me shpenzimet e saj kostot për këto veprime, por ato do të rimbursohen nga Autoriteti Kontraktor në bashkëpunim me Autoritetet Përkatëse të tjera, të cilat kanë në administrim ose pronësi këto infrastrukture publike. Në lidhje me këto kosto të rimbursueshme, Autoriteti Kontraktor garanton se do të kryhet pagesa nga ai vetë apo Autoriteti Përkatës pas kërkesës së Shoqërisë Koncesionare si dhe me paraqitjen nga kjo e fundit të dokumentacionit përkatës që vërteton koston si dhe të faturës/rave përkatëse dhe miratimin e Inxhinierit të Pavarur, brenda 60 (gjashtëdhjetë) Ditë Pune nga paraqitja e faturave tek Autoriteti Kontraktor.

38.3 Në rast se gjatë kryerjes së Punimeve në Territorin e Projektit zbulohet ndonjë infrastrukturë publike dhe kur një infrastrukturë e tillë publike nuk mund të ishte zbuluar normalisht nga Shoqëria Koncesionare përpara datës së nënshkrimit të kësaj Kontrate nga (i) Të Dhënat e Vëna në Dispozicion, ose (ii) hetimi i kujdesshëm i ndonjë shenje të jashtme të elementëve strukturorë në Territorin e Projektit, atëherë zbulimi i një infrastrukture të tillë publike të paparashikueshme do të konsiderohet si Shkak Lehtësimi.

Neni 39. Miratimet e nevojshme

39.1 Në rast se do të jetë e nevojshme, për të gjitha punët në lidhje me largimin, instalimin ose zëvendësimin, të përmendura te Neni 37 (*Materialet e Rrezikshme*) dhe Neni 38 (*Rrjetet e Infrastrukturës Publike*) më lart, në rast se Shoqëria Koncesionare është ajo që do të kryejë këto Punime, atëherë Shoqëria Koncesionare duhet të marrë tek Autoriteti Përkatës, të gjitha Miratimet e Nevojshme dhe të paraqesë kërkesat e shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm mbështetës,

të nevojshëm për dhënien e miratimeve të duhura. Autoriteti Kontraktor është i detyruar të bëjë të gjitha përpjekjet dhe të japë të gjithë ndihmën e nevojshme për Shoqërinë Koncesionare për të marrë Miratimet e Nevojshme nga ana e Autoriteteve Përkatëse.

39.2 Nëse një Autoritet Përkatës nuk jep një Miratim të Nevojshëm brenda periudhës kohore të përcaktuar në Ligj, për sa kohë që:

- a) Autoriteti Përkatës nuk ka paraqitur ndonjë kundërshtim apo nuk ka kërkuar masa të mëtejshme për t'u ndërmarrë përpara dhënies së Miratimit të Nevojshëm; dhe
- b) Shoqëria Koncesionare ka zbatuar të gjitha kërkesat dhe formalitetet e kërkuara nga Ligji në kërkesën për Miratimin e Nevojshëm;

atëherë kjo do të përbëjë një Shkak Lehtësimi.

Neni 40. Menaxhimi i cilësisë

40.1 Shoqëria Koncesionare përgatit dhe zbaton, në lidhje me çdo fazë të Projekt-Zbatimit, sisteme kontrolli dhe sigurimi të cilësisë, në përputhje me Standardin ISO 9001 (ose çdo procedurë tjetër të barasvlefshme, ose më të avancuar) dhe Praktikën e Mira Industriale. Shoqëria Koncesionare angazhohet që secili nga Nënkontraktorët të respektojë të njëjtat Standarde.

40.2 Sistemet e Cilësisë zbatohen për (ndër të tjera) menaxhimin e përgjithshëm, sistemin e kontrollit, planifikimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë dhe mirëmbajtjen e Rrugës.

40.3 Përpara fillimit të ndonjë pjese të Punimeve apo Shërbimeve të Mirëmbajtjes, Sistemet e Cilësisë të përgatitura nga Shoqëria Koncesionare i paraqiten Inxhinierit të Pavarur për komente dhe miratim.

40.4 Në mungesë të ndonjë komenti apo kundërshtimi nga Inxhinieri i Pavarur brenda 20 (njëzet) Ditësh Pune nga paraqitja, Sistemet e Cilësisë quhen të miratuara. Në rast të komenteve të Inxhinierit të Pavarur, Shoqëria Koncesionare i merr ato parasysh ose i dorëzon atij edhe njëherë Sistemet e Cilësisë me shpjegimet në lidhje me arsyet e mosmarrjes parasysh të komenteve.

40.5 Gjatë Kohëzgjatjes së Kontratës, Shoqëria Koncesionare i rishikon herë pas here sistemet e certifikuar. Në rastin e ndonjë ndryshimi në Sistemet e Cilësisë, Nenet 40.3 dhe 40.4 më sipër përdoren përkatësisht në lidhje me miratimin e Sistemeve të ndryshuara të Cilësisë nga Inxhinieri i Pavarur.

Neni 41. Kontrolli i cilësisë

Autoriteti Kontraktor ose çdo institucion apo Person i ngarkuar nga Autoriteti Kontraktor, duhet të bëjë herë pas here, kur e zgjedh vetë, me shpenzimet e Autoritetit Kontraktor apo të institucionit ose Personit të ngarkuar, një kontroll të procedurave të kontrollit të cilësisë së Shoqërisë Koncesionare dhe të Nënkontraktorëve për të siguruar kontrollin e kryerjes së detyrimeve sipas kësaj Kontrate.

Neni 42. Bashkërendimi i projektimit, ndërtimit dhe sigurisë

Shoqëria Koncesionare vepron në përputhje me Ligjet, të cilat rregullojnë bashkërendimin e Shoqërisë Koncesionare me Autoritetet Përkatëse për projektimin, ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e Rrugës, objekt i Kontratës, duke garantuar në çdo kohë sigurinë e Rrugës.

Neni 43. Përfundimi i Punimeve/Segmenteve

Përfundimi i Punimeve në lidhje me çdo Segment përkatës nënkupton se Segmenti ka përfunduar dhe se është bërë dorëzimi teknik në përputhje me Neni 44 (*Dorëzimi teknik*)

Neni 44. Dorëzimi teknik

44.1 Jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) Ditë Pune përpara datës që Shoqëria Koncesionare pret të përfundojë punën në lidhje me një Segment, Rugën apo Vepër tjetër, ajo i jep Inxhinierit të Pavarur dokumentacionin kualifikues në lidhje me skicat e projektimit, draftin e përditësuar të skicave me ndryshimet e bëra gjatë ndërtimit, duke vënë në dukje statusin e caktuar të punimeve në atë kohë, për qëllime inspektimi. Inxhinieri i Pavarur ka 10 (dhjetë) Ditë Pune të konfirmojë se Punimet janë kryer. Nëse ngrihet ndonjë kundërshtim nga Inxhinieri i Pavarur, Shoqëria Koncesionare dhe Inxhinieri i Pavarur konsultohen për masat që kërkohen për t'u ndërmarrë për të përmbushur kërkesat e Inxhinierit të Pavarur, me qëllim realizimin e kësaj Kontrate.

44.2 Pas marrjes të konfirmimit me shkrim nga Inxhinieri i Pavarur se Punimet në lidhje me atë Segment, Rugë apo Vepër tjetër kanë përfunduar, Shoqëria Koncesionare njofton me shkrim në lidhje me datën (datë e cila nuk mund të jetë më pak se sa 10 (dhjetë) Ditë Pune nga data e marrjes së konfirmimit nga ana e Inxhinierit të Pavarur) dhe mënyrën e organizimit të procedurës së dorëzimit si vijon; Autoritetin Kontraktor, Inxhinierin e Pavarur, Nënkontraktorin e Ndërtimit si dhe çdo Autoritet Përkatës, i cili ftohet ose prania e të cilit kërkohet me Ligj. Në njoftimin me shkrim të sipërpërmendur, Shoqëria Koncesionare do të përfshijë dhe konfirmimin nga Inxhinieri i Pavarur se Punimet janë kryer dhe çdo dokumentacion tjetër që mund të jetë i nevojshëm për kryerjen e procedurës së dorëzimit teknik.

44.3 Gjatë procedurës së dorëzimit teknik, Shoqëria Koncesionare do të lejojë çdo inspektim që mund të kërkohet të kryhet nga Autoriteti Kontraktor dhe/ose Autoriteti Përkatës sipas Ligjit. Autoriteti Kontraktor ka 30 (tridhjetë) Ditë Pune për të vendosur nëse Shoqëria Koncesionare i ka përmbushur të gjitha Standardet në lidhje me Punimet, ose për të njoftuar Shoqërinë Koncesionare për ndonjë kundërshtim që mund të ketë duke dërguar një njoftim të detajuar që shpjegon mospërputhjet e pretenduara.

44.4 Nëse ngrihet ndonjë kundërshtim nga Autoriteti Kontraktor dhe/ose Autoriteti Përkatës, Shoqëria Koncesionare dhe Inxhinieri i Pavarur konsultohen për masat që kërkohen për t'u ndërmarrë për të përmbushur kërkesat e Autoritetit Kontraktor, me qëllim realizimin e kësaj Kontrate.

44.5 Pas realizimit të masave të dakordësuara me Inxhinierin e Pavarur në nenin 44.1 apo 44.4 më lart, Shoqëria Koncesionare mund ta rifillojë procedurën e dorëzimit teknik në përputhje me Nenin 44.1, me kusht që nëse procedura teknike është rifilluar në përputhje me këtë dispozitë, periudha 15 (pesëmbëdhjetë) ditore sipas Nenit 44.1 dhe periudha 30 (tridhjetë) ditore sipas Nenit 44.3 më lart, të konsiderohen se janë 10 (dhjetë) Ditë Pune. Procedura e dorëzimit teknik përfundon kur Autoriteti Kontraktor dhe/ose Autoriteti Përkatës nuk evidenton më mospërputhje të Punimeve me Projekt-Zbatimin.

Neni 45. Marrja e Certifikatës së Përfundimit

45.1 Brenda 20 (njëzetë) Ditëve Pune nga përfundimi i procedurave të dorëzimit teknik sipas Neni 44 (*Dorëzimi teknik*) më lart, Autoriteti Kontraktor do të pajisë Shoqërinë Koncesionare me

Certifikatën e Përfundimit për Segmentin, Rugën dhe/ose Veprën tjetër. Vonesat e Autoritetit Kontraktor për pajisjen e Shoqërisë Koncesionare me Certifikatën e Përfundimit brenda afatit të mësipërm do të konsiderohet Shkak Lehtësimi.

45.2 Edhe nëse Shoqëria Koncesionare ka marrë një Certifikatë Përfundimi të vlefshme në lidhje me Segmentin përkatës, asgjë në këtë Kontratë nuk i pakëson apo kufizon në ndonjë mënyrë detyrimet e mbetura të Shoqërisë Koncesionare sipas kësaj Kontrate.

Neni 46. Marrja e Certifikatave të Përdorimit

46.1 Autoriteti Kontraktor në mënyrë të arsyeshme do të ofrojë ndihmën e nevojshme për Shoqërinë Koncesionare për pajisjen me Certifikatë Përdorimi (për një Segment, për Rugën dhe ose ndonjë Vepër tjetër) në kohë dhe në përputhje me Ligjin, për sa kohë që Shoqëria Koncesionare ka plotësuar kriteret dhe detyrimet e saj për të marrë Certifikatë Përdorimi në përputhje me procedurat e kërkuara nga dispozitat e Ligjit Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, të ndryshuar si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

46.2 Nëse Autoriteti Përkatës nuk e lëshon Certifikatën e Përdorimit brenda periudhës së parashikuar me Ligj, megjithëse Inxhinieri i Pavarur dhe Autoriteti Kontraktor nuk kanë paraqitur ndonjë kundërshtim për Punimet dhe, nga ana tjetër, as nuk kërkohet të merren masa të tjera për përfundimin e Punimeve, me kusht që Shoqëria Koncesionare të ketë përmbushur detyrimet e saj sipas dispozitave përkatëse të Ligjit kur ka bërë kërkesë për Certifikatën e Përdorimit, atëherë kjo do të konsiderohet si Shkak Lehtësimi, pa përjashtuar këtu zbatimin e kushteve të operimit të parashikuara nga kjo Kontratë ose Marrëveshja e Monitorimit Koordinimit referuar Shërbimit të Operimit.

Neni 47. Përgjegjësia për Defektet

47.1 Pa cënuar asnjë të drejtë tjetër të Palëve sipas kësaj Kontrate, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë t’i kërkojë Shoqërisë Koncesionare riparimin e çdo Defekti në Punime me shpenzimet e Shoqërisë Koncesionare, në përputhje me këtë Kontratë, gjatë Periudhës përkatëse të Përgjegjësisë së saj për Defektet.

47.2 Shoqëria Koncesionare është përgjegjëse dhe kryen sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur çdo rindërtim, riparim, rehabilitim ose Punime të tjera që kërkohen si rrjedhojë e një Defekti, përveç sa është parashikuar ndryshe në këtë Kontratë.

47.3 Me përfundimin e një Punimi, në përputhje me parashikimet e bëra te Neni 40 (*Menaxhimi i Cilësisë*) më lart, Inxhinieri i Pavarur vërteton se këto Punime janë kryer në përputhje me Standardet sipas Dokumenteve të Projektit. Në masën që Punime të tilla nuk janë përfunduar në përputhje me Standardet, Shoqërisë Koncesionare i kërkohet të kryejë Punime të tjera deri në plotësimin e tyre.

47.4 Për të shmangur çdo dyshim, gjatë gjithë Periudhës së Koncesionit dhe fazave të saj, Palët Koncesionare nuk do të jenë përgjegjëse për mosplotësime që vijnë si rezultat i drejtëpërdrejtë i ndonjë elementi të Shkakut të Lehtësimit apo/dhe Ngjarjeje të Forcës Madhore dhe nuk janë rezultat i mospërmbushjes me faj të detyrimeve të Shoqërisë Koncesionare në lidhje me Standardet.

Neni 48. Procedura për riparimin e Defekteve

48.1 Nëse gjatë Periudhës së Operimit të Segmenteve të ndërtuara nga Shoqëria Koncesionare, del në pah një Defekt, Shoqëria Koncesionare do të rregullojë Defektin/Defektet. Projekti/veprimet për eliminimin e Defektit të ndodhur do të miratohen paraprakisht nga Inxhinieri i Pavarur. Kostoja e riparimit të Defekteve do të përballohet nga Shoqëria Koncesionare.

48.2 Shoqëria Koncesionare në çdo kohë:

- a) kryen Punimet dhe Shërbimet për të mos e përkeqësuar një Defekt dhe;
- b) sapo merr dijeni për një Defekt, bën të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të zbutur pasojën e atij Defekti; dhe
- c) ndërmerr të gjitha hapat për të minimizuar pasojat e çdo Defekti të njohur.

48.3 Shoqëria Koncesionare e njofton Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e Pavarur brenda 5 (pesë) Ditësh Pune nga marrja dijeni ose konstatimi i një Defekti, dhe pas kësaj i jep Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të Pavarur çdo informacion të mëtejshëm në lidhje me Defektin. Inxhinieri i Pavarur, në bazë të këtij informacioni, jep mendimin e tij brenda 5 (pesë) Ditëve Pune, lidhur me aplikimin e masave për riparimin e tij.

48.4 Jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) Ditë Pune pasi ka marrë mendim nga Inxhinieri i Pavarur sipas Nenit 48.3 me sipër, Shoqëria Koncesionare i dorëzon Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të Pavarur një propozim për punime riparuese për ndreqjen e Defektit. Inxhinieri i Pavarur ka 5 (pesë) Ditë Pune për t'u shprehur në lidhje me propozimin e Shoqërisë Koncesionare.

48.5 Jo më vonë se 10 (dhjetë) Ditë Pune pas marrjes së konfirmimit nga Inxhinieri i Pavarur sipas Nenit 48.4 më lart, Autoriteti Kontraktor ose e miraton atë me shkrim, ose sugjeron ndryshimet përkatëse në Propozimin e Shoqërisë Koncesionare. Nëse Autoriteti Kontraktor vlerëson se i duhet më shumë kohë për shqyrtimin e propozimit, afati shtesë do t'i bëhet i ditur me shkrim Shoqërisë Koncesionare, por ky afat shtesë nuk mund të jetë më shumë se 10 (dhjetë) Ditë të tjera Pune. Nëse Autoriteti Kontraktor nuk përgjigjet në lidhje me Propozimin e Shoqërisë Koncesionare, atëherë ky propozim do të quhet i miratuar.

48.6 Nëse Autoriteti Kontraktor sugjeron ndryshime në Propozimin e Shoqërisë Koncesionare, Shoqëria Koncesionare brenda 5 (pesë) Ditësh Pune nga marrja e ndryshimeve të sugjeruara ia kalon propozimin Inxhinierit të Pavarur, i cili menjëherë jep një vendim përfundimtar për propozimin.

48.7 Vendimi i Inxhinierit të Pavarur sipas Nenit 48.6 më lart, është detyrues për Palët, përveç kur njëra nga Palët e kundërshton atë, në përputhje me parashikimet e bëra te Neni 132 (*Përshkallëzimi dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve*) i Kontratës, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) Ditësh Pune nga marrja e vendimit të Inxhinierit të Pavarur.

KREU 6 NDRYSHIMET

Neni 49. Ndryshime të Kërkuara nga Autoriteti Kontraktor

49.1 Autoriteti Kontraktor mundet që të kërkojë ndryshime në Standarde, Projekt-Zbatim, Punime ose në Shërbime (përfshirë një ndryshim në shkallën e Shërbimeve), ("**Ndryshimi i Kërkuar nga Autoriteti Kontraktor**") duke i dërguar Shoqërisë Koncesionare një njoftim ("**Njoftimi për**

Ndryshime nga Autoriteti Kontraktor”). Në Njoftimin për Ndryshime nga Autoriteti Kontraktor, Autoriteti Kontraktor duhet të japë detaje të paktën sa më poshtë:

- a) detaje të mjaftueshme për Ndryshimin e Kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, përfshirë dhe arsyetimin dhe argumentat përse duhet ky ndryshim, si dhe impaktin që pritet të ketë mbi Të Drejtat e Shoqërisë Koncesionare;
- b) të dhëna mbi kostot e Ndryshimit të Kërkuar nga Autoriteti Kontraktor me qëllim që Shoqëria Koncesionare të jetë në gjendje të kryejë një vlerësim të ndryshimit;
- c) afatin kohor brenda të cilit kërkohet që të realizohet Ndryshimi i Kërkuar nga Autoriteti Kontraktor;
- d) opinionin e Inxhinierit të Pavarur në lidhje me arsyeshmërinë e Ndryshimit të Kërkuar nga Autoriteti Kontraktor; si dhe
- e) masat lehtësuese që Autoriteti Kontraktor do të marrë për t'i lehtësuar Shoqërisë Koncesionare impaktin e Ndryshimit të Kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

49.2 Çdo Ndryshim i Kërkuar nga Autoriteti Kontraktor duhet të rakordohet dhe dakordësohet paraprakisht me Shoqërinë Koncesionare. Kostot për Ndryshimet e Kërkuara nga Autoriteti Kontraktor përballohen nga ky i fundit. Palët bien dakord që Shoqëria Koncesionare nuk ka asnjë detyrim të realizojë ndryshimin nëse nuk bie dakord për të.

49.3 Shoqëria Koncesionare do t'i përgjigjet Autoritetit Kontraktor sa më shpejt që të jetë e mundur, por gjithsesi, jo më vonë se në afatin e paraqitur në Njoftimin për Ndryshim të Autoritetit Kontraktor, i cili nuk mund të jetë më pak sesa 30 (tridhjetë) Ditë Pune.

49.4 Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të bëjë:

- a) kërkesë, sipas të cilës Punimet e ndërtimit të Rrugës objekt Koncesioni i kësaj Kontrate, apo Shërbimet duhen ofruar në një mënyrë që bie ndesh me Ligjin apo Praktikat e Mira të Industrisë së transportit, të ndërtimit siç është përcaktuar në Projekt-Zbatim;
- b) ndryshime që kërcënojnë, ose do të kërcënonin seriozisht shëndetin apo sigurinë e Personave;
- c) ndryshime që do të ndryshonin thellësisht natyrën e Projekt-Zbatimit apo të Shërbimeve, duke përfshirë natyrën e risqeve dhe Standardet;
- d) ndryshime që nuk bëjnë pjesë në të drejtat e Autoritetit Kontraktor;
- e) ndryshime që do të kërkonin Truall Shtesë ose Truall Ekstra (dhe një Truall i tillë Shtesë ose Truall Ekstra nuk jepet ose nuk përballohet financiarisht nga Autoriteti Kontraktor);
- f) ndryshime që do të shkaktonin heqjen, pezullimin ose ndryshimin e çdo Miratimi të Nevojshëm ekzistues, ose do të kërkonin një pëlqim/leje të re të nevojshme dhe kur nuk ka gjasa të arsyeshme që Shoqëria Koncesionare do të mund të merrte Miratimin e Nevojshëm, brenda afatit kohor të propozuar për zbatimin e ndryshimit të propozuar nga Autoriteti Kontraktor; dhe
- g) ndryshime që do të përbënin kosto dhe shpenzime që veçmas ose bashkërisht përgjatë gjithë Periudhës së Koncesionit tejkalojnë në total vlerën e 1 (një) milion Eurove për Shoqërinë Koncesionare, duke vënë kështu në rrezik dhe vështirësi Shoqërinë Koncesionare, përveç

rasteve kur Autoriteti Kontraktor merr përsipër mbulimin paraprak të shpenzimeve dhe kostove si dhe përveç rastit të rrugës alternative e cila do të rakordohet ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Autoritetit Përkatës përgjegjës për rrugët.

Neni 50. Ndryshime të kërkuara nga Shoqëria Koncesionare

50.1 Shoqëria Koncesionare mundet që të propozojë ndryshime në Punimet apo Shërbimet, duke i paraqitur një njoftim me shkrim Autoritetit Kontraktor (“**Njoftim për Ndryshime nga Koncesionari**”). Në Njoftimin për Ndryshime nga Koncesionari, Shoqëria Koncesionare bën të ditur:

- a) natyrën e ndryshimit të propozuar nga Shoqëria Koncesionare me detaje të mjaftueshme, me qëllim që t’i japë mundësi Autoritetit Kontraktor të vlerësojë propozimin në mënyrë të kualifikuar;
- b) nëse në lidhje me ndryshimin e kërkuar nga Shoqëria Koncesionare është e nevojshme të kërkohej shlyerja e detyrimeve të tij, sipas kësaj Kontrate, dhe nëse një ndryshim i tillë nga Shoqëria Koncesionare ka gjasa të shkaktojë vonesa në datën e programuar të përfundimit të Segmentit/eve përkatëse;
- c) Një shpjegim të shkaqeve për të cilat ndryshimi kërkohej nga Shoqëria Koncesionare;
- d) një shpjegim të ndikimit të pritshëm të ndryshimit të kërkuar nga Shoqëria Koncesionare përfshirë dhe kostot shtesë; si dhe
- e) vlerësimin e Inxhinierit të Pavarur në lidhje me arsyeshmërinë e propozimit të Shoqërisë Koncesionare.

50.2 Autoriteti Kontraktor e vlerëson me mirëbesim njoftimin e Shoqërisë Koncesionare për ndryshim, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat përkatëse, përfshirë, por pa u kufizuar me:

- a) ndikimin e mundshëm të Ndryshimit të Kërkuar nga Shoqëria Koncesionare në realizimin e Punimeve dhe Shërbimeve të Rrugës, si dhe riskun e cenimit të ecurisë së punës;
- b) ndikimin e mundshëm të Ndryshimit të Kërkuar nga Shoqëria Koncesionare në marrëdhëniet ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe Palëve të Treta;
- c) ndikimin e mundshëm të Ndryshimit të Kërkuar nga Shoqëria Koncesionare në gjendjen e Rrugës pas Datës së Përfundimit të Punimeve; dhe
- d) ndikimin e mundshëm të Ndryshimit të Kërkuar nga Shoqëria Koncesionare në risqet dhe kostot e përballuara nga Autoriteti Kontraktor.

50.3 Palët e diskutojnë brenda 20 (njëzet) Ditësh Pune Njoftimin për Ndryshim të Shoqërisë Koncesionare dhe Autoriteti Kontraktor mund të propozojë ndryshime të tjera dhe të pranojë ose të refuzojë propozimin për Ndryshim nga Shoqëria Koncesionare, duke argumentuar shkaqet e refuzimit.

50.4 Autoriteti Kontraktor do t’i përgjigjet Shoqërisë Koncesionare sa më shpejt që të jetë e mundur por gjithsesi, jo më vonë se në afatin e paraqitur në Njoftimin për Ndryshim të Shoqërisë Koncesionare, i cili nuk mund të jetë më pak sesa 30 (tridhjetë) Ditë Pune.

50.5 Nëse Autoriteti Kontraktor e pranon Njoftimin për Ndryshim nga Shoqëria Koncesionare,

Palët bien dakord për ndryshimet e nevojshme në kushtet e kësaj Kontrate dhe në Dokumentacionin e Projektit.

50.6 Përveç rasteve kur Ndryshimet e Kërkuara nga Shoqëria Koncesionare vijnë si rezultat i drejtpërdrejtë apo i tërthortë i një Shkaku Lehtësimi për të cilat do të zbatohen dispozitat të Neni 80 (*Shkaku i Lehtësimit*), kostot e ndryshimeve të kërkuara nga Shoqëria Koncesionare do të përballohen nga ajo.

KREU 7 SHËRBIMET E OPERIMIT

Neni 51. Shërbimi i Operimit

Shërbimi i Operimit përfshin operimin dhe mirëmbajtjen e Infrastrukturës së Operimit përfshirë kabinat, sistemin e portave të automatizuara për lejimin e hyrje daljeve në Rrugë, sensorët e trafikut dhe elementet e tjera matëse, sistemin elektronik për mbledhjen e Tarifave dhe të monitorimit të trafikut, serverat e nevojshëm për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave të trafikut dhe të arkëtimeve përkatëse, si dhe çdo element tjetër të nevojshëm ("**Infrastruktura e Operimit**") për realizimin e shërbimit të mundësimit të aksesit në Rrugë të Përdoruesve, arkëtimin e Tarifës, kontrollin e trafikut dhe ofrimin e ndihmës për Përdoruesit, parandalimin e shkeljeve, duke përfshirë reagimin në rast ndërhyrjesh urgjente ("**Shërbimi i Operimit**").

Neni 52. Data e Fillimit të Operimit nga Shoqëria Koncesionare

52.1 Për sa kohë nuk është rënë dakord ndryshe nga Autoriteti Kontraktor, Shërbimi i Operimit nga Shoqëria Koncesionare fillon në datën e pajisjes me Certifikatën e Përfundimit të veprës, për sa kohë që ajo mundëson fillimin e Shërbimit të Operimit ("**Data e Fillimit të Operimit të Shoqërisë Koncesionare**").

52.2 Periudha e Operimit fillon në Datën e Fillimit të Operimit dhe përfundon me përfundimin e Periudhës Koncesionare (në vijim "**Periudha e Operimit**").

52.3 Gjatë ofrimit të Shërbimit të Operimit nga Shoqëria Koncesionare, kjo e fundit, për aq sa këto janë të zbatueshme, do të aplikojë kushtet dhe parimet për ofrimin e shërbimit të Koordinimit të Përbashkët, të parashikuara në Shtojcën 2 (*Dispozitat Kryesore të Marrëveshjes së Monitorimit dhe Koordinimit të Përbashkët*).

Neni 53. Ndërtimi i Shesheve të Tarifës dhe Qendrës së Operimit dhe Krijimi mirëmbajtja e Infrastrukturës së Monitorimit, Koordinimit të Shërbimit të Operimit

53.1 Ndërtimi i Shesheve të Tarifës dhe Qendrës së Operimit për ofrimin e Shërbimit të Operimit do të realizohet nga Shoqëria Koncesionare në kuadër të Objektivit të kësaj Kontrate në përputhje me Projekt-Zbatimin.

53.2 Krijimi dhe mirëmbajtja e Infrastrukturës së Monitorimit, Koordinimit, referuar Shërbimit të Operimit realizohet nga Enti Kombëtar i Operimit Rrugor.

Neni 54. Monitorimi, Koordinimi i Shërbimit të Operimit nga Enti Kombëtar i Operimit Rrugor

54.1 Palët bien dakord që Enti Kombëtar i Operimit Rrugor (EKORR), do të ushtrojë monitorimin,

koordinimin e shërbimit të operimit sikurse parashikohet në këtë Kontratë, pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Monitorimit, Koordinimit të Shërbimit të Operimit (siç është përkufizuar më poshtë).

54.2 Jo më vonë se 6 (gjashtë) Muaj nga Data e Hyrjes në Fuqi të kësaj Kontrate, Autoriteti Kontraktor do të njoftojë me shkrim Shoqërinë Koncesionare për fillimin e negocimit të Marrëveshjes së Monitorimit, Koordinimit të Shërbimit të Operimit me Entin Kombëtar të Operimit Rrugor të caktuar nga Autoriteti, dhe do t'i përcjellë propozimin e projekt-kontratës së Marrëveshjes së Monitorimit, Koordinimit të Shërbimit të Operimit ("**Propozimi**") të hartuar nga EKORR. Propozimi do të hartohet referuar kushteve, të drejtave dhe detyrimeve themelore që janë përshkruar në Shtojcën 2 (Dispozitat Kryesore të Marrëveshjes së Monitorimit, Koordinimit të Shërbimit të Operimit).

54.3 Marrëveshja e Monitorimit, Koordinimit të Shërbimit të Operimit e nënshkruar mes Entit Kombëtar të Operimit Rrugor të caktuar nga Autoriteti dhe Shoqërisë Koncesionare dhe e dakortësuar nga Autoriteti Kontraktor do të konsiderohet si e nënshkruar mes Autoritetit Kontraktor dhe Shoqërisë Koncesionare. Autoriteti Kontraktor do të jetë solidarisht përgjegjës dhe çdo shkelje nga ana e Entit Kombëtar të Operimit Rrugor dhe Dëmet që i lindin Shoqërisë Koncesionare në lidhje me to do të konsiderohen Shkak Lehtësimi dhe/ose Mospërmbushje e Autoritetit Kontraktor sipas kësaj Kontrate dhe Marrëveshjes së Monitorimit, Koordinimit të Shërbimit të Operimit. Gjithashtu, shkelja nga ana e Shoqërisë Koncesionare e Marrëveshjes së Monitorimit, Koordinimit të Shërbimit të Operimit, do të konsiderohet Mospërmbushje nga Shoqëria Koncesionare sipas kësaj Kontrate.

Neni 55. Ushtrimi i Shërbimit të Operimit nga Shoqëria Koncesionare

Shërbimi i Operimit të Rrugës Milot – Balldre do të realizohet nga Shoqëria Koncesionare nga fillimi i shërbimit të operimit deri në Datën e Përfundimit të Kontratës.

Neni 56. Procedurat e Bashkërendimit të Operimit

56.1 Përpara Datës së Fillimit të Operimit, në bashkëpunim dhe me Inxhinierin e Pavarur, Palët do të kenë rënë dakord për procedurat e bashkërendimit në lidhje me operimin, Monitorimin, Koordinimin e Shërbimit të Operimit ndërmjet shoqërisë/shoqërive koncesionare, Entit Kombëtar të Operimit Rrugor dhe autoriteteve përkatëse (duke përfshirë Policinë, Shërbimet e Zjarrfikësve dhe të Ambulancës) ("**Procedurat e Bashkërendimit të Operimit**").

56.2 Procedurat e Bashkërendimit të Operimit ndër të tjera:

- a) parashikojnë takime periodike ndërmjet Shoqërisë/shoqërive Koncesionare për Shërbimin e Operimit, Entit Kombëtar të Operimit të Rrugës dhe Autoriteteve Përkatëse për të diskutuar çështjet që prekin objektin e Procedurave të Bashkërendimit të Operimit;
- b) përcaktojnë sipas rastit procedurat e rena dakord për menaxhimin e trafikut, duke përfshirë kufizimet e shpejtësisë, trajtimin e çdo rasti të jashtëzakonshëm, duke përfshirë procedurën e aksesit dhe rrugët për shërbimet e urgjencës (policia, zjarrfikëset dhe shërbimet e ambulancës, shoqëritë e furnizimit me ujë dhe energji elektrike, dhe çdo shoqëri tjetër përkatëse e telekomunikacionit);

- c) parashikojnë procedurat në lidhje me ruajtjen e funksionimit të sigurtë të Rrugës dhe sigurinë e Përdoruesve, punëmarrësve të Personit përgjegjës për Shërbimin e Operimit dhe vizitorëve të lejuar në Rrugë;
- d) përfshijnë procedurën e komunikimit ndërmjet Palëve dhe caktojnë një përfaqësues në emër të Personit përgjegjës për Shërbimin e Operimit për bashkërendimin e punës me Autoritetet Përkatëse; dhe
- e) përcaktojnë procedurën e rënë dakord për ndryshimin e Procedurave të Bashkërendimit të Operimit, herë pas here.

Neni 57. Plani i Operimit të Rrugës

57.1 Duke filluar në çdo moment pas Datës së Fillimit të Punimeve, krahas Procedurave të Bashkërendimit të Operimit, por jo më vonë se 20 (njëzet) Ditë Pune nga Data e Fillimit të Operimit, Shoqëria Koncesionare do të përgatisë dhe paraqesë te Autoriteti Kontraktor të gjithë programin në lidhje me Operimin, pasi ka marrë dhe kontributin dhe sugjerimet e Inxhinierit të Pavarur në hartimin e tij (në vijim **“Plani i Operimit të Rrugës”**).

57.2 Brenda 30 (tridhjetë) Ditësh Pune prej dërgimit te Autoriteti Kontraktor i Planit për Operimin e Rrugës nga Shoqëria Koncesionare, Autoriteti Kontraktor nëpërmjet Autoritetit Përkatës përgjegjës për rrugët, miraton Planin e Operimit të Rrugës ose paraqet vërejtjet apo rekomandimet e tij. Në rast se ka vërejtje dhe/ose rekomandime nga ana e Autoritetit Kontraktor, ky i fundit së bashku me paraqitjen e vërejtjeve dhe/ose rekomandimeve i cakton Shoqërisë Koncesionare edhe një datë për takimin midis Palëve, për të diskutuar Planin e Operimit të Rrugës dhe vërejtjet dhe/ose rekomandimet e Autoritetit Kontraktor.

57.3 Palët angazhohen se Shoqëria Koncesionare do të vlerësojë me kujdes dhe mirëbesim çdo parashtrim të bërë nga Autoriteti Kontraktor në lidhje me Planin e Operimit të Rrugës. Brenda 5 (pesë) Ditësh Pune pas takimit dhe gjithsesi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) Ditësh Pune nga data e marrjes së vërejtjeve apo rekomandimeve nga ana e Autoritetit Kontraktor, Shoqëria Koncesionare i dërgon Autoritetit Kontraktor versionin përfundimtar të Planit të Operimit të Rrugës dhe në rast të mosmarrjes parasysh të vërejtjeve dhe rekomandimeve të Autoritetit Kontraktor, i dërgon edhe një relacion shpjegues për arsyet e mosmarrjes parasysh. Autoriteti Kontraktor ka 15 (pesëmbëdhjetë) Ditë Pune për të vendosur nëse Shoqëria Koncesionare i ka përmbushur të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet, në lidhje me Planin e Operimit të Rrugës ose për të njoftuar Shoqërinë Koncesionare për ndonjë kundërshtim që mund të ketë duke dërguar një njoftim të detajuar që shpjegon kundërshtimin e tij. Nëse Autoriteti Kontraktor nuk përgjigjet në lidhje me versionin përfundimtar të Planit të Operimit të Rrugës, atëherë ky version do të quhet i miratuar.

57.4 Nëse ngrihet ndonjë kundërshtim nga Autoriteti Kontraktor, Shoqëria Koncesionare brenda 10 (dhjetë) Ditësh Pune nga marrja e kundërshtimeve të Autoritetit Kontraktor, ia kalon kundërshtimet Inxhinierit të Pavarur dhe i dërgon edhe një relacion shpjegues për arsyet e mosmarrjes parasysh të kundërshtimeve. Vendimi i Inxhinierit të Pavarur është detyrues për Palët, përveç kur njëra nga Palët e kundërshton atë, në përputhje me parashikimet e bëra te Kreu 19 Neni 132 (*Përshkallëzimi dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve*) i Kontratës, brenda 10 (dhjetë) Ditësh Pune nga marrja e vendimit të Inxhinierit të Pavarur.

Neni 58. Përputhshmëria me Procedurat dhe Planin e Operimit

58.1 Shoqëria Koncesionare do t'i ofrojë Shërbimet e Operimit gjatë gjithë Periudhës së Operimit, në përputhje me Procedurat e Bashkërendimit të Operimit, si dhe me Planin e Operimit të Rugës.

58.2 Në ofrimin e Shërbimeve të Operimit Shoqëria Koncesionare, gjatë gjithë kohës do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme të nevojshme për të siguruar që të mos veprojnë në ndonjë mënyrë që të ndikojë negativisht në funksionimin e Rugës dhe të trafikut të saj.

Neni 59. Përgjegjësia mbi Infrastrukturën e Operimit

Përgjegjësia për mirëmbajtjen e Infrastrukturës së Operimit, përfshirë çdo element tjetër të nevojshëm për realizimin e Shërbimit të Operimit është e Shoqërisë Koncesionare.

KREU 8 SHËRBIMET E MIRËMBAJTJES

Neni 60. Përgjegjësia për Mirëmbajtjen

Që nga Data e Përfundimit të Punimeve dhe deri në Datën e Përfundimit të Kontratës, Shoqëria Koncesionare do të jetë përgjegjëse për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe riparimet e dëmtimit të Veprës në përputhje me këtë Kontratë, me përjashtim të parashikimeve të ndryshme në Marrëveshjen e Monitorimit, Koordinimit të Shërbimit të Operimit dhe ose ndonjë akt tjetër të miratuar nga Palët.

Neni 61. Mirëmbajtja, përgatitja e Planit, Periudha e Mirëmbajtjes

61.1 Duke filluar në çdo moment pas Datës së Fillimit të Punimeve, por jo më vonë se 30 (tridhjetë) Ditë Pune nga fillimi i Periudhës së Operimit, Shoqëria Koncesionare në përputhje me kërkesat e Manualit të Mirëmbajtjes, përgatit dhe i paraqet Autoritetit Kontraktor të gjithë programin në lidhje me Mirëmbajtjen e cila duhet të jetë miratuar dhe nga Inxhinieri i Pavarur (në vijim “**Plani i Mirëmbajtjes së Rugës**”).

61.2 Brenda 30 (tridhjetë) Ditësh Pune pas marrjes të Planit për Mirëmbajtjen e Rugës nga Shoqëria Koncesionare, Autoriteti Kontraktor, miraton Planin e Mirëmbajtjes së Rugës ose paraqet vërejtjet apo rekomandimet e tij, në përputhje me Manualin e Mirëmbajtjes. Në rast se ka vërejtje dhe/ose rekomandime nga ana e Autoritetit Kontraktor, ky i fundit së bashku me paraqitjen e vërejtjeve dhe/ose rekomandimeve i cakton Shoqërisë Koncesionare edhe një datë për takimin midis Palëve për të diskutuar Planin e Mirëmbajtjes së Rugës dhe vërejtjet dhe/ose rekomandimet e Autoritetit Kontraktor. Shoqëria Koncesionare angazhohet se do të vlerësojë me kujdes dhe mirëbesim çdo parashtrim të bërë nga Autoriteti Kontraktor në lidhje me Planin e Mirëmbajtjes së Rugës. Brenda 5 (pesë) Ditësh Pune pas takimit dhe gjithsesi brenda 10 (dhjetë) Ditësh Pune nga data e marrjes së vërejtjeve apo rekomandimeve nga ana e Autoritetit Kontraktor, Shoqëria Koncesionare i dërgon Autoritetit Kontraktor Planin e Mirëmbajtjes së Rugës të rishikuar dhe në rast të mosmarrjes parasysh të vërejtjeve dhe rekomandimeve të Autoritetit Kontraktor i dërgon edhe një relacion shpjegues për arsyet e mosmarrjes parasysh. Autoriteti Kontraktor ka 20 (njëzetë) Ditë Pune për të vendosur nëse Shoqëria Koncesionare i ka përmblusur të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet, në lidhje me Planin e Mirëmbajtjes së Rugës ose për të njoftuar Shoqërinë Koncesionare për ndonjë kundërshtim që mund të ketë duke dërguar një njoftim të detajuar që shpjegon kundërshtimin e tij. Nëse Autoriteti Kontraktor nuk përgjigjet në

lidhje me Planin e Mirëmbajtjes së Rrugës të rishikuar, atëherë ky version do të quhet i miratuar. Nëse ngrihet ndonjë kundërshtim nga Autoriteti Kontraktor, Shoqëria Koncesionare brenda 10 (dhjetë) Ditësh Pune nga marrja e kundërshtimeve të Autoritetit Kontraktor, ia kalon kundërshtimet Inxhinierit të Pavarur dhe i dërgon edhe një relacion shpjegues për arsyet e mosmarrjes parasysh të kundërshtimeve, i cili menjëherë jep një vendim përfundimtar dhe detyrues për Palët, përveç kur njëra nga Palët e kundërshton atë, në përputhje me parashikimet e bëra te Neni 132 (*Përshkallëzimi dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve*) i Kontratës, brenda 10 (dhjetë) Ditësh Pune nga marrja e vendimit të Inxhinierit të Pavarur.

61.3 Shoqëria Koncesionare do të ofrojë Shërbimet e Mirëmbajtjes gjatë gjithë Periudhës së Operimit, në përputhje me Manualin e Mirëmbajtjes, me Planin e Mirëmbajtjes së Rrugës, si dhe dhe pasqyrën e aktiviteteve të Shërbimeve të Mirëmbajtjes të pasqyruara në Shtojcën 6 (*Pasqyra e Aktiviteteve të Shërbimit të Mirëmbajtjes*).

61.4 Në ofrimin e Shërbimeve të Mirëmbajtjes Shoqëria Koncesionare gjatë gjithë kohës bën të gjitha përpjekjet e arsyeshme të nevojshme për të siguruar që të mos veprojë në ndonjë mënyrë që të ndikojë negativisht në funksionimin e Rrugës dhe të trafikut të saj.

Neni 62. Procedurat e bashkërendimit të mirëmbajtjes

Deri në fillimin e Periudhës së Operimit, Shoqëria Koncesionare me ndihmën dhe kujdesin e Autoritetit Kontraktor, duhet t'i ketë mbaruar diskutimet me të gjitha Autoritetet Përkatëse përgjegjëse për Rrugën, ose që preken nga Shërbimet e Mirëmbajtjes, dhe duhet të ketë përgatitur dhe rënë dakord, nëse është e nevojshme, për procedurat e bashkërendimit në lidhje me Shërbimet e Mirëmbajtjes ndërmjet Autoritetit Përkatës (duke përfshirë policinë, shërbimet e zjarrfikësve dhe të ambulancës, shërbimeve të infrastrukturës publike) dhe Shoqërisë Koncesionare.

Neni 63. Ndryshimet në Manualin e Mirëmbajtjes dhe/ose Planin e Mirëmbajtjes së Rrugës

63.1 Shoqëria Koncesionare mund të propozojë tek Autoriteti Kontraktor ndryshimin e Manualit të Mirëmbajtjes dhe/ose Planin e Mirëmbajtjes së Rrugës. Brenda 20 (njëzetë) Ditësh Pune pas marrjes së propozimeve për Ndryshim nga Shoqëria Koncesionare, Autoriteti Kontraktor, vetë ose nëpërmjet Autoritetit Përkatës përgjegjës për rrugët, miraton propozimet ose paraqet me shkrim vërejtjet apo rekomandimet e tij. Në rast se ka vërejtje dhe/ose rekomandime nga ana e Autoritetit Kontraktor, ky i fundit së bashku me paraqitjen e vërejtjeve dhe rekomandimeve i cakton Shoqërisë Koncesionare edhe një datë për takimin midis Palëve për të diskutuar propozimet për ndryshimin e Manualit të Mirëmbajtjes dhe/ose Planin e Mirëmbajtjes së Rrugës si dhe vërejtjet e rekomandimet e Autoritetit Kontraktor. Shoqëria Koncesionare duhet të vlerësojë me kujdes dhe mirëbesim çdo parashtrim të bërë nga Autoriteti Kontraktor nëpërmjet Autoritetit përgjegjës për rrugët, në lidhje me Manualin e Mirëmbajtjes dhe/ose Planin e Mirëmbajtjes së Rrugës. Brenda 5 (pesë) Ditësh Pune pas takimit dhe gjithsesi brenda 10 (dhjetë) Ditësh Pune nga data e marrjes së vërejtjeve apo rekomandimeve nga ana e Autoritetit Kontraktor, Shoqëria Koncesionare i dërgon për miratim Autoritetit Kontraktor, versionin e rishikuar të propozimeve për ndryshimin e Manualit të Mirëmbajtjes dhe/ose Planin e Mirëmbajtjes së Rrugës, sipas vërejtjeve dhe rekomandimeve të Autoritetit Kontraktor. Autoriteti duhet të përgjigjet në lidhje me propozimin e ri brenda një afati prej 20 (njëzetë) Ditësh Pune nga dita e dërgimit të propozimit të ndryshuar. Në rast se Autoriteti Kontraktor nuk përgjigjet apo nuk e miraton propozimin e Shoqërisë

Koncesionare, atëherë do të vazhdojë të jetë në fuqi Manuali i Mirëmbajtjes aktual dhe/ose Plan i Mirëmbajtjes së Rrugës aktual.

63.2 Në rast se Palët nuk bien dakord për ndryshimet përkatëse në Manualin e Mirëmbajtjes dhe/ose Planin e Mirëmbajtjes së Rrugës, Inxhinieri i Pavarur vendos për ndryshimet përkatëse që do t'u bëhen atyre. Vendimi i Inxhinierit të Pavarur është detyrues për Palët përveçse kur njëra nga palët e kundërshton atë në përputhje me parashikimet e bëra te Neni 132 (*Përshkallëzimi dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve*) i kësaj Kontrate.

Neni 64. Qendra e Mirëmbajtjes

64.1 Shoqëria Koncesionare zhvillon, shfrytëzon dhe mirëmban një ose më shumë qendra mirëmbajtjeje sipas nevojës dhe në përputhje me Projekt-Zbatimin, Manualin e Mirëmbajtjes si dhe me Planin e Mirëmbajtjes së Rrugës, si dhe me Planin e Operimit të Rrugës (në vijim "**Qendra e Mirëmbajtjes**").

64.2 Nëse Shoqëria Koncesionare kërkon Truall Shtesë ku të ndërtojë Qendrën e Mirëmbajtjes, Autoriteti Kontraktor bie dakord me një kërkesë të tillë dhe e siguron Truallin Shtesë për qëllimet e Qendrës apo Qendrave të Mirëmbajtjes në kohë dhe sipas Ligjit për shpronësimet, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat.

64.3 Nëse Autoriteti Kontraktor nuk është në gjendje ta sigurojë Truallin Shtesë i cili është kërkuar nga Shoqërisë Koncesionare, në konsultim me të, Autoriteti Kontraktor zgjedh dhe siguron Truall Shtesë të krahasueshëm alternativ për qëllimet e Qendrës së Mirëmbajtjes.

64.4 Nëse Autoriteti Kontraktor dhe Shoqëria Koncesionare nuk janë në gjendje të bien dakord për Truallin Shtesë të krahasueshëm alternativ, atëherë çështja vendoset nga Inxhinieri i Pavarur dhe vendimi i Inxhinierit të Pavarur është detyrues për Palët, përveçse kur njëra nga palët e kundërshton atë në përputhje me parashikimet e bëra te Neni 132 (*Përshkallëzimi dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve*) i kësaj Kontrate.

64.5 Qendra apo Qendrat e Mirëmbajtjes janë pjesë e Punimeve dhe Shërbimeve dhe në lidhje me Qendrën apo Qendrat e Mirëmbajtjes, Shoqëria Koncesionare përmbush kërkesat e Autoriteteve Përkatëse dhe bashkërendohet me Autoritetet Përkatëse sipas procedurave të bashkërendimit të Neni 62 (*Procedurat e Bashkërendimit të Mirëmbajtjes*) i kësaj Kontrate.

Neni 65. Detyrimet e Shoqërisë Koncesionare në kuadër të Mirëmbajtjes

65.1 Në përputhje me kërkesat për Shërbimet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në përputhje me këtë Kontratë si dhe propozimet e Shoqërisë Koncesionare për mirëmbajtjen sipas propozimit të ofertës fituese, si dhe Praktikës më të Mirë të Industrisë, Shoqëria Koncesionare, në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktor dhe Autoritetet Përkatëse:

- a) do të marrë të gjitha masat për të bërë të mundur lëvizjen e qetë dhe të pandërprerë të trafikut në Rrugë dhe për t'i mbajtur në minimum vonesat e tij;
- b) do të ndërmarrë (dhe angazhohet që çdo Nënkontraktor si dhe punëmarrësit e tij do të ndërmarrin) të gjitha veprimet e nevojshme për të mirëmbajtur Rrugën në atë mënyrë që të sigurojë operimin e pandërprerë dhe të sigurt të Rrugës në bazë 24-orëshe nga automjetet dhe çdo Përdorues i mundshëm (përveç rasteve të Ngjarjeve të Forcës Madhore, aksidenteve apo ngjarjeve të tjera që e bëjnë atë të paoperueshme);

c) do të respektojë Manualin e Mirëmbajtjes; si dhe

d) do të veprojë sa më shpejt që të jetë e mundur ndaj emergjencave apo incidenteve të tjerë, për aq sa parashikohet në Manualin/let e Mirëmbajtjes apo në Planin e Mirëmbajtjes së Rrugës.

65.2 Kur një Punim për mirëmbajtje, riparim apo Punime të tjera, e bën të nevojshme ndërprerjen apo pezullimin e përdorimit të të gjitha pjesëve të Rrugës, apo mbylljen e Rrugës për një periudhë kohe, Shoqëria Koncesionare i jep (i) Autoritetit Kontraktor, (ii) Autoritetit Përkatës të përfshirë, si dhe (iii) çdo pale të interesuar dhe të gjithë Përdoruesve të prekur, me anë të mjeteve të disponueshme, në përputhje me Praktikën e Mirë të Industrisë, njoftim paraprak për një rast të tillë, përveç rasteve të emergjencës ose të një çrregullimi të vogël në Rrugë. Në rastin e një urgjence, apo të një çrregullimi të vogël në Rrugë, nuk kërkohet ndonjë njoftim paraprak, megjithatë, sa më shpejt që të jetë e mundur, por gjithsesi brenda një afati të arsyeshëm, Shoqëria Koncesionare i jep Autoritetit Kontraktor dhe çdo Autoriteti Përkatës, shpjegimet e ngjarjes në fjalë, nëse i kërkohet.

65.3 Shoqëria Koncesionare bën në çdo kohë përpjekjet e saj të arsyeshme, për të zvogëluar ose shmangur shqetësimet që i shkaktohen trafikut në Rrugë.

65.4 Shoqëria Koncesionare do të realizojë Riparimet Kapitale sipas cikleve të rehabilitimit të shtresave të Rrugës, të përcaktuara në Dokumentacionin e Ofertës, në përputhje me Rregullat teknike për projektimin e rrugëve të parashikuara nga Ligji. Shoqëria Koncesionare i paraqet Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të Pavarur një Program të Riparimit Kapital, jo më vonë se 30 (tridhjetë) Ditë Pune përpara ditës së parë me të cilën lidhet Programi i Riparimit Kapital dhe një propozim që lidhet me vitin e ardhshëm, në përputhje me Manualin e Mirëmbajtjes si dhe me Planin për Mirëmbajtjen e Rrugës. Autoriteti Kontraktor mund të komentojë për Programin e Riparimeve Kapitale brenda 30 (tridhjetë) Ditësh Pune pas paraqitjes së Programit të Riparimeve Kapitale të propozuara. Shoqëria Koncesionare merr parasysh komente të tilla, me përjashtim të atyre komenteve që do të sillnin vonesa të paarsyeshme, shkelje të kësaj Kontrate ose të Ligjit, ose kosto të larta.

65.5 Për të shmangur çdo dyshim, rregullimi i dëmtimeve në Rrugë si pasojë e Ngjarjeve të Forcës Madhore dhe shpenzimet e lidhura me to do të trajtohen sipas parashikimeve të neni 80 (*Shkaku i Lehtësimit*). Përpara fillimit të punimeve për rregullimin e këtyre dëmtimeve, Shoqëria Koncesionare i paraqet Inxhinierit të Pavarur dhe Autoritetit Kontraktor planin e ndërhyrjes për këto rregullime si dhe koston e tyre. Vetëm pasi Palët bien dakord për planin dhe koston e ndërhyrjeve, Shoqëria Koncesionare fillon punën për rregullimin e dëmtimeve në Rrugë.

KREU 9 NDËRHYRJET URGJENTE

Neni 66. Ndërhyrjet Urgjente të Shoqërisë Koncesionare

66.1 “Ndërhyrje/t Urgjente” përfshijnë Punime të jashtëzakonshme për zhbllokimin, pastrimin, mirëmbajtjen apo riparimin e Veprës në raste të Ngjarjes së Forcës Madhore, ose ngjarje të tjera që bllokojnë, pengojnë apo nuk lejojnë përdorimin e Veprës sipas përcaktimeve në këtë Kontratë nga Përdoruesit.

66.2 Shoqëria Koncesionare në bashkëpunim me (i) Autoritetin Kontraktor (ii) Autoritetin

Përkatës dhe/apo (iii) Entin Kombëtar të Operimit Rrugor (në rast se një bashkëpunim i tillë do të jetë i nevojshëm):

- a) në raste Ndërhjryesh Urgjente vepron në përputhje me (i) Planin e Mirëmbajtjes së Rrugës, (ii) Manualin/et e Mirëmbajtjes dhe (iii) Standardet e përcaktuara në këtë Kontratë; si dhe
- b) nëse ka pasur Ndërhjrye Urgjente, i paraqet Autoritetit Kontraktor një raport vjetor për rastet e Ndërhjryeve Urgjente në Periudhën e Koncesionit, ku jepen me hollësi aktivitetet e operacioneve të Ndërhjryeve Urgjente, të ndërmarra nga Shoqëria Koncesionare në rastin konkret të Ndërhjryeve Urgjente.

Neni 67. Kostot në lidhje me Ndërhjryet Urgjente

67.1 Nëse Shoqërisë Koncesionare si rezultat i Ndërhjryeve Urgjente për shkak të Ngjarjes së Forcës Madhore i lindin kosto që nuk do t'i kishin lindur në mungesë të Ndërhjryes Urgjente, Palët bien dakord që kostot shtesë që Shoqërisë Koncesionare që nuk i mbulohen nga Sigurimet, do të përballohen nga Palët në mënyrë të barabartë (50% me 50%).

67.2 Nëse Ndërhjryet Urgjente janë shkaktuar nga një veprim ose mosveprim me faj i Shoqërisë Koncesionare ose i një Pale të Koncesionarit, kostot shtesë që i lindin Shoqërisë Koncesionare do të mbulohen të gjitha nga vetë ajo.

67.3 Përveç rasteve të adresuara te Neni 68 (*Shërbime Shtesë dhe Alternative*), nëse Ndërhjryet Urgjente janë shkaktuar nga një veprim ose mosveprim me faj i Autoritet Kontraktor apo Palë e Autoritetit Kontraktor, kostot shtesë që i lindin Shoqërisë Koncesionare do të mbulohen nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 68. Shërbime shtesë dhe alternative

68.1 Nëse ndodh një rast Ndërhjrye Urgjente në Periudhën e Operimit, e cila nuk mund të zgjidhet me anë të ofrimit të zakonshëm të Shërbimeve (si për shembull ndërprerja e Shërbimit të Operimit për arsye të kërkesave të ardhura nga Autoritetet Përkatëse për zhvillimin e aktiviteteve sportive apo zyrtare apo raste të tjera), Shoqëria Koncesionare, bazuar dhe në udhëzimet e mundshme të Autoritetit Kontraktor, do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të siguruar ofrimin e shërbimeve të tilla shtesë ose zëvendësuese me qëllim që:

a) të zgjidhet rasti i Ndërhjryes Urgjente; dhe

b) të rivendoset ofrimi i zakonshëm i Shërbimeve sa më shpejt që të jetë e mundur,

me kusht që ofrimi i shërbimeve të tilla ose i shërbimeve zëvendësuese të mos bjerë ndesh me detyrimet e Shoqërisë Koncesionare sipas kësaj Kontrate dhe që Shoqëria Koncesionare të jetë në gjendje të ofrojë shërbime shtesë ose zëvendësuese (të cilat përfshijnë, për efekt sqarimi, dhe mbylljen e përkohshme të Shërbimit të Operimit).

Neni 69. Kostot e lidhura me shërbimet shtesë

Nëse Shoqëria Koncesionare ofron shërbime shtesë ose zëvendësuese në përputhje me parashikimet te Neni 68 (*Shërbime shtesë dhe alternative*) më sipër, Autoriteti Kontraktor i paguan Shoqërisë Koncesionare kostot e tij shtesë sipas shpenzimeve/faturimeve përkatëse si dhe Fitimin e Munguar, për shkak të ndërprerjes së pjesshme apo të plotë të Shërbimit të Operimit, që Shoqërisë Koncesionare i është shkaktuar si rezultat i ofrimit të shërbimeve të tilla shtesë ose

zëvendësuese (përveçse kur rasti për Ndërhyrje Urgjente është shkaktuar nga një veprim ose mosveprim i Shoqërisë Koncesionare ose i një Pale të Koncesionarit).

KREU 10 TARIFA

Neni 70. E drejta për Tarifën

70.1 Palët bien dakord që gjatë Kohëzgjatjes së Kontratës, Shoqëria Koncesionare ka të drejtën ekskluzive të përfitimit të të ardhurave nga Tarifa.

70.2 Shoqëria Koncesionare ka të drejtë të aplikojë Tarifën menjëherë pas Datës së Fillimit të Operimit.

Neni 71. Vjelja e të ardhurave nga Tarifa

71.1 Tarifa mund të arkëtohet në: (i) në Lekë, (ii) në Euro apo (iii) në monedha të tjera që mund të dakordësohen me shkrim nga Palët.

71.2 Arkëtimi i Tarifës realizohet bazuar në Të Ardhurat nga Tarifa në përputhje me këtë Kre, dhe me Shtojcën 8 (Dokumentacioni i Ofertës), menjëherë pas Datës së Fillimit të Operimit, e cila do të përfaqësojë edhe datën e fillimit të përdorimit të Rrugës me Tarifë.

Neni 72. Shkalla e Tarifës

72.1 Nga Data e Fillimit të Operimit, Shoqëria Koncesionare do të zbatojë Tarifën EUR pa TVSH për automjet për kilometër, e përshtatur sipas rastit në vartësi të klasifikimit të automjetit në përputhje me parashikimet të Neni 73 (*Klasifikimi i Automjeteve*) më poshtë. Tarifa në Lekë do të jetë shuma e llogaritur me kursin zyrtar të këmbimit nga Euro në Lekë të Bankës së Shqipërisë në Datën e Fillimit të Operimit.

72.2 Në përputhje me Dokumentacionin e Ofertës, duke filluar nga fillimi i vitit të dytë të plotë kalendarik që nga Data e Fillimit të Operimit, Tarifa do të rregullohet sipas formulës së mëposhtme:

$$T_i = T_0 \cdot I$$

Ku:

T_i – Tarifa në vitin i.

T_0 – Tarifa paraardhëse.

I – Indeksi i rritjes i cili llogaritet sipas formulës më poshtë:

$$I = \left(0.25 \cdot \frac{ECPI_i}{ECPI_0} \right) + \left(0.25 \cdot \frac{ECCI_i}{ECCI_0} \right) + \left(0.5 \cdot \frac{LCPI_i}{LCPI_0} \right)$$

Ku:

I - indeksi në vitin i

ECPI₀ –Indeksi i çmimeve në Euro në muajin në të cilën bie data e Mbylljes Financiare.

ECPI_i –Indeksi i çmimeve në Euro në muajin e fundit për të cilin janë të disponueshme të dhënat në datën e llogaritjes.

ECCL₀ – Indeksi i BE-së për çmimin e prodhimit në vitin në të cilin bie data e Mbylljes Financiare.

ECCL_i – Indeksi i BE-së për çmimin e prodhimit në vitin e fundit për të cilin janë të disponueshme të dhënat në datën e llogaritjes.

LCPI₀ – Indeksi i çmimit të konsumatorit në lekë në muajin në të cilin bie Mbyllja Financiare.

LCPI_i – Indeksi i çmimit të konsumatorit në lekë në muajin e fundit për të cilin janë të disponueshme të dhënat në datën e llogaritjes.

72.3 Në llogaritjen e Tarifës së rregulluar sipas formulës së mësipërme, Shoqëria Koncesionare do ta rrumbullakosë vlerën e Tarifës në një shifër pas presjes dhjetore (në Euro – 0.1 Euro dhe në dhjetë lekë - 10 lekë).

72.4 Përlllogaritjet e rregullimit të Shkallës së Tarifës së aplikuar do të bëhen në çdo Vit të Kontratës. Pavarësisht nga kjo, këto përlllogaritje do të pasqyrohen në vlerën e Tarifës në mënyrë kumulative një herë në 4 (katër) vjet. Përlllogaritjet përkatëse i dërgohen Autoritetit Kontraktor dhe ministrisë përgjegjëse për financat brenda muajit të parë pas përfundimit të çdo Viti Financiar, të cilët kanë një afat prej 45 (dyzet e pesë) Ditë Pune për verifikimin e saktësisë së përlllogaritjeve të kryera.

a) Në rast se Autoriteti Kontraktor dhe/ose ministria përgjegjëse për financat shprehin ndonjë rezervë lidhur me përlllogaritjet e kryera, brenda afatit sa më sipër, Palët dhe përfaqësuesi i autorizuar i ministrisë përgjegjëse për financat, do të mbledhen për të diskutuar me qëllim arritjen e një dakordësie të përbashkët.

b) Nëse, pavarësisht përpjekjeve në mirëbesim të Palëve, nuk kanë arritur dakordësinë mbi përlllogaritjen e bërë, brenda afatit 6 mujor nga data e dërgimit të përlllogaritjes tek Autoriteti Kontraktor, atëherë Shoqëria Konkensionare ka të drejtë të aplikojë Tarifën e Indeksuar sipas përlllogartijes që ajo ka bërë menjëherë sapo përfundon afati 6 mujor sa më sipër dhe Palët kanë të drejtë ti drejtohen Gjykatës në përputhje me nenin 132 të kësaj Kontrate.

c) Për të shmangur çdo dyshim, Autoriteti Kontraktor dhe Ministria përgjegjëse për Financat, në çdo kohë, pra dhe pas aplikimit nga Shoqëria Koncesionare të tarifës së indeksuar sipas shkronjës (b) të nenit 72.4, kanë të drejtë të verifikojnë saktësinë e përlllogaritjes së tarifës së indeksuar dhe nëse ato rezultojnë se nuk janë të sakta, ti kërkojnë Shoqërisë Konkensionare që të kryejë menjëherë korrigjimin e tyre dhe aplikimin e tarifave të sakta.

d) Nëse pavarësisht dakordësisë apo të drejtës së Shoqërisë Konkensionare për të aplikuar Tarifën e indeksuar sipas këtij Neni, Autoriteti Kontraktor vendos që për arsye publike ti kërkojë Shoqërisë Konkensionare që të mos e aplikojë Tarifën e Indeksuar, atëherë Shoqëria Konkensionare, pa paragjykuar ndonjë të drejtë të saj sipas kësaj Kontrate:

(i) nuk do ta aplikojë Tarifën e Indeksuar; dhe

(ii) 1 muaj përpara përfundimit të Vitit kalendarik në të cilin duhet të ishte aplikuar Tarifa e indeksuar, do ti dërgojë Autoriteti Kontraktor trafikun e ndodhur deri në atë datë dhe një parashikim për trafikun deri në fund të atij Viti kalendarik, së bashku me një përlllogaritje të kompesimit që duhet të marrë nga Autoriteti Kontraktor si pasojë e mosaplikimit të indeksimit të Tarifës (në vijim “Kompesimi për Indeksimit të Tarifës”); dhe

(iii) Shoqëria Konkensionare ka të drejtë të marrë Kompesimin për Indeksimin të Tarifës brenda 6 muajve nga përfundimi i Vitit kalendarik në të cilin duhet të ishte aplikuar Tarifa e indeksuar; dhe

(iv) Autoriteti Kontraktor dhe ministria përgjegjëse për financat do të marrin masat e nevojshme për të siguruar Kompesimin për Indeksimit të Tarifës sipas paragrafit (iii) më sipër.

72.5 Në përputhje me Dokumentacionin e Ofertës, duke filluar nga fillimi i vitit të dytë të plotë kalendarik që nga Data e Fillimit të Operimit, Tarifa e përlllogaritur në lekë do të indeksohet sipas indeksit të ndryshimit të kursit të këmbimit nga euro në lekë të vitit paraardhës (të përlllogaritur në bazë të të dhënave të Bankës së Shqipërisë).

72.6 Pavarësisht nga parashikimet e nenit 72.5, në rastin që kursi mesatar i këmbimit ndërmjet Lekut dhe Euros gjatë 30 (tridhjetë) ditëve paraprirëse gjatë një Viti të Kontratës ndryshon në një faktor që e kalon 5% (pesë përqind) nga kursi i këmbimit që ekzistonte në kohën e rregullimit më të fundit dhe ky ndryshim nuk kthehet përsëri brenda 5% (pesë përqind) të normës origjinale të këmbimit brenda 30 (tridhjetë) ditësh prej saj, Shoqëria Konkensionare ka të drejtën të aplikojë rritje të Tarifës bazuar në rregullimet e parashikuara në nenin 72.5, duke i zbatuar ato për periudhën që ka kaluar nga fillimi i Vitit të Kontratës deri në momentin e përlllogaritjes. Këto përshtatje mund të bëhen maksimumi 3 (tri) herë për Vit Kontrate.

72.7 Palët bien dakord që pavarësisht nga rezultati i përlllogaritjeve të kryera sipas këtij Neni 72 (Shkalla e Tarifës), Tarifa nuk do të ulet përtej nivelit të përcaktuar në nenin 72.1 më sipër.

72.8 Përveç parashikimeve të mësipërme, secila Palë ka të drejtë t’i propozojë Palës tjetër rritje shtesë të Tarifës, por ajo nuk mund të ndryshohet pa miratimin e të dyja Palëve.

Neni 73. Klasifikimi i Automjeteve

73.1 Në zbatimin e Tarifës përlllogaritet dhe taksimi i Automjeteve, në varësi të klasës së automjetit sipas tabelës më poshtë:

Klasa e automjeteve	Përshkrimi	Koeficienti i klasës/Tarifës
1	Motoçikletë/triçikël	0.5
2	Automjete të lehta	1
3	Automjete të ulëta me 3 akse	1.5

	dhe automjete të larta me 2 akse	
4	Automjete të ulëta me 4 akse dhe automjete të larta me 3 akse	2
5	Autobusë me më pak se 4 akse	2-3
6	Automjete të ulëta me 5 akse dhe automjete të larta me 4 aks	3
7	Automjete të ulëta me 6 akse dhe automjete të larta me 5 akse	3-4
8	Automjete të larta me 6 akse	4
9	Të gjitha automjetet me 7 ose më shumë akse	5

73.2 Në rastin e një Ndryshimi në Ligj në lidhje me klasifikimin e automjeteve, dispozitat në paragrafin më sipër do të përshtaten sipas rastit. Shoqëria Koncesionare i propozon Autoritetit Kontraktor për miratim (ky miratim nuk do të refuzohet pa arsye) rregullimet përkatëse në koeficientët e Tarifës për t'u përshtatur me kategorizimin e ri, në një mënyrë të tillë që niveli i ri i të Ardhurave nga Tarifat të mos ndryshojnë nga të Ardhurat e Tarifave të projektuara në Modelin Financiar. Nëse propozimi refuzohet, Shoqëria Koncesionare do të rishikojë dhe një herë ndryshimet që të reflektojnë vërejtjet e Autoritetit Kontraktor. Ndryshimet e bëra që kanë reflektuar vërejtjet e Autoritetit Kontraktor, do të konsiderohen përfundimtare dhe nuk do kenë më nevojë për aprovimin nga Autoriteti Kontraktor. Në rast se me përshtatjen e bërë në bazë të kategorizimit të ri do të ishte e nevojshme rumbullakimi i koeficientëve të Tarifës dhe aplikimi i tij do të shkaktonte një ulje të të Ardhurave të pritshme të Tarifës në krahasim me nivelin aktual të të Ardhurave të Tarifave për Vitin paraardhës, rumbullakimi do të bëhet duke iu përafëruar shifrës më të lartë.

Neni 74. Metoda e pagesës së Tarifës nga Përdoruesit, TVSH-ja

74.1 Përdoruesit do të mund ta paguajnë Tarifën me (i) para në dorë në lekë ose në Euro, (ii) me kartë debiti ose me kartë krediti, ose (iii) në forma pagesash të tjera që mund të përdoren në të ardhmen. Opsioni se cila formë pagese do të përdoret, zgjidhet nga çdo Përdorues i veçantë.

74.2 Shoqëria Koncesionare duhet të pranojë pagesat elektronike me anë të një sistemi elektronik të vjeljes së Tarifave (ETC) të paktën në njërën korsi të Rrugës, e cila duhet të funksionojë në të dyja kahet e rrugës. Sistemi ETC që Shoqëria Koncesionare do të blejë dhe përdorë duhet të jetë

në përputhje me Direktivën Europiane 2004/52/KE dhe duhet të minimizojë në maksimumin e mundshëm riskun e mospagimit të Tarifës. Me qëllim që të pasqyrojë kërkesat e pasjes së një sistemi ETC funksional, Shoqërisë Koncesionare i jepet një periudhë 1 (një) vjeçare, që nga Data e Fillimit të Operimit, përpara se kjo dispozitë të bëhet e zbatueshme.

74.3 Pagesat e Tarifës do t'i nënshtrohen TVSH-së, sikurse parashikohet në Ligj.

Neni 75. Regjistrimi i informacionit për Tarifat

75.1 Shoqëria Koncesionare monitoron dhe mban të dhëna të plota dhe të sakta për të gjitha të Ardhurat nga Tarifat dhe të dhëna për trafikun dhe e përfshin këtë informacion në raportet e ecures vjetore, në përputhje me parashikimet te Neni 107 (*Pasqyrat Vjetore të Pagesave*) të kësaj Kontrate.

75.2 Autoriteti Kontraktor herë pas here (me shpenzimet e veta) i inspekton, monitoron ose i kontrollon këto të Ardhura nga Tarifa dhe të dhënat e trafikut dhe kryen kontrole te Shoqëria Koncesionare dhe/ose Enti Kombëtar i Operimit të Rugës në lidhje me zbatimin e Tarifës.

Neni 76. Përdoruesit e përjashtuar

76.1 Autoriteti Kontraktor dhe Shoqëria Koncesionare bien dakord që Lista e Përdoruesve të Përjashtuar e pasqyruar në Shtojcën 3 (*Lista e Përdoruesve të Përjashtuar*), është lista e plotë e Përdoruesve që lejohen të udhëtojnë në Rugë pa pagesë dhe që nuk u kërkohet të paguajnë Tarifën, ndërsa të gjithë Përdoruesit e tjerë duhet të paguajnë Tarifën.

76.2 Asnjëra nga Palët nuk mund të shtojë ose heqë ndonjë person apo grup njerëzish nga Shtojca 3 (*Lista e Përdoruesve të Përjashtuar*), pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës tjetër.

76.3 Nëse me marrëveshje me shkrim mes tyre Palët bien dakord që të aplikojnë Tarifa të reduktuara për një/disë kategori Përdoruesish, rimbursimi i diferencës së Tarifës do t'i bëhet Shoqërisë Koncesionare nga Autoriteti Kontraktor sipas parashikimeve te Neni 108 (*Pagesat Vjetore*).

Neni 77. E drejta për të nxjerrë të Ardhura Shtesë

Për aq sa lejohet me Ligj, Shoqëria Koncesionare mund të përdorë Rugën për të nxjerrë të Ardhura Shtesë, përveç të Ardhurave nga Tarifa. Nëse kërkohet nga Ligji propozimet për të nxjerrë të Ardhura Shtesë do t'i nënshtrohen miratimit të Autoritetit Kontraktor ose Autoritetit Përkates. Të Ardhurat Shtesë do të shpërndahen në mënyrë të barabartë midis Shoqërisë Koncesionare dhe Autoritetit Kontraktor, pas zbritjes së Shpenzimeve të lidhura me realizimin e të Ardhurave Shtesë.

Neni 78. Evazioni i Tarifës

Në rast se një Përdorues bën Evazion Tarife, përgjegjësia i ngelet Shoqërisë Koncesionare që ka lejuar përdoruesin e rrugës të bëjë Evazion Tarife, gjithësi pas kërkesës me shkrim nga ana e Shoqërisë Koncesionare, Autoriteti Kontraktor i jep të gjithë ndihmën e arsyeshme Shoqërisë Koncesionare për arkëtimin e Tarifës nga Përdoruesit, duke përfshirë, por pa u kufizuar me ofrimin e pranisë së arsyeshme të policisë rrugore në Rugë dhe duke reaguar në mënyrë efikase ndaj kërkesave të Shoqërisë Koncesionare në lidhje me zbatimin e Tarifës.

KREU 11 NGJARJE TË VEÇANTA

Neni 79. Forca Madhore

79.1 “Ngjarje e Forcës Madhore” është një ngjarje që nuk është në kontrollin e Palëve dhe që nuk mund të parashikohej prej tyre si dhe që sjell për pasojë që Pala e Dëmtuar që e pretendon të mos jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e parashikuara në këtë Kontratë, përfshirë, pa u kufizuar në:

- a) çdo akt i natyrës duke përfshirë, por duke mos u kufizuar te, zjarri, përmbytja, ose çdo katastrofë tjetër natyrore, si tërmeti, uragani, tornadoja, goditja nga meteori ose nga një trup tjetër qiellor;
- b) pushtimi, lufta, kryengritja, revolucioni, lufta civile, konflikti i armatosur, gjendja e jashtëzakonshme e vendosur me Ligj, terrorizmi ose embargoja
- c) rrezatimi jonizues ose kontaminimi kimik apo biologjik;
- d) shpërthimet e shkaktuara nga pajisjet supersonike ose shpërthime të tjera;
- e) shpërthimi bërthamor ose kontaminimi radioaktiv;
- f) epidemitë apo pandemitë;
- g) dhe ngjarje të tjera të ngjashme që nuk janë në dorë të asnjërës prej Palëve dhe që sjellin për pasojë që njëra nga Palët të mos jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e parashikuara në këtë Kontratë.

79.2 Asnjë Palë nuk ka të drejtë të konsiderojë Palën tjetër në mospërmbushje dhe në shkelje të detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate, për shkak të një Ngjarjeje të Forcës Madhore dhe në masën që një Ngjarje e Forcës Madhore e pengon të kryejë detyrimet e veta.

79.3 Kur ndodh një Ngjarje e një Force Madhore, Pala e Dëmtuar e njofton Palën tjetër pa vonesë në përputhje me afatet respektive të përcaktuara në këtë Kontratë. Njoftimi përfshin hollësitë për ndikimin e kësaj ngjarjeje në detyrimet e Palës së Dëmtuar dhe për çdo veprim të propozuar për zbutjen e pasojave të saj.

79.4 Pas një njoftimi të tillë, Palët konsultohen me njëra tjetrën pa vonesë dhe me mirëbesim bëjnë përpjekje të arsyeshme për të rënë dakord për kushtet e përshtatshme për zbutjen e efekteve të Ngjarjes së shkaktuar nga Forca Madhore dhe për të lehtësuar realizimin në vijimësi të Kontratës.

Neni 80. Shkaku i Lehtësimit

80.1 “Shkak Lehtësimi” janë ngjarjet e mëposhtme që i linden Shoqërisë Koncesionare:

- a) shkelje nga ana e Autoritetit Kontraktor dhe/ose të autorizuarit prej tij e çdo detyrimi thelbësor të parashikuar në këtë Kontratë që e bën Shoqërinë Koncesionare të mospërmbushë detyrimet e parashikuara me këtë Kontratë, për një periudhë më të gjatë se 30 (tridhjetë) Ditë Pune;
- b) dështimi nga ana e Autoriteti Kontraktor për të bërë Dorëzimin e Territorit të Projektit apo për t'i vënë në dispozicion Shoqërisë Koncesionare Territorin e Projektit;

- c) dështimi nga ana e Autoriteti Kontraktor për t'i siguruar Shoqërisë Koncesionare Gëzimin e Qetë dhe hyrje-dalje në Shesh pas Datës së Fillimit të Punimeve;
- d) moskryerja ose vonesa e Pagesave nga Autoriteti Kontraktor;
- e) çdo Ndryshim në Ligj i cili e bën të pamundur ose e pengon në mënyrë të konsiderueshme zbatimin e Kontratës nga ana e Shoqërisë Koncesionare apo/dhe dëmton interesin e tij financiar dhe ekonomik sipas kësaj Kontrate;
- f) çdo Veprim Shtetëror Thelbësisht në Kundërshtim me Kontratën;
- g) zbulimi në Shesh i Objekteve Arkeologjike ose i atyre të Trashëgimisë Kulturore, përfshirë varreza dhe përkujtime, ose sende të tjera me rëndësi arkeologjike, gjeologjike ose historike, janë zbuluar në/ose rreth Territorit të Projektit;
- h) zbulimi i Infrastrukturës së Paparashikuar Publike;
- i) zbulimi i Materialeve të Rrezikshme;
- j) Ngjarje të Forcës Madhore;
- k) zbulimi i një Problemi të Mbartur, që pengon Shoqërinë Koncesionare në përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në këtë Kontratë;
- l) Mospajisja e Shoqërisë Koncesionare jo për faj të Shoqërisë Koncesionare, me Miratimet e Nevojshme dhe/ose Miratimet e Nevojshme nga Autoriteti Kontraktor, para Datës së Fillimit të Punimeve, kur prej Shoqërisë Koncesionare janë marrë të gjitha masat dhe janë plotësuar të gjitha kriteret ligjore dhe detyrimet kontraktore për marrjen e tyre ;
- m) Mospajisja, heqja, revokimi, shpallja e pavlefshmërisë dhe/ose ndryshimi (pa kërkesën e Shoqërisë Koncesionare) i Miratimeve të Nevojshme dhe/ose Miratimeve të Nevojshme nga Autoriteti Kontraktor jo për faj të Shoqërisë Koncesionare pas Datës së Fillimit të Punimeve;
- n) Lindja e një mosmarrëveshjeje që zgjidhet në përputhje me Nenin 132 (*Përshkallëzimi dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve*);
- o) greva, braktisja e punës nga punëmarrësit, për aq sa këto ngjarje zhvillohen në të gjithë sektorin përkatës dhe jo vetëm tek Shoqëria Koncesionare;
- p) trazira civile, protesta që kanë për pasojë mbylljen e Rrugës, ndalimin e Shërbimeve, apo bllokimin e Sheshit ose të një pjese të tij;
- q) një Situatë e Jashtëzakonshme Gjeoteknike ose humbja apo dëmtimi aksidental, që u bëhet Punimeve ose Rrugës, Segmenteve të Rrugës ose pjesëve të saj;
- r) çdo ngjarje apo shkak tjetër që është parashikuar shprehimisht si Shkak Lehtësimi në këtë Kontratë.

80.2 Në rast se, si rrjedhojë e një Shkakut Lehtësimi Shoqëria Koncesionare vonohet në kryerjen e Punimeve ose Shërbimeve sipas Kontratës dhe/ose nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e tjera të saj që rrjedhin nga kjo Kontratë, Koncesionari/Shoqëria Koncesionare mund të kërkojë përfitimet e mëposhtme të aplikueshme sipas rastit, në formën e:

- a) një shtyrjeje të datës së parashikuar të përmbushjes së detyrimit përkatës dhe të gjitha afateve kohore për detyrimet që pasojnë për vonesën e pësuar nga Shoqëria Koncesionare; dhe/ose
- b) ndryshimit të detyrimeve të tij përfshirë penaltete të lidhura me to, nëse ka të tilla, për aq dhe në masën sa ato janë prekur nga ndodhja e Shkakut të Lehtësimit; dhe/ose
- c) moszbatueshmërisë të dispozitave për zgjidhjen e Kontratës për Mospërmbushjen e Detyrimeve të Koncesionarit/Shoqërisë Koncesionare për aq sa Shkaku i Lehtësimit ka shkaktuar mospërmbushjen ose ka kontribuar materialisht për të; dhe ose
- d) zgjatjes së Periudhës së Koncesionit, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar..

80.3 Pavarësisht nga sa më lart, në (i) rastet e ngjarjeve të parashikura në nënparagrafët (a), (c), (d), (f), (m) të Nenit 80.1, (ii) rastet e përmendura në Kontratë përfshirë nenet 13.2, 67.3, që sjellin kosto për Shoqërinë Koncesionare, dhe duhet t’i kompensohen, në shtesë të përfitimeve të parashikuara në paragrafin 80.2, Koncesionari ose Shoqëria Koncesionare mund të kërkojë dhe kompensim për Dëmet e pësuar, me përjashtim të kostove që rrjedhin nga ngjarje të Forcës Madhore.

80.4 Pavarësisht nga parashikimet e Nenit 80.3 më lart, në rastet kur Shoqëria Koncesionare gjendet në kushtet e Ngjarjes së Forcës Madhore dhe Palët nuk vendosin ta zgjidhin Kontratën në përputhje me dispozitat e Nenit 99 (*Zgjidhja e Kontratës për Shkak të Ngjarjes së Forcës Madhore*), kostot e lindura si rrjedhojë e Ngjarjes së Forcës Madhore që nuk mbulohen nga Sigurimet do të ndahen mes të dyja Palëve në mënyrë të barabartë (50% me 50%).

80.5 Përveçse kur vonesa në zbatimin e afateve të poshtëpërmendura të njoftimit nuk është shkaktuar nga Shoqëria Koncesionare ose është shkaktuar për arsye që nuk varen nga Shoqëria Koncesionare, Shoqëria Koncesionare siguron përfitime sipas Nenit 80.1, 80.2 dhe 80.3 më sipër, në rrethana kur ka njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e Pavarur për kërkesën e saj për të marrë ndonjë prej këtyre përfitimeve pa vonesa të tepërta, por gjithsesi, jo më vonë se maksimumi:

- a) 30 (tridhjetë) Ditë Pune pasi Shoqëria Koncesionare ka marrë dijeni për ndodhjen e Shkakut të Lehtësimit; dhe
- b) jo më vonë se 30 (tridhjetë) Ditë Pune pas dorëzimit të njoftimit të përmendur në paragrafin më sipër:

1) i ka dhënë Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të Pavarur një shpjegim të plotë dhe të hollësishëm për Shkakun e Lehtësimit me kusht që, në rast se informacioni i plotë nuk është i disponueshëm brenda 30 (tridhjetë) Ditësh Pune nga dhënia e njoftimit sipas Nenit 80.5 (a) më sipër, Shoqëria Koncesionare duhet të dërgojë një njoftim ku të parashtrojë të gjithë informacionin e disponueshëm dhe çdo 7 (shtatë) Ditë Pune pas paraqitjes të këtij informacioni, t’u japë informacion të mëtejshëm Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të Pavarur;

2) në rastin e një vonese, e ka njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e Pavarur për kohëzgjatjen e përafërt të kësaj vonese;

3) e ka njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e Pavarur për humbjen e pritshme të të ardhurave, ose për një rritje të kostove që rezultojnë nga një Shkak Lehtësimi; dhe

4) t'i ketë provuar Inxhinierit të Pavarur se:

- (i) Shkak i Lehtësimit ka rezultuar ose do të rezultojë në shtyrjen e Punimeve ose Shërbimeve, mospërmbushjen e detyrimeve të tjera të Shoqërisë Koncesionare, shtimin e kostove, ose mosgjenerimin e të ardhurave nga Shoqëria Koncesionare; dhe
- (ii) Shoqëria Koncesionare i ka bërë të gjitha përpjekjet e arsyeshme në përputhje me Praktikën e Mirë të Industrisë për të parandaluar apo zbutur pasojat e një Shkak Lehtësimi, nëse një gjë e tillë ishte e mundur.

80.6 Nëse Shoqëria Koncesionare i ka përmbushur detyrimet e parashikuara në Nenin 80.5 më lart dhe Inxhinieri i Pavarur bën një njoftim ku deklaron se ka ndodhur një Shkak Lehtësimi dhe se Shoqërisë Koncesionare i duhet hequr përkatësisht përgjegjësia për mospërmbushjen e detyrimit të saj, në përputhje me Nenin 80.1 më lart, atëherë:

- a) kur është e përshtatshme, data e programuar e përfundimit paraprak të Segmentit përkatës ose data e programuar e përfundimit të Segmentit përkatës ose data e programuar e realizimit të Shërbimit përkatës shtyhet për një periudhë kohore të përcaktuar nga Inxhinieri i Pavarur, por gjithsesi jo më të shkurtër sesa periudha e vonësës e shkaktuar nga Shkak i Lehtësimit; dhe
- b) sipas rastit zbaton, parashikimet e Nenit 80.3; dhe
- c) Autoriteti Kontraktor nuk e ushtron të drejtën e tij të përfundimit të parakohshëm të Kontratës për shkak të Mospërmbushjeve nga Shoqëria Koncesionare të detyrimeve të tij, shkaktuar nga Shkak i Lehtësimit; dhe
- d) Autoriteti Kontraktor i ofron Shoqërisë Koncesionare mundësinë e përjashtimit nga detyrimet e tij që rrjedhin nga kjo Kontratë, të cilat përcaktohen nga Inxhinieri i Pavarur.

80.7 Njoftimi me shkrim i Inxhinierit të Pavarur në lidhje me ndodhjen e një Shkak Lehtësimi është detyrues për Palët, përveçse kur njëra nga Palët e kundërshton me shkrim atë brenda 10 (dhjetë) Ditëve Pune nga data e njoftimit të Inxhinierit të Pavarur në përputhje me procedurën e mëposhtme:

- a) Brenda 10 (dhjetë) Ditëve Pune nga kundërshtimi i Palës, Palët do të kryejnë një takim të parë së bashku edhe me Inxhinierin e Pavarur për të diskutuar në detaje argumentet e Palëve si dhe të Inxhinierit të Pavarur në lidhje me Shkakun e Lehtësimit.
- b) Pas takimit të parë, Palët mund të kryejnë dhe 2 (dy) takime të tjera me një hapësirë kohore prej 10 (dhjetë) Ditësh Pune njëra nga tjetra.
- c) Brenda 10 (dhjetë) Ditësh Pune nga takimi i fundit, Inxhinieri i Pavarur do të dalë me një vendim përfundimtar i cili është i detyrueshëm për Palët përveçse kur ato vendosin të zbatojnë parashikimet e bëra te Neni 132 (*Përshkallëzimi dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve*) i kësaj Kontrate.

80.8 Palët bien dakord që, nëse ndonjëra nga Palët e kundërshton vendimin e parashikuar me lart,

sipas parashikimeve të Neni 132 (*Përshkallëzimi dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve*) të kësaj Kontrate për të zgjidhur mosmarrëveshjen e lindur sipas këtij Neni, atëherë deri në marrjen e një vendimi të Gjykatës, Shoqëria Koncesionare ka të drejtën, por jo detyrimin, që të pezullojë Punimet apo Shërbimet. Shoqëria Koncesionare, në çdo rast, mban përgjegjësi për dëmin e shkaktuar prej pezullimit të punimeve apo shërbimeve të kësaj kontrate, në rast të një vendimi përfundimtar, i cili përcakton se mos implementimi dhe zbatimi i kontratës së koncesionit ka ardhur për faji të shoqërisë koncesionare.

80.9 Shoqëria Koncesionare është e detyruar të njoftojë Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e Pavarur menjëherë në rast se merr dijeni për ndonjë informacion tjetër dhe/ose material në lidhje me një Shkak Lehtësimi, si dhe të njoftojë Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e Pavarur për hollësitë e një informacioni të tillë, të cilat janë të reja ose që tregojnë se informacioni i dhënë më parë ka qenë thelbësisht i pasaktë dhe/ose i gabuar.

Neni 81. Veprimi Shtetëror Thelbësisht në Kundësjtim me Kontratën

81.1 Një “**Veprim Shtetëror Thelbësisht në Kundësjtim me Kontratën**” nënkupton rastet kur, Autoriteti Kontraktor, pas Datës së Nënshkrimit të kësaj Kontrate merr apo dështon të ndërmarrë ndonjë veprim të çdo natyre, ose nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate, Marrëveshjes së Monitorimit, Koordinimit referuar Shërbimit të Operimit ose në përputhje me Ligjin (përveç veprimeve apo mosveprimeve të ndërmarra nga Autoriteti Kontraktor për të zbutur efektet e shkeljes nga ana e Shoqërisë Koncesionare), efekti i të cilave ndikon drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë mbi Shoqërinë në shpenzimet apo të ardhurat, apo pozicionin ekonomik dhe financiar të saj, duke përfshirë, por pa u kufizuar në to dhe:

- a) mospërmbushjen nga ana e Autoritetit Kontraktor apo ndonjë Autoriteti Përkates tjetër, të ndonjë detyrimi ligjor, ose të mos ekzekutojë ose të mos zbatojë ndonjë të Drejtë të Shoqërisë Koncesionare;
- b) një Ndryshim në Ligj i cili, pas zbatimit të dispozitave mbi Ndryshimin e Ligjit në përputhje me Nenin 82.1 (*Ndryshimet në Ligj*) në këtë Kontratë, ende ndikon negativisht në aftësinë e Shoqërisë Koncesionare për të ndërmarrë, kryer dhe përfunduar Punimet dhe Shërbimet apo Mirëmbajtjen e Rrugës, si dhe zbatimin e kësaj Kontrate;
- c) veprimi ose mosveprimi përbën abuzim të pushtetit qeveritar, ose është diskriminues nga vetë natyra apo efekti që krijon, ose është i papajtueshëm me Ligjin dhe /ose krijon pengesa apo Dëm;
- d) Shpronësimi, rekuizimi, konfiskimi apo shtetëzimi i kuotave të Koncesionarit/Shoqërisë Koncesionare ose të Të Drejtave të tjera të Shoqërisë Koncesionare, pa shkak ligjor të ligjshëm;
- e) çdo ndalim apo kushtëzim në marrjen dhe transferimin e përfitimeve apo të ardhurave të Koncesionarit/Shoqërisë Koncesionare, kapitalit apo financimeve (sipas dokumenteve financiare) jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (përfshirë ndalimin dhe kufizimin e këmbimit valutor);
- f) kufizime ose masa me efekt të ngjashëm në lidhje me punësimin e personelit të nevojshëm, pavarësisht nga kombësia e tyre dhe/ose banimi, përveç kufizimeve për dënime penale nga gjykata kompetente;

- g) një Ndryshim Cilësues në Ligj që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në realizimin e Objektit të Kontratës. Për të shmangur çdo dyshim, një Ndryshim Cilësues në Ligj, për çështje të kompensimit ekonomik, do të trajtohet nga Shoqëria Koncesionare, ose sipas zbatimit të dispozitave mbi Ndryshimin Cilësues në Ligj në përputhje me Nenin 82.2 (*Ndryshimet në Ligj*) në këtë Kontratë, ose si një Veprim Shtetëror Thelbësisht në Kundërshtim me Kontratën, dhe jo si dy ngjarje të veçanta së bashku.

81.2 Kur Shoqëria Koncesionare është penguar, pengohet ose vonohet në punën e saj, për shkak të një Veprimi Shtetëror Thelbësisht në Kundërshtim me Kontratën, Shoqëria Koncesionare njofton Autoritetin Kontraktor, sa më shpejt që të jetë e mundur, dhe i bën të ditur:

- a) ekzistencën dhe natyrën e Veprimit Shtetëror Thelbësisht në Kundërshtim me Kontratën;
- b) efektet e këtij veprimi mbi punën e Shoqërisë Koncesionare;
- c) hapat që Shoqëria Koncesionare ka ndërmarrë për të shmangur efektet negative të këtij veprimi në punën e Shoqërisë Koncesionare.

Autoriteti Kontraktor, me marrjen e njoftimit, ka të drejtë të kërkojë që Shoqëria Koncesionare t'i dorëzojë informacione shtesë dhe dëshmi mbështetëse.

81.3 Autoriteti Kontraktor do të ketë një afat prej jo më shumë se 45 (dyzet e pesë) Ditësh Pune, nga data e marrjes së këtij njoftimi me shkrim, për të bërë çdo përpjekje të mundshme për të ndrequr situatën, e cila rikthen gjendjen e përgjithshme ekonomike të Shoqërisë Koncesionare në atë në të cilën do të ishte nëse ky Veprim Shtetëror Thelbësisht në Kundërshtim me Kontratën nuk do të kishte ndodhur. Nëse Autoriteti Kontraktor nuk do të ndikojë në ndreqjen e tij brenda këtij afati, Palët do të konsultohen brenda 14 (katërmëdhjetë) ditësh kalendarike pas skadimit të kësaj periudhe me qëllim arritjen e një zgjidhjeje të përbashkët, të pranueshme për situatën.

81.4 Në rast se një zgjidhje reciprokisht e kënaqshme e situatës nuk është arritur në kuadër të kësaj periudhe 14 (katërmëdhjetë) ditore kalendarike nëpërmjet:

- a) një rregullimi apo përshtatjeje të nevojshme, apo pagese dhe/ose zgjatje afati, që mund të jetë e drejtë dhe e arsyeshme duke marrë në konsideratë rrethanat; dhe/ose
- b) një lehtësimi monetar të drejtë dhe të arsyeshëm sipas rrethanave; dhe/ose
- c) një zgjatjeje të Periudhës së Koncesionit,

atëherë, Shoqëria Koncesionare mundet që (i) të vazhdojë zbatimin e detyrimeve të saj në bazë të Kontratës duke e konsideruar Veprimin Shtetëror Thelbësisht në Kundërshtim me Kontratën si Shkak Lehtësimi, ose (ii) të zgjidhë Kontratën në përputhje me klauzolën për zgjidhjen e parakohshme të Kontratës për Mospërmbushje të Autoritetit Kontraktor, pa asnjë përgjegjësi apo dëm, apo kosto për Shoqërinë Koncesionare, në rast se çdo mjet juridik tjetër i parashikuar në këtë Kontratë nuk do të jetë i mjaftueshëm për të vendosur Shoqërinë Koncesionare në një pozicion ekonomik të njëjtë krahasuar me pozicionin në të cilin ndodhej, përpara ndodhjes së Veprimit Shtetëror Thelbësisht në Kundërshtim me Kontratën, duke mbajtur parasysh të drejtat dhe detyrimet e vazhdueshme të Shoqërisë Koncesionare sipas kësaj Kontrate, Projektit dhe çdo marrëveshjeje tjetër të parashikuar në këtë Kontratë.

Neni 82. Ndryshimet në Ligj

82.1 Nëse ndodh një Ndryshim në Ligj i cili nuk është Ndryshim Cilësues i Ligjit, i cili kërkon nga Shoqëria Koncesionare të amendojë, ndryshojë, Projektin, cilësinë, ose vëllimin e Punimeve ose Shërbimeve, Shoqëria Koncesionare paraqet një propozim për ndryshim në përputhje me Neni 50 (Ndryshime të Kërkuara nga Shoqëria Koncesionare).

82.2 Do të konsiderohet “Ndryshim Cilësues i Ligjit”:

a) Ndryshimi Diskriminues i Ligjit;

b) Ndryshimi Specifik i Ligjit; ose

82.3 Do të konsiderohet “**Ndryshim Diskriminues i Ligjit**”, Ndryshimi i Ligjit, i cili zbatohet në mënyrë specifike:

a) për Projektin dhe jo për projekte të ngjashme; ose

b) për Koncesionarin/Shoqërinë Koncesionare dhe për asnjë Person tjetër; ose

c) për Nënkontraktorët e angazhuar në Projekt ose për shoqëritë tregtare të angazhuara në projekte të ngjashme me Projektin dhe për asnjë Person tjetër.

82.4 Do të konsiderohet “**Ndryshim Specifik i Ligjit**” një Ndryshim i Ligjit që i referohet specifikisht ofrimit të Shërbimeve ose Punimeve në lidhje me rrugë të njëjta ose të ngjashme me Shërbimet dhe Punimet e parashikuara me këtë Kontratë, ose shoqërive tregtare aktiviteti kryesor i të cilave është ofrimi i shërbimeve dhe i punimeve rrugore të njëjta ose të ngjashme me Shërbimet dhe Punimet e parashikuara me këtë Kontratë.

82.5 Për të shmangur çdo dyshim, përveç ndryshimeve të parashikuara te Neni 82.2 Ndryshimet Cilësuese në Ligj të cilat (i) nuk ndikojnë në mënyrë të pafavorshme në aftësinë e Shoqërisë Koncesionare për të ushtruar, respektuar ose kryer ndonjë nga të drejtat dhe detyrimet sipas kësaj Kontrate ose që nuk ndikojnë në ligjshmërinë, vlefshmërinë, natyrën detyruese ose zbatueshmërinë e kësaj Kontrate apo (ii) që nuk ndikojnë në ligjshmërinë, vlefshmërinë, natyrën detyruese ose zbatueshmërinë e kësaj Kontrate dhe (iii) janë me karakter të përgjithshëm në Ligjin e Tatimeve dhe/ose Taksave të aplikueshëm në të gjitha subjektet në Republikën e Shqipërisë nuk do të konsiderohen Shkak Lehtësimi dhe/apo kompensimi të Shoqërisë Koncesionare.

Neni 83. Efektet e Ndryshimit Cilësues në Ligj

83.1 Nëse ndodh, apo pritët të ndodhë, një Ndryshim Cilësues i Ligjit, secila nga Palët mund të njoftojë me shkrim Palën tjetër dhe Inxhinierin e Pavarur për efektet e mundshme të një ndryshimi të tillë, duke specifikuar:

a) nëse kërkohet përjashtim nga përmbushja e detyrimeve, duke përfshirë detyrimin për të arritur datën e programuar të përfundimit të Segmentit përkatës;

b) çdo ndryshim të nevojshëm në Punime apo Shërbimet që shkaktohet apo rezulton nga një Ndryshim i tillë Cilësues në Ligj;

c) nëse kërkohet ndonjë ndryshim në kushtet e kësaj Kontrate ose të Dokumentacionit të Projektit;

- d) nëse zbatimi i Ndryshimit Cilësues të Ligjit do të rezultojë drejtpërdrejt në rritjen e kostove apo në humbjen e të ardhurave të Shoqërisë Koncesionare;
- e) çdo Shpenzim Kapital që kërkohet për të zbatuar Ndryshimin Cilësues në Ligj, ose që mund të kursehet;
- f) çdo Miratim i Nevojshëm që do të kërkohet për të zbatuar një Ndryshim Cilësues në Ligj; dhe
- g) mënyrën në të cilën Ndryshimi Cilësues në Ligj mund të prekë çmimet e vëna nga furnizuesit për Shërbimet, duke përfshirë firmat e operuara nga Ortakët e Shoqërisë Koncesionare, ose Shoqëritë e tyre të Lidhura.

83.2 Nëse, si rezultat i një Ndryshimi Cilësues në Ligj:

- a) Shoqëria Koncesionare nuk është në gjendje të kryejë Punimet, me qëllim që të jetë në gjendje të sigurojë certifikimet përkatëse në lidhje me përfundimin e një Segmenti përkatës deri në datën e programuar për përfundimin e tij;
- b) Shoqëria Koncesionare nuk është në gjendje të përmbushë ndonjërin nga detyrimet e saj që rrjedhin nga kjo Kontratë; ose
- c) Shoqërisë Koncesionare i kanë lindur ose do t'i lindin kosto, të cilat ndryshe nuk do t'i kishin lindur, ose nuk ka gjeneruar ose nuk do të gjenerojë të ardhura, të cilat ndryshe do t'i kishte gjeneruar po të mos kishte ndodhur një Ndryshim i tillë Cilësues në Ligj,

në këtë rast Shoqëria Koncesionare ka të drejtë të sigurojë një përfitim në formën e:

- i. shtyrjes së duhur të Datës së Programuar të Përfundimit të Punimeve të Segmentit përkatës, e cila do të jetë e përshtatshme dhe e mjaftueshme për të përfunduar Punimet;
- ii. ndryshimeve të nevojshme të Dokumentacionit të Projektit për të marrë parasysh dhe reflektuar Ndryshimin Cilësues në Ligj;
- iii. të drejtës së kompensimit; dhe/ose
- iv. një zgjatjeje të Periudhës së Koncesionit sipas parashikimeve të Ligjit 125/2013 “*Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat*”, i ndryshuar ; dhe/ose
- v. mosaplikimin e dispozitave për zgjidhjen e njëanshme të Kontratës për faj të Shoqërisë Koncesionare, nëse ka njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Inxhinierin e Pavarur lidhur me këto pretendime brenda një afati jo më shumë se 60 (gjashtëdhjetë) Ditë Pune nga hyrja në fuqi e Ndryshimit të Ligjit.

83.3 Në rast të ekzistencës së kushteve të sipërcituara, Palët do të takohen për të diskutuar për efektet e sjella nga Ndryshimi Cilësues i Ligjit brenda 20 (njëzet) Ditësh Pune nga aprovimi i tij dhe do të përpiqen të arrijnë një marrëveshje brenda 30 (tridhjetë) Ditësh Pune nga takimi i tyre. Në rast se Palët nuk bien dakord për mënyrën se si duhet adresuar Ndryshimi Cilësues i Ligjit, atëherë Shoqëria Koncesionare ka të drejtë të zgjidhë mosmarrëveshjen e lindur sipas këtij Neni dhe sipas parashikimeve të Kreut 19 Neni 132 (*Përshkallëzimi dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve*)

të kësaj Kontrate.

KREU 12 PËRGJEGJËSIA, PENALITETET, PALËT E TRETA

Neni 84. Përgjegjësi solidare

Palët pranojnë që Koncesionari dhe Shoqëria Koncesionare janë solidarisht përgjegjëse për përmbushjen e kushteve të kësaj Kontrate.

Neni 85. Penalitetet

85.1 Nëse si rezultat i Mospërmbushjes së Shoqërisë Koncesionare, përfundimi i Veprës nuk realizohet brenda afateve të përcaktuara në Grafikon e Punimeve për fajin e Shoqërisë Koncesionare, Autoriteti Kontraktor mund të dërgojë një Njoftim për Mospërmbushje të Detyrimeve të Shoqëria Koncesionare në përputhje me parashikimet e Neni 97 (*Zgjidhja si Pasojë e Mospërmbushjes së Detyrimeve nga Shoqëria Koncesionare*), duke i vënë në dispozicion një kohë të arsyeshme për të kryer veprimet korrigjuese, por jo më pak se 30 (tridhjetë) Ditë Pune pas dorëzimit të Njoftimit për Korrigjim të Shoqëria Koncesionare.

85.2 Në qoftë se Shoqëria Koncesionare nuk ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme korrigjuese për të përmirësuar shkaqet e mospërmbushjes të vëna në dukje në Njoftimin për Mospërmbushje të Detyrimeve, brenda një kohe të arsyeshme, ajo i paguan Autoritetit Kontraktor penalitet në masën 0.0001 % të Vlerës së Investimit për çdo muaj vonesë. Ky penalitet fillon të aplikohet menjëherë pas përfundimit të një periudhe prej 60 (gjashtëdhjetë) Ditësh Pune nga data e fundit e afatit të përcaktuar në Njoftimin për Mospërmbushje të Detyrimeve të dërguar nga Autoriteti Kontraktor sipas Neni 85.1.

85.3 Në rast të konstatimit të shkeljeve që çojnë në aplikimin e sanksioneve sipas këtij Neni, Autoriteti Kontraktor dhe Shoqëria Koncesionare do të diskutojnë për një periudhë 90 (nëntëdhjetë) ditore lidhur me shkeljen. Kur vendoset për aplikimin e penalitetit përkatës, penaliteti paguhet në llogari të Autoritetit Kontraktor brenda 90 (nëntëdhjetë) Ditësh Pune nga njoftimi i Autoritetit Kontraktor.

85.4 Shuma totale e të gjitha sanksioneve të aplikueshme, sipas rastit, nga kjo Kontratë në ngarkim të Shoqërisë Koncesionare, gjatë gjithë Kohëzgjatjes së Kontratës nuk do të tejkalojë shumën e siguruar të Garancisë së Kontratës.

Neni 86. Dëmshpërblimi ndaj Autoritetit Kontraktor në lidhje me Palët e Treta

86.1 Shoqëria Koncesionare merr përsipër të kompensojë dëmin ose kërkesën për dëmshpërblim të Autoritetit Kontraktor në lidhje me çdo pretendim për dëm të ndonjë Pale të Tretë, të vërtetuar nga një vendim gjyqësor i formës së prerë në bazë të ngjarjeve apo mosveprimeve apo ndonjë rrethane tjetër të lidhur me mosplotësimin e detyrimeve të Shoqërisë Koncesionare sipas kësaj Kontrate, ose me ndonjë veprim apo mosveprim tjetër të Shoqërisë Koncesionare.

86.2 Detyrimi i Shoqërisë Koncesionare për të dëmshpërblyer Autoritetin Kontraktor siç parashikohet në këtë Nen, do të reduktohet në mënyrë proporcionale me masën që veprimet ose mosveprimet neglizhente të Autoritetit Kontraktor apo Autoriteteve Përkatëse ose ndonjë prej përfaqësuesve ose punonjësve të tyre kanë kontribuar për këtë dëm.

86.3 Pavarësisht nga çdo parashikim i ndryshëm në këtë Kontratë, Koncesionari apo Shoqëria

Koncesionare nuk do të jenë përgjegjës për pretendime për dëme, humbje, dëmtime, Defekte, riparime dhe vonesa në zbatimin e Punimeve, të cilat kanë ardhur si rezultat nga:

a) veprimi apo mosveprimi me faj i Autoritetit Kontraktor ose i Palës së Autoritetit Kontraktor ose i një Pale të Tretë;

b) shkelja nga Autoriteti Kontraktor e kësaj Kontrate ose e Ligjit, si dhe shkelja e Autoritetit Përkatës;

c) veprimi i Shoqërisë Koncesionare është kryer sipas udhëzimeve të Përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktor;

d) veprimi i Shoqërisë Koncesionare është kryer plotësisht sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate, Ligjit dhe Miratimeve të Nevojshme.

e) Ngjarjeve të Forcës Madhore;

KREU 13 SIGURIMET

Neni 87. Sigurimet

87.1 Shoqëria Koncesionare mban sigurimet e nevojshme të Projektit në bazë të Shtojcës 1 (Sigurimet) me kushtet e përcaktuara në këtë Shtojcë dhe këtë Nen (“**Sigurimet**”). Shoqëria Koncesionare ia dërgon kushtet e propozuara të Sigurimeve Autoritetit Kontraktor për t’i parë dhe për të dhënë pëlqim të paktën 30 (tridhjetë) Ditë Pune përpara blerjes së një Sigurimi të tillë. Brenda 30 (tridhjetë) Ditësh Pune nga marrja e kushteve të propozuara nga Shoqëria Koncesionare, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kërkojë amendamente në kushtet e propozuara të Sigurimeve (duke vepruar me arsye), nëse këto nuk pasqyrojnë kërkesat e Shtojcës 1 (Sigurimet) ose të këtij Neni.

87.2 Shoqëria Koncesionare do të bëjë përpjekje të arsyeshme që dhe Nënkontraktorët e saj të blejnë dhe mbajnë të gjitha sigurimet që kërkohen nga Ligji.

87.3 Shoqëria Koncesionare është përgjegjëse të përballojë me shpenzimet e veta të gjitha kostot që lidhen me Sigurimet. Fakti që Shoqëria Koncesionare është ose jo e detyruar të blejë sigurimin e risqeve të caktuara sipas kësaj Kontrate, nuk e cenon Palën që përballon pasojat financiare të një risku të tillë.

Neni 88. Kushtet dhe afatet e Sigurimeve

88.1 Sigurimet:

a)do të realizohen me shoqëri sigurimi;

b)do të mbajnë të pacënuar kërkesat për dëmshpërblim të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor; dhe

c)në rast anulimi, ndryshimi apo mosrinovimi të tyre, i duhen njoftuar me shkrim Autoritetit Kontraktor të paktën 30 (tridhjetë) ditë kalendarike përpara.

88.2 Shoqëria Koncesionare do të bëjë kërkesë për dëmshpërblim nga Sigurimet që Shoqëria Koncesionare ka në shkallë të disponueshme, për të ulur vlerën e çdo kërkesë të Shoqërisë Koncesionare ndaj Autoritetit Kontraktor, në bazë të kësaj Kontrate. Vlera e një kërkesë të Shoqërisë Koncesionare për dëmshpërblim nga Autoritetit Kontraktor në bazë të kësaj Kontrate,

duke përfshirë edhe në lidhje me një Ngjarje të Forcës Madhore, do të ulet me shumën e përftuar efektivisht nga Shoqëria Koncesionare në bazë të Sigurimeve.

88.3 Secila nga Palët do të shmangë kryerjen e veprimeve, ose do të kryejë të gjitha veprimet e arsyeshme, me qëllim mënjanimin e situatave që do të rezultojnë në refuzimin nga ana e një siguruesi të Sigurimit për të paguar një kërkesë për dëmshpërblim në bazë të çdo Sigurimi.

Neni 89. Dokumentacioni lidhur me Sigurimet

89.1 Shoqëria Koncesionare, me kërkesë me shkrim tek Autoritetit Kontraktor, i jep atij:

- a) kopje të të gjitha policave të sigurimit që lidhen me Sigurimet (bashkë me çdo informacion tjetër të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në lidhje me këto polica sigurimi);
- b) dëshmi se primet e pagueshme sipas të gjitha policave të sigurimit, të lidhura me Sigurimet, janë paguar dhe Sigurimet janë në fuqi të plotë, në përputhje me dispozitat të KREU 13 (Sigurimet) dhe Shtojcën 1 (Sigurimet); dhe
- c) sa më shpejt që të jetë e mundur, por gjithsesi në apo përpara datës së rinovimit, kopje të dokumentit provizor të sigurimit në lidhje me Sigurimet, nëse është e zbatueshme.

Neni 90. Risku i Pasigurueshëm

Në rast Risku të Pasigurueshëm, ai do të jetë subjekt negocimi me marrëveshje midis Palëve.

Neni 91. Mosblerja dhe mosmbajtja e Sigurimeve

91.1 Nëse Shoqëria Koncesionare është në shkelje të Nenit 87 (Sigurimet) më lart, Autoriteti Kontraktor i kërkon me shkrim Shoqërisë Koncesionare të paraqesë pranë tij Sigurimet me vlefshmëri të plotë, brenda 30 (tridhjetë) Ditëve Pune nga marrja e njoftimit. Nëse Shoqëria Koncesionare është në shkelje të këtij Neni, pas marrjes paraprakisht të miratimit me shkrim nga Shoqëria Koncesionare, Autoriteti Kontraktor mund të paguajë çdo prim të kërkuar për të mbajtur në fuqi Sigurimet e përcaktuara të Nenit 87 (Sigurimet) më lart ose mund të blejë vetë një Sigurim të tillë. Në secilin rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë t'i rikuperojë këto shuma nga Shoqëria Koncesionare me anë të një kërkesë me shkrim duke dokumentuar pagesat e kryera.

91.2 Asnjë parashikim i këtij Neni nuk e detyron Shoqërinë Koncesionare të paguajë sigurimin në lidhje me një Risk të Pasigurueshëm, përveçse kur shkakun që një risk është bërë Risk i Pasigurueshëm është një veprim ose mosveprim me faj i Shoqërisë Koncesionare.

Neni 92. Përdorimi i të ardhurave nga Sigurimet

Të gjitha të ardhurat e marra nga Sigurimet sipas çdo police të dëmit fizik do të përdoren për riparimin, rehabilitimin dhe zëvendësimin e secilës pjesë ose pjesëve të Rrugës në lidhje me të cilat janë marrë të ardhurat ose për kompensimin e tyre, apo për zëvendësimin e shpenzimeve në rast se riparimi apo rehabilitimi është bërë përpara periudhës së rimbursimit të Sigurimit.

KREU 14 TRANSFERIMI I OBJEKTIT TË KONTRATËS

Neni 93. Procedura për transferimin në fund të Periudhës së Koncesionit

93.1 Jo më vonë se 3 (tre) vjet përpara datës së fundit të Periudhës së Koncesionit, Shoqëria Koncesionare kryen vërtetimin fillestar, me qëllim që të vlerësojë gjendjen e Rugës dhe të ndërmarrë masat e nevojshme, për të kryer planin në lidhje me nevojën e Shpenzimeve Kapitale, nëse ka, si dhe çdo Punim që do të dakordësohet ndërmjet Palëve.

93.2 Jo më vonë se 18 (tetëmbëdhjetë) Muaj përpara kthimit, në bashkërendim me Inxhinierin e Pavarur, Shoqëria Koncesionare përgatit një plan paraprak të vlerësimit të kthimit, i cili do të përdoret për të përcaktuar ecurinë e Mirëmbajtjes së Rugës për pjesën e mbetur të afatit.

93.3 Vërtetimi paraprak i kthimit do të identifikojë çdo Punim rregullues që mund të nevojitet, me qëllim që Ruga të arrijë Standardet e kërkuara, kërkesat e dorëzimit në Datën e Përfundimit të Kontratës, si dhe kostot e vlerësuara të kryerjes së këtyre Punimeve.

93.4 Palët do të negociojnë dhe do të dakordësojnë me shkrim lidhur me hapat dhe procedurat që do të ndiqen në kohën e vënies në dispozicion të Rugës tek Autoriteti Kontraktor.

93.5 Shoqëria Koncesionare ia kthen Sheshin, Infrastrukturën e Operimit, Veprën Autoritetit Kontraktor në Datën e Përfundimit të kësaj Kontrate, në gjendje të mirë dhe funksionale, të mirëmbajtur brenda Standardeve të përcaktuara në Projekt, pa asnjë barrë apo detyrim të mbartur.

Neni 94. Transferimi i parakohshëm

94.1 Nëse njëra nga Palët bën një zgjidhje të parakohshme të Kontratës në përputhje me dispozitat te KREU 15 (*Zgjidhja e Parakohshme e Kontratës*), Palët do të bien dakord lidhur me procedurat që do ndjekin për të kryer dorëzimet e Shesheve apo Veprës sipas rastit (përfshirë për hapat që duhet të ndërmerren për çlirimin e tyre nga barrët apo detyrimet e mbartura) tek Autoriteti Kontraktor, i cili i merr ato në dorëzim (duke përfshirë edhe Punimet e përkohshme). Palët bien dakord që Autoriteti Kontraktor do t'i marrë Sheshet apo Veprën në dorëzim të çliruara nga barrët apo detyrimet e mbartura për sa kohë që ai ka bërë kompensimin e plotë të Shoqërisë Koncesionare në përputhje me dispozitat te KREU 16 (*Kompensimi për Zgjidhjen e Kontratës*).

94.2 Shoqëria Koncesionare do t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor Manualin e Mirëmbajtjes së bashku me të gjitha dokumentet dhe të dhënat që kanë të bëjnë me Projekt-Zbatimin dhe të dhënat e përditësuara gjatë ndërtimit, në shkallën që ato janë finalizuar në kohën e përfundimit, ose, përndryshe, skicat siç janë në gjendjen aktuale.

94.3 Palët mund të diskutojnë lidhur me mundësinë e marrjes së pajisjeve dhe mjeteve të Shoqërisë Koncesionare nga ana e Autoritetit Kontraktor me qëllim përfundimin e Punimeve, pasi Shoqëria Koncesionare të kompensohet për kostot e tyre. Në rast mos dakordësimi, Autoriteti Kontraktor i siguron Shoqërisë Koncesionare hyrje-dalje dhe përdorim të arsyeshëm të Sheshit dhe/ose Veprës për aq kohë sa i nevojitet për largimin e personelit, stafit, pajisjeve dhe makinerive.

Neni 95. Të drejtat pas transferimit

95.1 Përveç të drejtave të shprehura se do të vazhdojnë edhe pas përfundimit të kësaj Kontrate, pas dorëzimit/transferimit Shoqëria Koncesionare nuk mban më përgjegjësi për mirëmbajtjen dhe riparimet e dëmtimeve të mëpasshme të Veprës. Të Drejtat e Shoqërisë Koncesionare në bazë të kësaj Kontrate, duke përfshirë detyrimin e Shoqërisë Koncesionare për të mirëmbajtur Veprën do të përfundojnë automatikisht dhe Autoriteti Kontraktor merr përsipër dhe përfton të drejtat dhe detyrimet e Shoqërisë Koncesionare ndaj Veprës.

95.2 Shoqëria Koncesionare do të bashkëpunojë në mënyrë të arsyeshme me Autoritetin Kontraktor për të siguruar transferimin e Shërbimeve të një Palë e Tretë, e caktuar nga Autoriteti Kontraktor për të operuar dhe mirëmbajtur Veprën pas Datës së Përfundimit të Kontratës.

KREU 15 ZGJIDHJA E PARAKOHSHME E KONTRATËS

Neni 96. Zgjidhja e parakohshme

96.1 Përveç përfundimit të afatit të kësaj Kontrate në Datën e Përfundimit të saj, Palët mund ta zgjidhin këtë Kontratë në përputhje me dispozitat e këtij Kreu.

96.2 Palët bien dakord se Kontrata mund të zgjidhet ose nga ajo mund të hiqet dorë, vetëm për shkaqet e shprehura shprehimisht në dispozitat e këtij Kreu si dhe të ligjit nr.125/2013, datë 25.04.2013 “Për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, i ndryshuar.

96.3 Përfundimi i parakohshëm i kësaj Kontrate bëhet pa cenuar të drejtat dhe detyrimet e Palëve të parashikuara shprehimisht në këtë Kontratë, ose ato të drejta dhe detyrime që zbatohen pas Datës së Përfundimit të Kontratës për shkak të natyrës së tyre.

Neni 97. Zgjidhja si pasojë e Mospërbushjes së Detyrimeve nga Shoqëria Koncesionare

97.1 Do të konsiderohet “**Mospërbushje nga Shoqëria Koncesionare**” çdo ngjarje e mëposhtme që ndodh për faj të Shoqërisë Koncesionare dhe jo si rrjedhojë e veprimeve apo mungesës së veprimeve nga Autoriteti Kontraktor:

- a) shkelja e detyrimeve të Shoqërisë Koncesionare, që:
 - i) prek ndjeshëm dhe për kohë të gjatë aftësinë e Autoritetit Kontraktor për të përmbushur detyrimet e parashikuara me Ligj dhe Kontratë; ose
 - ii) prek ndjeshëm përdorimin e Rrugës nga Autoriteti Kontraktor dhe Përdoruesit;
 - b) në përfundim të procedurës së falimentit, vendimi përfundimtar i gjykatës i cili pranon likuidimin e Shoqërisë Koncesionare, të lidhur me paaftësinë paguese;
 - c) përveçse rasteve kur kjo është e justifikuar nga dispozita të tjera të kësaj Kontrate, mosfillimi i Punimeve nga Shoqëria Koncesionare në përputhje me Grafikon brenda 3 (tre) Muajve nga Data e Fillimit të Punimeve;
 - d) Braktisja e Punimeve nga Shoqëria Koncesionare;
 - e) mosrespektimi i përfundimit të Punimeve sipas Grafikut të Punimeve pjesë e Projekt-Zbatimit;
 - f) mosnxjerrja e Certifikatës së Përdorimit/lejes së shfrytëzimit për të gjitha Segmentet përkatëse të Rrugës brenda afatit përfundimtar për Certifikatën e Përdorimit/lejen e shfrytëzimit;
 - g) Shoqëria Koncesionare nuk bën fillimisht dhe në vazhdimësi Sigurimet e Nevojshme sipas Kontratës;
 - h) Shoqëria Koncesionare shkel kufizimet e vendosura në Kontratë të Neni 10 (*E Drejta e Nënkontraktimit*) për nënkontraktimin;
 - i) Koncesionari shkel kufizimet e vendosura të Kreu 18 Neni 120 (*Transferimi i Kuotave të Shoqërisë Koncesionare*) i kësaj Kontrate; dhe/ose
 - j) mosplotësimi i kushteve paraprake të cilat varen nga veprimet ose mosveprimet e Koncesionarit dhe/ose Shoqërisë Koncesionare sipas dispozitave të parashikuara të Neni 6 i kësaj Kontrate.

97.2 Në varësi dhe të dispozitave të Nenit 97.3 të kësaj Kontrate, në rrethanat kur ka ndodhur një Mospërmbushje nga Shoqëria Koncesionare, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të zgjidhë këtë Kontratë menjëherë pas një njoftimi me shkrim 30 (tridhjetë) Ditë Pune përpara që i bën Shoqërisë Koncesionare (“**Njoftimi për Mospërmbushje të Detyrimeve nga Shoqëria Koncesionare**”).

97.3 Përveçse në rastet e identifikuara në paragrafët (b) dhe (i) të Neni 97.1, përpara se Autoriteti Kontraktor të dërgojë një Njoftim për Mospërmbushje të Detyrimeve nga Shoqëria Koncesionare, Autoriteti Kontraktor do të dërgojë një njoftim për të korrigjuar mospërmbushjen e saj (“**Njoftimi për Korrigjim**”), i cili përmban një përshkrim të mospërmbushjeve nga Shoqëria Koncesionare dhe një periudhë për korrigjimin e tyre, e cila do të jetë jo më pak se 30 (tridhjetë) Ditë Pune pas dorëzimit të Njoftimit për Korrigjim të Shoqëria Koncesionare.

97.4 Autoriteti Kontraktor nuk do t’i dërgojë Shoqërisë Koncesionare Njoftim për Mospërmbushje nëse:

- a) Shoqëria Koncesionare e korrigjon mospërmbushjen deri në datën e parashikuar në Njoftimin për Korrigjim; ose
- b) Në rastin e një Mospërmbushjeje nga Shoqëria Koncesionare, të përcaktuar në gerrat a), c), d), e), f), g), h) të Neni 97.1 i kësaj Kontrate dhe në varësi të Marrëveshjes Financiare, nëse ka, Shoqëria Koncesionare i dorëzon Autoritetit Kontraktor brenda periudhës së korrigjimit të parashikuar në Njoftimin për Korrigjim, një plan të pranueshëm nga Autoriteti Kontraktor për korrigjimin e Mospërmbushjeve nga Shoqëria Koncesionare dhe Shoqëria Koncesionare, pa asnjë vonesë të mëtejshme, në zbatimin e planit në përputhje me kushtet e tij.

97.5 Përveç sa mund të parashikohet në dispozitat e Marrëveshjes së Financimit, nëse ka një Marrëveshje Financimi të tillë, nëse në ndonjë kohë Shoqëria Koncesionare nuk e përmbush planin korrigjues të pranuar nga Autoriteti Kontraktor në përputhje me Nenin 97.4 (b) më lart, Autoriteti Kontraktor mund t’i dërgojë Shoqërisë Koncesionare një Njoftim të dytë për Korrigjim, ku i kërkohet përmbushja e planit brenda një afati të arsyeshëm i cili nuk mund të jetë më pak se 30 (tridhjetë) Ditë Pune. Në rast të mos përmbushjes së planit brenda këtij afati, atëherë Autoriteti Kontraktor i dërgon Shoqërisë Koncesionare, Njoftimin për Mospërmbushje të Detyrimeve të Shoqërisë Koncesionare dhe kjo Kontratë përfundon në datën e përcaktuar në Njoftimin për Mospërmbushje të Shoqërisë Koncesionare.

Neni 98. Zgjidhja e Kontratës si pasojë e Mospërmbushjes së Detyrimeve nga Autoriteti Kontraktor

98.1 Do të konsiderohet “**Mospërmbushje nga Autoriteti Kontraktor**” secila prej ngjarjeve ose fakteve të mëposhtme:

- a) Autoriteti Kontraktor (apo Enti Kombëtar i Operimit Rugor) nuk paguan shumat përkatëse të Pagesave nga Autoriteti Kontraktor sipas Kontratës apo/dhe pagesave apo detyrimeve të tjera të lindura nga Marrëveshja e Monitorimit Koordinimit të Shërbimit të Operimit;
- b) Moskryerja në kohë e Dorëzimit të Territorit të Projektit, pa shkaqe të arsyeshme ;
- c) Shpronësimi, sekuestrimi, marrja në përdorim të përkohshëm nga ana e Autoritetit Kontraktor dhe/apo ndonjë Autoriteti Përkatës, e një pjese me rëndësi të aktiveve të Koncesionarit/Shoqërisë Koncesionare ose të një Nënkontraktori ose i aksioneve/kuotave

të Koncesionarit apo Shoqërisë Konkensionare, për sa kohë këto veprime si më sipër nuk ndodhin si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e një Mospërmbushje nga Shoqëria Konkensionare;

- d) Kalim i Kontratës tek Palë të Treta nga Autoriteti Kontraktor në kundërshtim me dispozitat te Neni 119 (*Transferimi nga Autoriteti Kontraktor*) i kësaj Kontrate;
- e) Shkelje e detyrimeve të Autoritetit Kontraktor dhe/apo Autoriteteve Përkatëse të parashikuara në këtë Kontratë ose në Marrëveshjen e Monitorimit Koordinimit të Shërbimit të Operimit që e bëjnë të pamundur ose e pengojnë në mënyrë të konsiderueshme Shoqërinë Konkensionare që të realizojë Punimet dhe/ose Shërbimet për një periudhë më të gjatë se 1 (një) Muaj;
- f) çdo Ndryshim Cilësues në Ligj, i cili është i paparashikushëm dhe që e bën të pamundur ose e pengon në mënyrë të konsiderueshme zbatimin e Kontratës nga ana e Shoqërisë Konkensionare dhe apo dëmton interesat e saj financiar dhe ekonomik sipas kësaj Kontrate;
- g) çdo Veprim Shtetëror Thelbësisht në Kundërshtim me Kontratën; dhe
- h) Mosplotësimi i kushteve paraprake të cilat varen nga veprimet ose mosveprimet e Autoritetit Kontraktor dhe/ose Palëve të Autoritetit Kontraktor sipas dispozitave të parashikuara te Neni 6 (*Kushtet Paraprake*) i kësaj Kontrate.

98.2 Në rrethana kur ka ndodhur një Mospërmbushje nga Autoriteti Kontraktor, Shoqëria Konkensionare ka të drejtë ta zgjidhë këtë Kontratë me dërgimin e një njoftimi paraprak për Mospërmbushjet nga Autoriteti Kontraktor (**“Njoftimi për Mospërmbushje nga ana e Autoritetit Kontraktor”**).

98.3 Përpara dërgimit të një Njoftimi për Mospërmbushje nga ana e Autoritetit Kontraktor, Shoqëria Konkensionare duhet t’i dërgojë Autoritetit Kontraktor një njoftim për të korrigjuar mospërmbushjen e tij (**“Njoftimi për Korrigjim”**). Njoftimi për Korrigjim duhet të përmbajë një përshkrim të Mospërmbushjeve nga Autoriteti Kontraktor dhe një periudhë për korrigjimin e tyre, e cila do të jetë jo më pak se 30 (tridhjetë) Ditë Pune pas dorëzimit të Njoftimit për Korrigjim te Autoriteti Kontraktor.

98.4 Shoqëria Konkensionare mund të mos i dërgojë Autoritetit Kontraktor Njoftimin për Mospërmbushje nga ana e Autoriteti Kontraktor, nëse:

- a) Autoriteti Kontraktor e korrigjon mospërmbushjen deri në datën e parashikuar në Njoftimin për Korrigjim; ose
- b) Në rastin e një Mospërmbushjeje nga Autoriteti Kontraktor, ky i fundit i dorëzon Shoqërisë Konkensionare një propozim të pranueshëm nga Shoqëria Konkensionare për korrigjimin e Mospërmbushjeve nga Autoriteti Kontraktor brenda periudhës së korrigjimit të parashikuar në Njoftimin për Korrigjim dhe Autoriteti Kontraktor nis zbatimin e planit në përputhje me kushtet e tij pa asnjë vonesë të mëtejshme.

98.5 Nëse Autoriteti Kontraktor nuk e përmbush planin korrigjues të pranuar nga Shoqëria Konkensionare në përputhje me Nenin 98.4 (b) më lart, Shoqëria Konkensionare mund t’i dërgojë Autoritetit Kontraktor një Njoftim të dytë për Korrigjim, ku i kërkohet përmbushja e planit brenda një afati të arsyeshëm i cili nuk mund të jetë më pak se 30 (tridhjetë) Ditë Pune. Në

rast të mos përmbushjes së planit brenda këtij afati, atëherë Shoqëria Koncesionare i dërgon Autoritetit Kontraktor, Njoftimin për Mospërmbushje të Detyrimeve të Autoritetit Kontraktor dhe kjo Kontratë përfundon në datën e përcaktuar në Njoftimin për Mospërmbushje të Autoritetit Kontraktor.

98.6 Në rastet e zgjidhjes së kontratës si pasojë e Mospërmbushjes nga ana e Autoritetit Kontraktor, Data e Përfundimit të Kontratës do të konsiderohet si më poshtë vijon:

- a) Në rastin e një Mospërmbushjeje nga Autoriteti Kontraktor të përcaktuar në germën (c) të Nenit 98.1 është data e dorëzimit të Njoftimit për Mospërmbushje nga Autoriteti Kontraktor; ose
- b) Në rastin e të gjitha Mospërmbushjeve të tjera nga ana e Autoritetit Kontraktor, është një datë jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) Ditë Pune pas dorëzimit tek Autoriteti Kontraktor i Njoftimit të Mospërmbushjeve nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Në rastin e një Mospërmbushjeje nga Autoriteti Kontraktor, të përcaktuar në germën (a) të Nenit 98.1, Autoriteti Kontraktor mund t'i parandalojë pasojat e përfundimit dhe kjo Kontratë nuk përfundon në datën e përcaktuar në Njoftimin për Mospërmbushje nga Autoriteti Kontraktor, në rrethanat kur Autoriteti Kontraktor e korrigjon Mospërmbushjen nga ana e Autoritetit Kontraktor brenda 60 (gjashtëdhjetë) Ditësh Pune nga marrja e Njoftimit për Mospërmbushje.

Neni 99. Zgjidhja e Kontratës për shkak të Ngjarjes së Forcës Madhore

Kur Palët nuk bien dakord për kushte të tilla brenda 6 (gjashtë) Muajsh nga data e fillimit të Ngjarjes së Forcës Madhore, dhe një Forcë e tillë Madhore vazhdon, ose pasojat e saj vazhdojnë të jenë të tilla saqë Pala e Dëmtuar nuk është në gjendje t'i përmbushë të gjitha, ose pjesën më të madhe të detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate, secila nga Palët mund ta zgjidhë këtë Kontratë, duke i dhënë një njoftim paraprak 30 (tridhjetë) Ditë Pune përpara Palës tjetër.

Neni 100. Njoftimi i zgjidhjes së Kontratës

Secila nga Palët që kërkon zgjidhjen e kësaj kontrate në përputhje me pikat e mësipërme, do të njoftojë paraprakisht me shkrim Palën tjetër. Njoftimi duhet të përmbajë:

- a) detajet e duhura duke nënvizuar shkakun e zgjidhjes;
- b) Datën e Përfundimit të Kontratës;
- c) hollësitë e llogaritjes së pagesave si rezultat i zgjidhjes së kontratës;
- d) çdo informacion tjetër të rëndësishëm.

Neni 101. Zgjidhja e Kontratës me konsensus

Palët kanë të drejtë ta zgjidhin Kontratën me pëlqim të dyanshëm të shprehur me shkrim, duke negociuar me mirëbesim mënyrën e kompensimit të Palëve.

KREU 16 KOMPENSIMI PËR ZGJIDHJEN E KONTRATËS

Neni 102. Të përgjithshme

102.1 Nëse kjo Kontratë përfundon përpara kohe, pas dërgimit të Njoftimit për Përfundim të Parakohshëm në përputhje me parashikimet e bëra te KREU 15 (*Zgjidhja e Parakohshme e Kontratës*) i kësaj Kontrate, Autoriteti Kontraktor dhe Shoqëria Koncesionare kanë të drejtë të marrin shumën e Kompensimit të Zgjidhjes së Kontratës në përputhje me këtë Nen.

102.2 Përveç sa mund të parashikohet ndryshe shprehimisht në këtë Kontratë, Palët pranojnë se e drejta për përfundimin e parakohshëm dhe pagesa e shumës së Kompensimit të Zgjidhjes së Kontratës, dhe/ose, sipas rastit, e drejta për zbritjen e pagesave, është një zgjidhje e mjaftueshme për kërkesat e dyanshme në lidhje me përfundimin e parakohshëm të kësaj Kontrate.

102.3 Çdo mosmarrëveshje në lidhje me shumën e llogaritura apo të përcaktuara në përputhje me këtë Nen do të zgjidhet në bazë të parashikimeve të Nenit 132 (*Përshkallëzimi dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve*) të kësaj Kontrate.

Neni 103. Kompensimi për zgjidhje të Kontratës për Mospërmbushje të Shoqërisë Koncesionare

103.1 Në rrethana kur kjo Kontratë zgjidhet për Mospërmbushje të Shoqërisë Koncesionare në përputhje me parashikimet e Nenit 97 (*Zgjidhje si Pasojë e Mospërmbushjes së Detyrimeve nga Shoqëria Koncesionare*) të kësaj Kontrate, Shoqëria Koncesionare i paguan Autoritetit Kontraktor një shumë për zgjidhjen e Kontratës, të barabartë me vlerën kumulative të:

- a) çdo pagese përfshirë, penalitete të aplikuara ndaj Shoqërisë Koncesionare nga Autoriteti Kontraktor, sipas dispozitave të kësaj Kontrate, të akumuluar deri në Datën e Përfundimit të Kontratës; dhe
- b) pa paragjykuar ushtrimin e ndonjë të drejte zëvendësimi të Huadhënësve sipas Nenit 122 (*E Drejta e Zëvendësimit nga Huadhënësit*) pas Datës së Fillimit të Punimeve, çdo kosto ose shpenzim për dorëzimin e posedimit të Veprës dhe transferimin e pronësisë së Qendrës së Mirëmbajtjes nga Shoqëria Koncesionare tek Autoriteti Kontraktor.

Sa më sipër nuk përjashton të drejtën e Autoritetit Kontraktor për të kërkuar ndonjë kompensim ose dëm të shkaktuar kundrejt Autoritetit Kontraktor i cili i takon sipas zbatimit të dispozitave të Ligjit.

103.2 Në rastet kur Shoqëria Koncesionare duhet të kryejë një pagesë ndaj Autoritetit Kontraktor në zbatim të Nenit 103.1 më lart, e gjithë shumën për Kompensimin e Zgjidhjes së Kontratës do të paguhet sa më shpejt që të jetë e mundur.

103.3 Pa paragjykuar të drejtat e Autoritetit Kontraktor, kur zbatohet Neni 103 (Kompensimi për Zgjidhje të Kontratës për Mospërmbushje të Shoqërisë Koncesionare) i kësaj Kontrate, kur kjo Kontratë zgjidhet si pasojë e Mospërmbushjeve të Shoqërisë Koncesionare, në varësi të fazës në të cilën ndodhet Projekti në Datën e Përfundimit të Kontratës, Shoqëria Koncesionare:

- a) **Gjatë Fazës së Zhvillimit** (Periudhës nga Data e Hyrjes në fuqi të Kontratës së Koncesionit deri në përmbushjen e Kushteve Paraprake): Nuk do të përfitojë asnjë kompensim nga Autoriteti Kontraktor.
- b) **Gjatë Fazës së Ndërtimit:** Do të përfitojë të gjitha kostot për zhvillimin dhe implementimin e Projektit (duke përfshirë kostot nga Data e Hyrjes në fuqi të Kontratës së Koncesionit deri në përmbushjen e Kushteve Paraprake, kostot e projektimit dhe ndërtimit), por pa përfshirë kostot shtesë të shpenzuara nga Shoqëria Koncesionare të cilat nuk parashikohen në Kontratë, dhe duke zbritur:
 1. pagesat apo shumën që Shoqëria Koncesionare i detyrohet Autoritetit Kontraktor

sipas kësaj Kontrate (përfshirë edhe pagesat sipas Nenit 103.1 (a) dhe (b); dhe

2. pagesat e arsyeshme të kryera nga Autoriteti Kontraktor për ruajtjen e Punimeve në gjendjen aktuale.

c) Gjatë Fazës së Operimit: Do të përfitojë një kompesim si më poshtë:

Totali i vlerës së Të Ardhurave nga Tarifa, që do të kishte marrë Shoqëria Koncesionare që nga Data e Përfundimit të Kontratës deri në fund të Periudhës së Koncesionit në bazë të Modelit Financiar me përditësimet më të fundit, minus totalin e të gjitha kostove të cilat Autoriteti Kontraktor parashikon të ketë si rezultat i zgjidhjes të Kontratës e cila do të llogaritet.

Në përlllogaritjen e kostove, Autoriteti Kontraktor do të konsiderojë komponentët si vijon (pa i përlllogaritur dy herë):

1. Një vlerësim të arsyeshëm të rrezikut për çdo tejkalim të kostove që do të lindin, pavarësisht nëse është parashikuar apo jo fillimisht;

2. Kostot e realizimit të Punimeve dhe/apo ofrimit të Shërbimeve që parashikohen të jenë të nevojshme për Autoritetin Kontraktor, nga data e zgjidhjes së Kontratës deri në datën e përfundimit të afatit të Kontratës, me qëllim realizimin e Punimeve dhe ofrimit të Shërbimeve të Projektit sipas Standardit të kërkuar;

3. Kostot e nevojshme riparuese në lidhje me Punimet që ka bërë Shoqëria Koncesionare Punimet dhe ofruar Shërbimet e Projektit sipas Standardit të kërkuar (duke përfshirë çdo kosto që Autoriteti Kontraktor parashikon të ketë për të përfunduar Punimet) si dhe kostot operative shtesë të nevojshme me qëllim rikthimin e shërbimeve operative në standardin e kërkuar duke zbritur (në masën që këto shuma janë të llogaritura në kostot e parashikuara në këtë paragraf) shumën e përgjithshme të çdo shume sigurimi të marrë apo që do të merret nga Koncesionari si dhe shumat që paguhen nga Autoriteti Kontraktor për shpenzime kapitale, për aq sa nuk janë paguar.

Të gjitha shumat e parashikuara të të ardhurave dhe kostove sa më sipër duhet të llogariten në terma nominalë sipas çmimeve aktuale të indeksuara.

103.4 Pavarësisht çdo parashikimi tjetër sipas Nenit 103.3 më sipër, në rast se, në vijim të kërkesës së Huadhënësit për të ushtruar të drejtën e zëvendësimit sipas Neneve 122, 123, dhe 124 të kësaj Kontrate, ky zëvendësim nuk kryhet për faj të Autoritetit Kontraktor, atëherë përjashtimisht dhe vetëm në këtë rast, Shoqëria Koncesionare ka të drejtë të përfitojë edhe Detyrimet kundrejt Huadhënësve.

103.5 Për të shmangur çdo dyshim, në përlllogaritjen e detyrimit të Shoqërisë Koncesionare në lidhje me Kompensimin për Zgjidhje të Kontratës për Mospërmbushje nga ana e saj, Autoriteti Kontraktor duhet të përdorë së pari vlerën e Garancisë së Kontratës, përveç nëse afati i Garancisë së Kontratës do të ketë mbaruar në përputhje me këtë Kontratë. Nëse do të ketë një Pagesë nga Autoriteti Kontraktor që është ende e pashlyer në Datën e Përfundimit të Kontratës kjo pagesë do të zbritet nga vlera e Garancisë së Kontratës.

103.6 Në rast të zgjidhjes së Kontratës për shkak të Mospërmbushjes nga Shoqëria Koncesionare të parashikuar nga Neni 97.1 shkronja (b), (d) dhe (j), Shoqëria Koncesionare nuk do të përfitojë asnjë kompensim nga Autoriteti Kontraktor.

103.7 Në funksion të këtij Neni, “Detyrimet Kundrejt Huadhënësve” janë shumat e

komponentëve të mëposhtëm:

(i) principalit, interesave (përfshirë edhe penalitetet për mospagesë, por vetëm atë të konstatuar përpara zgjidhjes së kësaj Kontrate, si rezultat i Mospërmbushjes nga Autoriteti Kontraktor), komisioneve bankare, kostove dhe shpenzimeve të bëra apo të kryera në mënyrë të rregullt apo që Shoqëria Koncesionare i detyrohet apo kanë mbetur pa paguar te Huadhënësit nga ana e Shoqërisë Koncesionare, në bazë të Marrëveshjeve të Drejtpërdrejta deri më Datën e Përfundimit të Kontratës (ku përfshihen edhe kostot e pagesave në rast shlyerjeje kredie përpara kohe); dhe

(ii) të gjitha shumave që Shoqëria Koncesionare u detyrohet Huadhënësve për shkak të zgjidhjes përpara kohe të marrëveshjeve mbrojtëse “hedging” për normën e interesit (ku përfshihen edhe kostot për shlyerje përpara kohe dhe komisionet e angazhimit të pagueshme si rezultat i kësaj), me kusht që Shoqëria Koncesionare dhe Huadhënësit do të mundohen në mënyrë të arsyeshme t’i zbusin këto vlera, për aq sa është e mundur.

Neni 104. Kompensimi i zgjidhjes së Kontratës për shkak Mospërmbushjeje nga ana e Autoritetit Kontraktor

104.1 Do të konsiderohet “Kompensim i Zgjidhjes së Kontratës për Shkak të Mospërmbushjes nga Autoriteti Kontraktor” shuma e barabartë me vlerën kumulative të:

- a) Detyrimeve Kundrejt Huadhënësve që lidhen me Punimet e kryera deri në Datën e Përfundimit të Kontratës;
- b) Vlerën e Punimeve të realizuara deri në momentin e ndërprerjes së Kontratës për shkak të Mosplotësimit nga Autoriteti Kontraktor,
- c) Vlerën e detyrimeve ndaj Palëve të Treta që lindin nga kjo Kontratë dhe që përfshinë Kostot e Zgjidhjes para kohe të Nënkontratave, që lindin nga zbatimi apo zgjidhja e Kontratës;
- d) Kapitalit të Investuar duke zbritur të gjitha pagesat në formën e dividendit apo shpërndarjeve të ngjashme të fitimit, të paguara përpara Datës së Përfundimit të Kontratës (nëse diferenca është pozitive);
- e) Pagesave nga Autoriteti Kontraktor që nuk janë kryer deri në Datën e Përfundimit të Kontratës;
- f) Një shumë e cila kur mblidhet së bashku me dividendët (ose me shpërndarje të ngjashme të fitimit) që Shoqëria Koncesionare ka paguar në bazë të Kapitalit të Investuar në Datën e Përfundimit të Kontratës ose përpara kësaj date, duke mbajtur parasysh momentin kur është kryer në fakt kjo pagesë, jep një normë reale të brendshme kthimi (“Internal Rate of Return” apo “IRR”) mbi Kapitalin e Investuar të barabartë me Normën e Brendshme të Kthimit mbi Kapitalin e Investuar të përcaktuar në Modelin Financiar;
- g) Penalitetet e parashikuara në këtë Kontratë për Autoritetin Kontraktor;
- h) Çdo Dëm tjetër apo e drejtë për kompensim që i lind Shoqërisë Koncesionare, ose që kësaj i është dashur të përballojë apo mbulojë, si pasojë e Mospërmbushjes së Autoritetit Kontraktor si dhe të zgjidhjes së Kontratës për shkak të kësaj mospërmbushjeje; dhe

- i) Kthimin e Garancisë së Kontratës, pas verifikimit dhe zbritjes së ndonjë detyrimi (nëse ka) nga Shoqëria Koncesionare, deri në datën e Mospërmbushjes nga Autoriteti Kontraktor.

104.2 Nëse kjo Kontratë përfundon para kohe për Mospërmbushje nga Autoriteti Kontraktor, ky i fundit i paguan Shoqërisë Koncesionare Kompensimin e Zgjidhjes së Kontratës për Shkak të Mospërmbushjes nga Autoriteti Kontraktor, pa përjashtuar ndonjë kompensim ose Dëm të shkaktuar kundrejt Shoqërisë Koncesionare i cili i takon sipas zbatimit të dispozitave të Ligjit.

Neni 105. Kompensimi i zgjidhjes së Kontratës për Shkak të Ngjarjes së Forcës Madhore

105.1 Shoqëria Koncesionare ka të drejtë të përfitojë “**Kompensimin e Zgjidhjes së Kontratës për shkak të Ngjarjes së Forcës Madhore**”, e cila është shuma e barabartë me vlerën agregate të:

- a) Detyrimeve Kundrejt Huadhënësve që lidhen me Punimet e kryera deri në Datën e Përfundimit të Kontratës;
- b) Kapitalit të Investuar;
- c) Vlerën e detyrimeve ndaj Palëve të Treta përfshirë Kostot e Zgjidhjes para Kohe të Nënkontratave, që lindin nga zbatimi apo zgjidhja e Kontratës;
- d) Pagesat e Autoriteti Kontraktor që i detyrohet Shoqërisë Koncesionare dhe që janë ende të pashlyera në Datën e Përfundimit të Kontratës; dhe
- e) Kthimin e Garancisë së Kontratës, pas verifikimit dhe zbritjes së ndonjë detyrimi (nëse ka) nga Shoqëria Koncesionare, deri në datën e zgjidhjes së Kontratës për shkak të Forcës Madhore.

Minus

- a) Pagesat nga Autoriteti Kontraktor të shlyera përpara Datës së Përfundimit të Kontratës;
- b) Pagesat që Shoqëria Koncesionare ka marrë nga Sigurimet.

105.2 Nëse si rezultat i një Ngjarjeje të shkaktuar nga një Forcë Madhore Shoqëria Koncesionare nuk është në gjendje të përmbushë ndonjë nga detyrimet e saj që rrjedhin nga kjo Kontratë, do të zbatohen dispozitat te Neni 80 (*Shkaku i Lehtësimit*).

105.3 Nëse si rezultat i një Ngjarjeje të shkaktuar nga një Forcë Madhore Autoriteti Kontraktor nuk është në gjendje të përmbushë ndonjë nga detyrimet e tij që rrjedhin nga kjo Kontratë, atëherë Autoriteti Kontraktor mund të marrë një përfitim në formën e:

- a) ndryshimit të detyrimeve të tij për aq sa ato preken nga Ngjarja e Forcës Madhore;
- b) përjashtimit nga zgjidhja e Kontratës për faj të Autoritetit Kontraktor për aq sa mospërmbushja është shkaktuar ose është ndikuar materialisht nga ekzistenca e Ngjarjes së Forcës Madhore,

me kusht që Ngjarja e Forcës Madhore mos të konsiderohet se rrjedh nga një gjendje e paaftësisë paguese të Autoritetit Kontraktor për çfarëdolloj shkaku.

105.4 Autoriteti Kontraktor mund të pretendojë përfitime të tilla vetëm në rrethana kur e ka njoftuar Shoqërinë Koncesionare dhe Inxhinierin e Pavarur për kërkesën e tij për t’i dhënë

ndonjë nga këto përfitime pa vonesë, por gjithsesi jo më vonë se maksimumi:

- a) 20 (njëzetë) Ditë Pune pasi Shoqëria Koncesionare ka marrë dijeni për ndodhjen e një Ngjarjeje të Forcës Madhore; ose
- b) 30 (tridhjetë) Ditë Pune pas ngjarjes së shkaktuar nga Ngjarja e Forcës Madhore.

KREU 17 PAGESAT

Neni 106. Pagesa për rakordimin e të Ardhurave Vjetore nga Tarifa

Duke nisur nga fillimi i Periudhës së Garancisë:

- a) nëse të Ardhurat nga Tarifa që janë arkëtuar për Vitin përkatës janë më pak se Të Ardhurat Bazë për atë Vit të Kontratës, Autoriteti Kontraktor i paguan Shoqërisë Koncesionare Pagesën për Rakordimin e Deficitit të të Ardhurave sipas Shtojcës 4 (*Pagesat e Autoritetit Kontraktor gjatë Periudhës së Garancisë*); ose
- b) nëse të Ardhurat nga Tarifa që janë arkëtuar për Vitin përkatës janë më shumë se sa Të Ardhurat Bazë për atë Vit të Kontratës, Shoqëria Koncesionare i paguan Autoritetit Kontraktor Pagesën e Suficitit të të Ardhurave sipas Shtojcës 4/1 (*Pagesat e Suficitit të Ardhurave ndaj Autoritetit Kontraktor*).

Neni 107. Pasqyrat vjetore të pagesave

107.1 Shoqëria Koncesionare duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktor një deklaratë vjetore të pagesave që Palët i detyrohen njëra-tjetrës përfshirë edhe pagesat e realizuara përgjatë vitit, sipas afateve të përcaktuara në këtë Kontratë ("**Pasqyra Vjetore e Pagesave**") jo më vonë se 1 (një) Muaj pas përfundimit të Vitit të mëparshëm të Kontratës, në lidhje me Vitin e Kontratës paraardhëse ("**Afati i Paraqitjes së Pasqyrave Vjetore të Pagesave**") ku jepen me hollësi informacion mbi:

- a) Pagesa e pagueshme e Pagesës së Suficitit të të Ardhurave;
- b) Kompensimi për Evazion Tarife Rruge;
- c) Të dhënat për të gjitha të Ardhurat Shtesë të fituara në përputhje me dispozitat te Neni 77 (*E Drejta për të Nxjerrë të Ardhura Shtesë*) i kësaj Kontrate; dhe
- d) Të gjitha Pagesat e tjera nga Autoriteti Kontraktor.

bashkë me një faturë në Euro dhe/ose lekë, për shumën që Autoriteti Kontraktor duhet t'i paguajë Shoqërisë Koncesionare ose, sipas rastit, një pasqyrë në Euro dhe/ose lekë të shumës që Shoqëria Koncesionare i detyrohet Autoritetit Kontraktor.

107.2 Në rast se gjatë Periudhës së Operimit, e drejta për të ofruar Shërbimet e Operimit i ka kaluar Entit të Operimit, detyrimi sipas paragrafit të mësipërm për paraqitjen e informacionit mbi pagesat e pagueshme të Pasqyrës Vjetore të Pagesave si dhe çdo detyrim tjetër i lidhur me të i parashikuar në këtë Kontratë, do t'i ngarkohet Entit të Operimit, i cili duhet t'i paraqesë këtë informacion Shoqërisë Koncesionare dhe Autoritetit Kontraktor, jo më vonë se 20 (njëzetë) Ditë pas përfundimit të Vitit të mëparshëm të Kontratës, në lidhje me Vitin e Kontratës paraardhëse.

Neni 108. Pagesat Vjetore

Përveç kur Autoriteti Kontraktor apo një palë e Autoritetit Kontraktor e kundërshton shumën (ose një pjesë të saj) që përmban Pasqyra Vjetore e Pagesave rast në të cilin zbatohen dispozitat të Neni 115 (*Shumat e Kundërshtuara*) veprohet si më poshtë:

- a) kur Autoriteti Kontraktor duhet ta paguajë Shoqërinë Koncesionare në përputhje me parashikimet të Neni 78 (*Evazioni i Tarifës*) Autoriteti Kontraktor ia paguan shumën (ose pjesën e padiskutuar të asaj shume) Shoqërisë Koncesionare brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga afati i dorëzimit të Pasqyrës Vjetore të Pagesave; ose
- b) kur duhet bërë një pagesë nga Shoqëria Koncesionare tek Autoriteti Kontraktor në përputhje me Neni 106 (*Pagesa e Suficitit Të Të Ardhurave Vjetore nga Tarifa*) dhe Neni 107 (*Pasqyrat Vjetore të Pagesave*) më lart, Shoqëria Koncesionare ia paguan atë shumë (ose pjesën e padiskutueshme të asaj shume) Autoritetit Kontraktor brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga Afati i Paraqitjes së Pasqyrës Vjetore të Pagesave.
- c) Për të shmangur çdo keqkuptim, Pagesa vjetore që Autoriteti Kontraktor ose ndonjë Palë e Autoritetit Kontraktor i detyrohet Shoqërisë Koncesionare apo Koncesionarit sipas dispozitave të kësaj Kontrate, trajtojnë rakordimet e diferencave të pagesave ndërmjet Palëve, me bazë vjetore, pa shmangur në ndonjë formë detyrimin e kryerjes së pagesave përkatëse në përputhje me afatet dhe parashikimet e kësaj Kontrate, përfshirë shumat të cilat duhet të paguhën nga Autoriteti Kontraktues dhe/ose Enti Kombëtar i Operimit Rrugor Operimit, në përputhje me parashikimet dhe afatet e Marreveshjes së Operimit.

Neni 109. Kërkesa për Pagesë për Kompensim nga Zgjidhja e Kontratës

Pas marrjes së njoftimit me shkrim për zgjidhjen e Kontratës në bazë të KREU 15 (*Zgjidhja e Parakohshme e Kontratës*), sipas rastit, nga Shoqëria Koncesionare ose Autoriteti Kontraktor, Shoqëria Koncesionare do t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor një listë që specifikon me shkrim të gjitha shumat e pretenduara në bazë të KREU 16 (*Kompensimi për Zgjidhjen e Kontratës*), llogaritjet e hollësishme të secilës shumë të pretenduar, dhe një përshkrim të arsyes që shuma e tillë u bë e pagueshme para Datës së Përfundimit të Kontratës ose është bërë e pagueshme si rezultat i përfundimit të kësaj Kontrate. Kjo listë do t'i bashkëngjitet një certifikimi të një përfaqësuesi të autorizuar të Shoqërisë Koncesionare, që vërteton për dhe në emër të Shoqërisë Koncesionare, për arsyeshmërinë dhe saktësinë e deklaratave të bëra (në vijim, së bashku me listën, “**Kërkesa për Pagesë**”).

Neni 110. Informacioni i kërkuar për përcaktimin e shumës së kompensimit për Zgjidhjen e Kontratës

Gjatë vlerësimit të Kërkesës për Pagesë, Autoriteti Kontraktor mund të mbështetet te çdo informacion dhe/ose dokument bashkëlidhur kërkesës, që i shërben këtij vlerësimi.

Neni 111. Modalitetet e pagesës së Kompensimit për Zgjidhjen e Kontratës

111.1 Autoriteti Kontraktor dhe Shoqëria Koncesionare do takohen brenda 20 (njëzetë) Ditësh Pune nga dorëzimi i Kërkesës për Pagesë për të diskutuar për mënyrën e pagesës të shumës së Kompensimit për Zgjidhjen e Kontratës (nëse do të jetë e plotë, me këste, afatin etj.).

111.2 Nëse Palët dakordësohen për pagesa më këste, pjesët e shumës së Kompensimit të Zgjidhjes së Kontratës, data e pagimit të cilave është shtyrë (nuk është paguar në kohë), do të prodhojnë interes të barabartë me shifrën më të lartë nga (i) interesi i parashikuar nga Ligji, apo (ii) interesi i parashikuar në Marrëveshjen e Financimit, duke filluar nga Data e Përfundimit të Kontratës. Autoriteti Kontraktor mundet që në çdo kohë ta parapaguajë të gjithë përqindjen e mbetur të shumës së Kompensimit të Zgjidhjes së Kontratës, me kusht që ta bëjë këtë në datën e duhur të pagimit të këstit dhe ta njoftojë Shoqërinë Koncesionare jo më vonë se 30 (tridhjetë) Ditë Pune më përpara.

111.3 Nëse Autoriteti Kontraktor nuk arrin të paguajë ndonjë nga këstet e përcaktuara sipas Nenit 111.2 më sipër, Shoqëria Koncesionare mund të kërkojë pagimin e menjëhershëm të shumës së mbetur pa paguar nga shuma e Kompensimit të Zgjidhjes së Kontratës, përfshirë interesin e lindur, duke dërguar një njoftim me shkrim brenda 30 (tridhjetë) Ditësh Pune nga data e marrjes dijeni.

Neni 112. Tatimi mbi vlerën e shtuar

Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe shprehimisht, të gjitha detyrimet dhe shumat sipas kësaj Kontrate llogariten pa TVSH.

Neni 113. Pagesa e Plotë

Përveçse kur është rënë dakord shprehimisht në këtë Kontratë, Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë shumë (që i takon Shoqërisë Koncesionare për Kompensim për Zgjidhjen e Kontratës), të pagueshme në përputhje me parashikimet të KREU 16 (*Kompensimi për Zgjidhjen e Kontratës*) më lart nëse si rezultat i një kompensimi/mbajtje të tillë, shuma që i është paguar faktikisht Shoqërisë Koncesionare në lidhje me zgjidhjen e Kontratës do të jetë më e vogël sesa Detyrimet e papaguara të Shoqërisë Koncesionare Kundrejt Huadhënësve. Në respektim të sa më sipër, Autoriteti Kontraktor mund të kompensojë një shumë që i detyrohet atij nga Shoqëria Koncesionare me shumën për zgjidhjen e Kontratës, vetëm nëse është rënë dakord për një gjë të tillë shprehimisht në këtë Kontratë dhe nëse kjo lejohet sipas Ligjeve.

Neni 114. Monedha e kryerjes së Pagesave

114.1 Përveç rastit të pagesave të Të Ardhurave nga Tarifa që rregullohen sipas parashikimeve të Marrëveshjes së Monitorimit Koordinimit të Shërbimit të Operimit Operimit, kur Palët duhet të bëjnë një pagesë në bazë të Pasqyrës Vjetore të Pagesave apo të Kërkesës për Pagesë, një pagesë e tillë paguhet në Lekë pas këmbimit të shumës në Euro me kursin zyrtar të këmbimit Euro/Lek të Bankës së Shqipërisë në datën e kryerjes së pagesës .

114.2 Në lidhje me të gjitha Pagesat që Autoriteti Kontraktor do duhet të bëjë në bazë të kësaj Kontrate, në rastin kur monedha Lek nuk ekziston më dhe as monedha Euro nuk ekziston më, atëherë llogaritë do të bëhen në monedhën e dollarit amerikan, me një kurs këmbimi ekuivalent me kursin e këmbimit të Euros me dollarin amerikan në Datën e Hyrjes në Fuqi.

Neni 115. Shumat e kundërshtuara

115.1 Kur Autoriteti Kontraktor e kundërshton një shumë të paraqitur në Pasqyrën Vjetore të Pagesave për atë Vit konkret të Kontratës apo në Kërkesën për Pagesë, Autoriteti Kontraktor e

njofton Shoqërinë Koncesionare për mospranimin e tij me shkrim jo më vonë se 20 (njëzetë) Ditë Pune nga dita që Autoriteti Kontraktor merr Pasqyrën Vjetore të Pagesave apo Kërkesën për Pagesë, duke deklaruar arsyet dhe çdo provë të disponueshme që ka për të konfirmuar deklaratat e tij të cilat kundërshtojnë hollësitë e paraqitura në Pasqyrën Vjetore të Pagesave apo Kërkesën për Pagesë.

115.2 Pas përfundimit të periudhës së parashikuar në Nenin 115.1 si më lart, Autoriteti Kontraktor mund të kundërshtojë një vlerë të paraqitur në Pasqyrën Vjetore të Pagesave apo Kërkesës për Pagesë, me kusht që edhe nëse e kundërshton këtë vlerë, ai të bëjë pagesën përkatëse në mënyrë të plotë të vlerës së pranuar dhe të mos ketë të drejtë të mbajë apo kompensojë ndonjë pagesë përkundrejt një vlere të tillë të pranuar, të cilën ndryshe ai do të ishte i detyruar t'ia paguante Shoqërisë Koncesionare, përveç vlerës së diskutuar, për të cilën nuk do të bëjë pagesën përkatëse derisa mosmarrëveshja të zgjidhet në përputhje me parashikimet e bëra te Neni 132 (*Përshkallëzimi dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve*) më poshtë.

Neni 116. Përgjigjja e Shoqërisë Koncesionare në lidhje me shumat e kundërshtuara

Brenda 20 (njëzetë) Ditësh Pune nga marrja e njoftimit të Autoritetit Kontraktor sipas parashikimeve të Neni 115 (*Shumat e Kundërshtuara*) më lart, Shoqëria Koncesionare e njofton Autoritetin Kontraktor nëse pranon apo refuzon llogaritjet e ndryshme të vlerës së parashikuar në Pasqyrën Vjetore të Pagesave apo Kërkesës për Pagesë në njoftimin e Autoritetit Kontraktor dhe:

- a) nëse Shoqëria Koncesionare i pranon llogaritjet e paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, ose nëse nuk bën komente për to brenda kohës së dhënë, përdoret vlera e paraqitur në Pasqyrën Vjetore të Pagesave apo Kërkesës për Pagesë, të paraqitur në njoftimin e Autoritetit Kontraktor; ose
- b) nëse Shoqëria Koncesionare nuk është dakord me llogaritjet e paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, mosmarrëveshja zgjidhet ndërmjet palëve në përputhje me parashikimet të Neni 132 (*Përshkallëzimi dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve*) i kësaj Kontrate.

Neni 117. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në lidhje me Pagesat

Në rastin e një mosmarrëveshjeje ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe Shoqërisë Koncesionare në lidhje me vlerën e parashikuar në Pasqyrën Vjetore të Pagesave apo në Kërkesën për Pagesë, një mosmarrëveshje e tillë zgjidhet në përputhje me parashikimet të Neni 132 (*Përshkallëzimi dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve*).

KREU 18 TRANSFERIMET

Neni 118. Transferimi i Kontratës nga Shoqëria Koncesionare

118.1 Përveçse siç parashikohet te Neni 10 (*E Drejta e Nënkontraktimit*) apo në rrethana të tjera ku lejohet shprehimisht sipas kësaj Kontrate, Shoqëria Koncesionare nuk mund të kalojë apo transferojë (a) këtë Kontratë apo çdo kontratë apo marrëveshje tjetër të lidhur me të, (b) të drejtat dhe detyrimet e tij të përcaktuara këtu apo në kontratat apo marrëveshjet e tjera të lidhura me këtë Kontratë, (c) apo çdo aset, pa aprovimin paraprak të Autoritetit Kontraktor. Pavarësisht nga sa më lart, Shoqëria Koncesionare mund të transferojë Marrëveshjen e Operimit me miratimin paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktor. Autoriteti Kontraktor nuk do të vonojë apo refuzojë në mënyrë të paarsyeshme këtë miratim, duke i dhënë përgjigje Koncesionarit në lidhje me këtë

kërkesë për miratim, jo më vonë se 30 (tridhjetë) Ditë Pune nga dita në të cilën Autoriteti Kontraktor ka marrë kërkesën nga Koncesionari.

118.2 Transferimi i Kontratës nga Shoqëria Koncesionare sipas këtij Neni, me pëlqimin paraprak të Autoritetit Kontraktor, mund të transferohet vetëm pas përfundimit të ndërtimit të veprës, te një Palë e Tretë, që përmbush kërkesat e përshtatshmërisë, të përcaktuara në Dokumentacionin e Tenderit, në bazë të cilit Kontrata është dhënë fillimisht, përveç se nëse:

a) këto kërkesa iu referohen kushteve që nuk janë më të nevojshme për përmbushjen e Kontratës për shkak të faktit se këto detyrime dhe kërkesa të përmendura janë tashmë duke u konsumuar ose duke u realizuar nga Koncesionari dhe/ ose Shoqëria Koncesionare.

b) Transferimi i Kontratës nuk prish cilësinë dhe nuk përkeqëson vazhdimësinë e realizimit dhe të përmbushjes së Kontratës.

118.3 Autoriteti Kontraktues kërkon një miratim paraprak nga Autoriteti Përkatës përgjegjës për financat për të gjitha transferimet e planifikuara të Kontratës, të cilat ndikojnë ose krijojnë rrezikun e ndikimit në ndonjë mënyrë në buxhetin e shtetit ose në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore, ose të cilat mund të ndryshojnë në ndonjë mënyrë mbështetjen financiare, siç përcaktohet nga Ligji Nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, i ndryshuar. Autoriteti kontraktues njofton Autoritetin Përkatës përgjegjës për financat për transferimet e Kontratës të bëra në përputhje me këtë Nen.

Neni 119. Transferimi i Kontratës nga Autoriteti Kontraktor

Autoriteti Kontraktor nuk mund të transferojë këtë Kontratë apo të drejtat dhe detyrimet e tij, pa aprovimin paraprak të Shoqërisë Koncesionare, e cila duhet të shprehet brenda një afati 30 ditor. Shoqëria Koncesionare nuk do të vonojë apo refuzojë në mënyrë të paarsyeshme këtë miratim.

Neni 120. Transferimi i kuotave të Shoqërisë Koncesionare

Në përputhje me Ligjin Nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, i ndryshuar, për çdo ndryshim në Kontrollin e Shoqërisë Koncesionare gjatë Kohëzgjatjes së Kontratës, duhet marrë pëlqimi paraprak me shkrim i Autoritetit Kontraktor dhe të Autoritetit Përkatës për financat, duke vepruar në mënyrë të arsyeshme dhe bazuar në kritere objektive dhe jo në bazë të diskrecionit. Kriteret objektive do të quhen të përmbushura kur Shoqëria Koncesionare provon se pozita ligjore dhe ekonomike e Shoqërisë Koncesionare për zbatimin e Punimeve dhe/ ose Shërbimeve nuk do të përkeqësohet si rezultat i një ndryshimi të tillë. Autoriteti Kontraktor do të japë miratimin e tij apo do e refuzojë duke argumentuar arsyet e refuzimit mbi propozimin për ndryshimin e pronësisë, në përputhje me afatet e parashikuara në Ligjin e mësipërm, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, dhe brenda 30 (tridhjetë) Ditëve Pune nga marrja e miratimit paraprak apo refuzimit nga Autoriteti Përkatës përgjegjës për financat.

Neni 121. Krijimi i Barrëve Siguruese

Për arsye të financimit të Punimeve, Shoqëria Koncesionare ose Koncesionari mund të krijojë barrë siguruese mbi të drejtat, interesat, në përputhje me dhe sipas kësaj Kontrate dhe Ligjin Nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, i ndryshuar.

Neni 122. E Drejta e Zëvendësimit nga Huadhënësit

Pavarësisht nga çdo parashikim i ndryshëm në këtë Kontratë, Palët pranojnë se, në rastin e një Mospërmbushjeje nga Shoqëria Koncesionare sipas kësaj Kontrate, apo sipas Marrëveshjes së Financimit, dhe vazhdimit të rastit të mospërmbushjes deri në skadimin e afatit përkatës për korrigjim, Huadhënësit kanë të drejtë të propozojnë një Shoqëri Zëvendësuese për Autoritetin Kontraktues, e cila do të zëvendësojë Shoqërinë Koncesionare.

Neni 123. Kushtet e Zëvendësimit

Përpara këtij zëvendësimi, Huadhënësit do të duhet të paraqesin prova të mjaftueshme dhe të kënaqshme tek Autoriteti Kontraktor, për Shoqërinë Zëvendësuese që:

- a) ajo është e themeluar dhe regjistruar në mënyrë të rregullt si një shoqëri tregtare dhe që ka mundësinë dhe zotësinë për të qenë palë në marrëveshje të tilla, që mund të kërkohen për zëvendësimin;
- b) ka kapacitetin financiar dhe teknik të mjaftueshëm, për të performuar dhe përfunduar të gjitha detyrimet e Shoqërisë Koncesionare në këtë Kontratë;
- c) ka kapacitetin të paguajë detyrimet financiare, të cilat Autoriteti Kontraktor ka të drejtë ti marrë nga Shoqëria Koncesionare përpara apo në momentin e këtij zëvendësimi; dhe
- d) përmbush të gjitha kërkesat ligjore të përcaktuara në Ligj, apo në legjislacionin përkatës për partneritetin publik-privat dhe koncesionet, apo atë për prokurimin publik.

Neni 124. Koha e Zëvendësimit

Në përputhje me Ligjin Nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, i ndryshuar, Huadhënësit, apo përfaqësuesit e Huadhënësve, siç mund të jetë rasti, kanë të drejtë, pas miratimit nga Autoriteti Kontraktor sipas procedurës së mëposhtme, të bëjnë efektiv zëvendësimin brenda një kohe të arsyeshme pas skadimit të periudhës së korrigjimit, ashtu siç mund të përcaktohet aty. Me qëllim kryerjen e këtij zëvendësimi, Huadhënësit, apo përfaqësuesit e Huadhënësve, ashtu siç mund të jetë rasti, do të njoftojnë qëllimin e tyre tek Autoriteti Kontraktor dhe do t’i japin atij të gjithë informacionin, ashtu siç mund të jetë e nevojshme dhe të kërkohet nga Autoriteti Kontraktor për të verifikuar që kushtet e përcaktuara në këtë Nen janë përmbushur. Autoriteti Kontraktor, brenda një kohe të arsyeshme nga ky njoftim, dhe në çdo rast brenda 20 (njëzetë) ditëve do të informojë Huadhënësit apo përfaqësuesit e tyre, në lidhje me pranimin, ose jo, të zëvendësimit, pranim, i cili nuk mund të mos jepet, në rast se kushtet e përcaktuara të Neni 123 (*Kushtet e Zëvendësimit*) janë përmbushur.

KREU 19 DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 125. Konfidencialiteti

125.1 Palët janë të detyruara të ruajnë konfidencialitetin në lidhje me dispozita të tilla të Kontratës, Shtojcave të kësaj Kontrate dhe Dokumenteve të Projektit, si dhe çdo të dhënë të krijuar dhe mbajtur në përputhje me këtë Kontratë, që përcaktohen në bazë të ligjit si “sekrete tregtare” apo “të dhëna personale”.

125.2 Ky Nen nuk zbatohet në rastin kur informacioni që vihet në dispozicion:

- a) u jepet Palëve që duhet dhe në shkallën që nevojitet për përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Kontrate;
- b) zakonisht është i disponueshëm për Palët, përveç rasteve kur sigurohet si rezultat i shkeljes së detyrimeve në këtë Kontratë;
- c) në përputhje me procedurën e parashikuar te Neni 132 (*Përshkallëzimi dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve*) i kësaj Kontrate, mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
- d) nëse kërkohet sipas Ligjit;
- e) u jepet këshilltarëve profesionistë të Shoqërisë Koncesionare;
- f) Huadhënësve apo këshilltarëve të tyre dhe këshilltarëve të tyre të Sigurimeve; dhe
- g) për respektimin e një vendimi/urdhri të gjykatës apo një akti administrativ të një Autoriteti Përkatës.

125.3 Dispozitat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë pikë, do të vijojnë të mbeten në fuqi gjatë deri në 5 (pesë) vjet pas Datës së Përfundimit të kësaj Kontrate.

Neni 126. Të dhënat e shoqërisë koncesionare

Shoqëria Koncesionare mban dhe ruan të dhëna të plota në lidhje me Rugën duke përfshirë, por duke mos u kufizuar me, të dhënat për kostot faktike apo të parashikuara për operimin e Rugës dhe ofrimin e Punimeve dhe Shërbimeve, kostot e ndërtimit, operimit dhe financimit për gjatë gjithë Kohëzgjatjes së Kontratës.

Neni 127. Miratimi në Heshtje nga Autoriteti Kontraktor

Në rast se bazuar në dispozitat e kësaj Kontrate Autoriteti Kontraktor ka të drejtën apo detyrimin për të dhënë një miratim, mosdhënia e të cilit do të quhet miratim në heshtje, por nuk e ka dhënë miratimin në përputhje me afatin e parashikuar në dispozitat e posaçme të kësaj Kontrate, atëherë me kalimin e atij afati, miratimi do të konsiderohet i dhënë në heshtje. Në rastet kur Autoriteti Kontraktor ka të drejtën apo detyrimin për të dhënë një miratim, mosdhënia e të cilit konsiderohet si miratim në heshtje sipas kësaj Kontrate si dhe për të cilat Kontrata nuk ka parashikuar një afat të posaçëm për miratim, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka dhënë miratimin në heshtje me kalimin e 20 (njëzetë) Ditëve Pune duke filluar nga dita kur Autoritetit i ka lindur e drejta apo detyrimi për të dhënë miratimin.

Neni 128. Njoftimet

128.1 Të gjitha komunikimet me shkrim, të bëra sipas kësaj Kontrate, ose çdo komunikim tjetër në lidhje me këtë Kontratë, nga secila nga Palët, Palës tjetër i dërgohen me një nga mënyrat e mëposhtme:

- a) dorëzim dorazi të komunikimit me shkrim, për sa kohë ky dorëzim protokollohet apo merret konfirmim dorëzimi;
- b) faks; dhe/ose

c) me postë ose me shërbim korrieri rekomande (verifikimi i dërgesës).

Komunikim me shkrim u dërgohet palëve në adresat e mëposhtme:

Kur i dërgohet Autoritetit Kontraktor:

Adresa: Rruga “Deshmoret e Kombit” 1001, Tiranë

Email: info@infrastruktura.gov.al

Për: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Kur i dërgohet Koncesionarit/Shoqërisë Koncesionare:

Adresa:

Email:

Për: “Shoqëria Koncesinare”

128.2 Përveç rasteve kur është përcaktuar shprehimisht ndryshe në Kontratë, Palët bien dakord që kur një njoftim apo kërkesë kërkon përgjigjen, miratimin, refuzimin, apo argumentimin e Palës tjetër, Pala që ka marrë njoftimin apo kërkesën do të shprehet me shkrim në lidhje me qëndrimin e saj brenda 20 (njëzet) Ditësh Pune duke e argumentuar atë.

Neni 129. Pavlefshmëria e pjesshme

Nëse ndonjë dispozitë këtu është, ose bëhet e pavlefshme apo e pazbatueshme, një pavlefshmëri ose pazbatueshmëri e tillë nuk i cenon dispozitat e tjera të kësaj Kontrate. Palët marrin përsipër të zëvendësojnë dispozitën e pavlefshme dhe të pazbatueshme sa më shpejt që të jetë e mundur me një dispozitë tjetër të vlefshme dhe të zbatueshme, përmbajtja e së cilës është e ngjashme me dispozitën e pavlefshme ose të pazbatueshme.

Neni 130. Mbrojtja e të dhënave

130.1 Nëse gjatë zbatimit të kësaj Kontrate Shoqëria Koncesionare do të përpunojë të dhëna personale, ajo do të plotësojë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Ligji Nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, dhe nëse kërkohet pëlqimi i subjektit të të dhënave, një pëlqim i tillë do të merret me qëllim që të dhënat personale të mund t’i jepen Autoritetit Kontraktor.

130.2 Autoriteti Kontraktor nuk do t’i japë një Pale të Tretë (përjashtojë Autoritetin Përkatës), asnjë prej të dhënave konfidenciale pjesë e Dokumentacionit të Ofertës dhe Dokumentacionit të Projektit, pa miratimin e Koncesionarit.

Neni 131. Ligji rregullues

Kjo Kontratë rregullohet nga Ligji Shqiptar.

Neni 132. Përshkallëzimi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

132.1 Autoriteti Kontraktor dhe shoqëria koncesionare duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë

marrveshje me negociata direkte.

132.2 Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së marrveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 133. Amendamentet e Kontratës

133.1 Kjo Kontratë mund të ndryshohet me anë të amendamenteve me shkrim të nënshkuara nga të dyja Palët dhe miratimin e Këshillit të Ministrave.

133.2 Çdo ndryshim i kësaj marrëveshjeje apo Shtojcave bashkëlidhur saj, pasi të hyjë në fuqi, do të jetë pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj kontrate.

Neni 134. Kostot dhe shpenzimet e palëve

Kur nuk parashikohet ndryshe në këtë Kontratë, ose në ndonjë dokument tjetër të Projektit, secila Palë i përballon vetë të gjitha kostot që i rrjedhin në lidhje me zbatimin e kësaj Kontrate dhe të amendamenteve të saj.

Neni 135. Konflikti i Kontratës kundrejt marrëveshjeve të tjera

Nëse dispozitat e kësaj Kontrate bien në kundërshtim me dispozitat e një marrëveshjeje ose kontrate tjetër ndërmjet Palëve në këtë Kontratë, në lidhje me të njëjtin Objekt, pavarësisht nëse një marrëveshje e tillë është bërë përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate, kjo Kontratë do të ketë gjithmonë përparësi.

Neni 136. Heqja dorë nga imuniteti

136.1 Në përputhje me Ligjin, Palët, në mënyrë të përvokueshme dhe të pakushtëzuar, heqin dorë dhe pranojnë se nuk do të ngrenë pretendime për imunitet për veten, të ardhurat, pasuritë ose pronat respektive, në lidhje me çdo procedurë lajmërimi, padie, juridiksioni, procesi gjyqësor, arbitrazhi, vendimi të ndërmjetëm, vendimi gjyqësor, apo ekzekutimi të vendimit. Për të evituar çdo dyshim, heqja dorë nga imuniteti nuk përfshin pasuritë të cilat janë subjekt i parashikimeve të Konventës së Vjenës për marrëdhëniet diplomatike të vitit 1961.

136.2 Heqja dorë nga imuniteti nuk përfshin:

- a) Ambientet e misionit”, të tashme apo të ardhme, sic përcaktohet në Konventën e Vjenës mbi marrëdhëniet diplomatike të nënshkuar në vitin 1961, ambientet konsullore” të tashme dhe të ardhme, siç përcaktohet në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore të nënshkuar në vitin 1963, ose që përdoren nga një diplomat ose mision diplomatik i Shqipërisë ose çdo agjenci ose instrument i tyre;
- b) Asnjë pasuri të paluajtshme sipas nenit 3, paragrafi 1-3 i ligjit nr.8743, datë 22.02.2001 ”Mbi pasuritë e paluajtshme Shtetërore” i ndryshuar;
- c) Asnjë fond monetar/ose shuma monetare të përcaktuara për përmbushjen e detyrimeve që

Republika e Shqipërisë ka në bazë të traktateve, konventave apo marrëveshjeve publike ndërkombëtare të nënshkruara në kapacitetin e saj si Subjekt i së drejtës Ndërkombëtare Publike.

136.3 Palët pranojnë që vendimi përfundimtar i shpallur në kuadër të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve do të jetë detyrues dhe i ekzekutueshëm nga organet gjyqësore të Republikës së Shqipërisë ose të juridiksionit përkatës i cili ka shpallur vendimin përfundimtar.

Neni 137. Vlefshmëria e kësaj Kontrate

Nëse ndonjë term apo dispozitë e kësaj Kontrate rezulton e pavlefshme, kjo pavlefshmëri nuk prek dispozitat e tjera. Në këtë rast dispozita e pavlefshme zëvendësohet nga dispozita përkatëse e ligjit ose nga një dispozitë tjetër, nëse Palët bien dakord. I njëjti kriter vlen edhe në rastin kur ka ndonjë mungesë të paqëllimshme në tekstin e kësaj Kontrate.

Neni 138. Kontrata e plotë

Kjo Kontratë, duke përfshirë edhe Shtojcat, përfaqëson vullnetin e Palëve në lidhje me Projektin dhe zëvendëson çdo marrëveshje të mëparshme ose të gjitha rregullimet, me gojë ose me shkrim, midis Palëve në lidhje me Projektin.

Neni 139. Pamundësia e heqjes dorë nga Kontrata

Asnjë dispozitë e kësaj Kontrate nuk bën të mundur tërheqjen e palëve nga Kontrata. Dështimi i secilës palë, për të përmbushur detyrimet e kësaj Kontrate nuk do të interpretohet asnjëherë si tërheqje nga Kontrata apo heqje dorë nga të drejtat apo detyrimet që rrjedhin nga ajo.

Neni 140. Regjistrimi i Kontratës

Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga miratimi i Projekt-Zbatimit, kjo Kontratë duhet të regjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme, pranë ASHK-së.

Neni 141. Gjuha dhe numri i kopjeve të Kontratës

Kjo Kontratë është hartuar në gjuhën shqipe dhe nënshkruar në 5 (pesë) ekzemplarë me përmbajtje të njëjtë ligjore dhe të barazvlefshëm me njëri-tjetrin.

PALËT

Në emër të Autoritetit Kontraktor:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Përfaqësuar nga:

Emri:

Në emër të Koncesionarit:

“.....”

Emri:

Në emër të Shoqërisë Koncesionare:

“.....”

Emri:

SHTOJCA 1

Sigurimet

KËRKESAT MINIMALE PËR SIGURIMIN PËR NDËRTIMIN, OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN

Pas Datës së Fillimit të Punimeve Shoqëria Koncesionare merr dhe mban mbulimet e mëposhtme në sigurim, nëpërmjet policave të lëshuara nga shoqëri sigurimi të licensuara nga autoriteti përgjegjës në Republikën e Shqipërisë, sipas kushteve të mëposhtme:

PJESA 1. SIGURIMI PER NDËRTIMIN

SIGURIMI I SHOQËRISË KONCESIONARE GJATË PERIUDHËS SË NDËRTIMIT

1. Sigurimi i të gjitha rreziqeve në ndërtim

Mbulimi:

Punimet e Kontratës të realizuara dhe gjatë realizimit materialet dhe punimet provizore, për sa kohë janë në Territorin e Projektit, nga të gjitha rreziqet që shkaktojnë humbje ose dëme materiale.

Shuma e siguruar:

Një shumë e mjaftueshme për të paguar kërkesat për dëmshpërblim dhe jo më të vogël se [●] për qind e Punimeve Kapitale [që mbetet për t'u përcaktuar nga Shoqëria Koncesionare dhe për t'u aprovuar nga Huadhënësi].

Shumat e zbritshme:

Në lidhje me çdo ngjarje të ndodhur, gjatë periudhës së ndërtimit dhe kolaudimit [që mbeten për t'u përcaktuar nga Shoqëria Koncesionare]:

i) nga tërmeti

Jo më shumë se [●] EUR
(mbetet për t'u përcaktuar)

ii) nga stuhia, shtrëngata, përmytja, dëmtimi nga uji, cunami, shembja e tokës

Jo më shumë se [●] EUR
(mbetet për t'u përcaktuar nga

Shoqëria Koncesionare dhe për
t'u aprovuar nga Huadhënësi)

iii) nga çdo shkak

Jo më shumë se [●] EUR
(mbetet për t'u përcaktuar nga
Shoqëria Koncesionare dhe për
t'u aprovuar nga Huadhënësi)

Periudha e mbulimit: Fillon me Njoftimin për fillimin sipas parashikimeve të bëra në (Nënkontratën e ndërtimit) dhe vazhdon gjatë projektimit, prokurimit, përgatitjes së kantierit, ndërtimit, kolaudit, vënies në punë dhe deri në vënien në shfrytëzim të plotë, plus [●] ([●]) muaj periudhë garancie nga Nënkontraktori ndërtimor.

Person i siguruar: Shoqëria Koncesionare, Nënkontraktori ndërtimor dhe furnitorët e Koncesionarit dhe të Nënkontraktorëve ndërtimorë.

Të Përgjithshme:

- Mbulimi përfshin kalimin brenda territorit të Republikës së Shqipërisë të mallrave dhe materialeve të marra me prokurim lokal.
- Dëmet do të paguhen në monedhën me të cilën ka lindur kostoja, pra euro, dollar amerikan ose monedha e vendit.
- Siguruesit dhe risiguruesit heqin dorë nga të gjitha të drejtat e regresit (rikthimit) kundrejt secilës prej palëve të specifikuara këtu.
- Përfshin mbulimin për projektimin me defekt, për aq sa ofrohet ky mbulim.
- Shuma e siguruar do të llogaritet me koston e plotë të zëvendësimit dhe do të përfshijë çdo material pa pagesë që i furnizohen Shoqërisë Koncesionare.
- Polica duhet të përfshijë edhe një rubrikë mbi përgjegjësinë ndaj Palëve të Treta me kufi minimal dëmshpërblimi që mbetet për t'u përcaktuar nga Shoqëria Koncesionare dhe pranohet nga Huadhënësit dhe duhet të përfshijë kryqëzim të plotë të përgjegjësive mes palëve të siguruara.
- Mbulimi CAR do të përmbajë një dispozitë për dëm të fshehtë 50/50.
- Sigurimi do të parashikojë për sa më poshtë:
 - Grevat, turbullirat dhe trazirat civile (SRCC);
 - Kryqëzim i përgjegjësive mes palëve të siguruara;
 - Zgjatje e periudhës së mirëmbajtjes;
 - Grafikon e ndërtimit dhe/ose ngritjes;
 - Punë jashtë orarit, punë gjatë natës, punë gjatë festave zyrtare dhe transport ekspres të mallrave;
 - Objekte në zona tërmeti;
 - Klauzolë 72-orëshe për rreziqet madhore;
 - Largimi i ujërave;
 - Testim i makinerive dhe instalimeve;
 - Kabllon, tubat dhe objektet e tjera nëntokë;
 - Bimët nujqësore, pyjet dhe kulturat;
 - Seksionet;

- Kampet & magazinat;
- Materiale ndërtimi;
- Masa mbrojtëse në lidhje me reshjet, përmytjet dhe mbulimin nga uji;
- Largimin e inerteve;
- Objektet e zjarrfikëse dhe mbrojtjen kundër zjarrit në kantierin e ndërtimit;
- Tranzitin në tokë;
- Riskun e projektuesit;
- Pronat ekzistuese;
- Vibrimet/dobësitë e strukturave mbajtëse;
- Punimet për themel piloti dhe mure mbajtëse;
- Riskun e prodhuesit (për instalimet e/m);
- Impiante dhe pajisje ndërtimi.

Kushte të veçanta

I siguruari merr të gjitha masat përkatëse për të mbrojtur Palët e Treta nga ndonjë aksident/dëm gjatë realizimit të punimeve.

1. Sigurimi kundër humbjeve të shkaktuara nga përfundimi me vonesë i projektit (ALOP)

Mbulimi:

Pagesat e lindura pas vonimit në fillimin e operacioneve të Projektit si rezultat i drejtpërdrejt i humbjes ose dëmtimit fizik të mbuluar nga Sigurimi i të gjitha rreziqeve në ndërtim.

Shuma e siguruar:

Të ardhurat nga Tarifa e Rrugës ose një shumë të paktën e barabartë me shlyerjen e borxhit gjithsej dhe shpenzimet fikse gjatë Periudhës së dëmshpërblimit.

Periudha e dëmshpërblimit: 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e përfundimit paraprak të programuar të Punimeve për Sheshet e Tarifes.

Personi i Siguruar: Shoqëria Koncesionare dhe Huadhënësit.

Shuma e Zbritshme: Jo me shumë se 30 (tridhjetë) ditë.

Te përgjithshme:

Mbulimi duhet të mbulojë moslejimin e hyrjes; mbulim për klientët dhe furnitorët, sipas rastit.

2. Të ndryshme

Sigurime të tjera sipas zakonit, dëshirës apo nevojës në përmbushje të kërkesave vendore ose kërkesave të tjera, si sigurimi i përgjegjësisë kontraktore, sigurimi i kompensimit të punonjësve dhe përgjegjësisë së punëdhënësve në lidhje me të gjithë punëtorët e punësuar në ndërtimin e Projektit dhe sigurim i përgjegjësisë për të gjitha automjetet e zotëruara, të marra me qira të dhëna me qira, të përdorura ose të marra hua për përdorim në Republikën e Shqipërisë në lidhje me Projektin.

PJESA 2- SIGURIMET PËR SHFRYTËZIMIN

Shoqëria Koncesionare merr dhe mban mbulimet e mëposhtme me sigurim, në çdo moment gjatë periudhës së Koncesionarit, nëpërmjet policave dhe nga sigurues të pranueshëm për Huadhënësit dhe për Autoritetin Kontraktor sipas kushteve të mëposhtme:

i. Sigurimi i objekteve të ndërtimit pas përfundimit (CECR)

Mbulimi: Të gjitha aktivet që përbëjnë Projektin, duke përfshirë, ndër të tjera, ndërtesat me çfarë kanë brenda, makineritë, inventarin, pajisjet mbërthyes, pajisje të tjera të vogla dhe të gjitha pasuritë e tjera vetjake nga “të gjitha rreziqet” e humbjes ose dëmit material, ku përfshihen zjarri, rrufeja, shperthimi, rreziqet natyrore (përmytja, tërmeti etj.), terrorizmi dhe sabotimi, grevat, trazirat civile dhe avaria e makinerive.

Shuma e siguruar: Nje shumë e mjaftueshme për të kthyer në gjendjen e mëparshme pronën (mbetjet për t’u përcaktuar nga Shoqëria Koncesionare dhe pranohet nga Huadhënësit).

Shuma e zbritshme: Shuma minimale e përcaktueshme në mënyrë të arsyeshme në përputhje me Ligjin e Sigurimeve

Personi i Siguruar: Shoqëria Koncesionare dhe Huadhënësit.

Të përgjithshme: Të përfshijë një klauzolë për heqje dorë nga të drejtat e regresit (rikthimit) nga siguruesit dhe risiguruesit kundrejt secilës prej palëve të specifikuara këtu.

ii. Ndërprerja e biznesit (operimit)

Mbulimi: Humbja e të ardhurave si rezultat i drejtpërdrejt i humbjes ose dëmtimit të Projektit, të mbuluar nga Neni 1 më sipër.

Shuma e siguruar: Te ardhurat nga Tarifa e Rrugës ose një shumë të paktën e barabartë me shlyerjen e borxhit gjithsej dhe shpenzimet fikse gjate Periudhës së dëmshperblimit.

Periudha e dëmshperblimit: 12 (dymbëdhjetë) muaj

Person i siguruar: Autoriteti Kontraktor Shoqëria Koncesionare dhe Huadhënësit.

Shuma e zbritshme: Shuma minimale e përcaktueshme në mënyrë të arsyeshme në përputhje me Ligjin e Sigurimeve

Të përgjithshme: Të përfshijë një klauzolë për heqje dorë nga të drejtat e regresit (rikthimit) nga siguruesit dhe risiguruesit kundrejt secilës prej palëve të specifikuara këtu.
Mbulim për klientët dhe furnitorët, sipas rastit.

iii. Sigurimi i përgjegjësisë ligjore ndaj Palëve të Treta/publikut/produktet

Mbulimi: Përgjegjësia ligjore e palëve të siguruara për vdekjen ose dëmtimin trupor të Palëve të Treta ose për humbjen ose dëmtimin e pasurive të tyre, që lind nga pasja në pronësi, shfrytëzimi, përdorimi ose mirëmbajtja e Projektit.

Kufiri i dëmshpërblimit: Përcaktohet në marrëveshje me Huadhënësit por jo më pak se [●] EUR [mbetet për t'u përcaktuar nga Huadhënësit kur të afrohet data e përmbylljes financiare] për çdo ngjarje (e shprehur si shumë agregate në lidhje me Përgjegjësinë për produktet dhe risqet e ndotjes).

Shumat e zbritshme: Shuma minimale e përcaktueshme në mënyrë të arsyeshme në përputhje me Ligjin e Sigurimeve

Person i siguruar: Autoriteti Kontraktor Shoqëria Koncesionare dhe Huadhënësit.

Të përgjithshme: Të përfshijnë:
një klauzolë për heqje dorë nga të drejtat e regresit (rikthimit) nga siguruesit dhe risiguruesit kundrejt secilës prej palëve të specifikuar këtu;
një klauzolë për kryqëzim të përgjegjësisë mes palëve të siguruar;
[një klauzolë për vlefshmëri territoriale në të gjithë botën;]
rrjedhje të papritur dhe aksidentale, ndotje dhe kontaminim, dhe kostot e lindura për pastrimin.

iv. Të ndryshme

Sigurime të tjera,

- a) sipas zakonit apo nevojës në përmbushje të kërkesave vendore ose kërkesave të tjera, si sigurimi i përgjegjësisë kontraktore, sigurimi i kompensimit të punonjësve dhe përgjegjësisë së punëdhënësve në lidhje me shfrytëzimin e tij; sigurim i përgjegjësisë për të gjitha automjetet e zotëruara, të marra me qira, të dhëna me qira, të përdorura ose të marra hua për përdorim në Republikën e Shqipërisë në lidhje me Projektin;
- b) që konsiderohen nga Shoqëria Koncesionare si të dëshirueshme ose të nevojshme në kuadër të maturisë, ose që kërkohen nga Huadhënësit ose Autoriteti Kontraktor si sigurimi i anëtarëve të keshillit të administrimit dhe sigurimi i nënpunësve; ose
- c) në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

TË PËRGJITHSHME

- a) Koncesionari kujdeset që çdo policë e blerë në përputhje me këtë shtojcë të parashikojë:
 - i. Kalimin e të drejtave të policave tek Huadhënësit dhe Autoriteti Kontraktues;
 - ii. Klauzolë për të drejtën e të siguruarit për t'iu drejtuar direkt risiguruesit/për kalimin e të drejtave për fondet nga risigurimi;
 - iii. që policat nuk duhen të anulohen, të lihen të skadojnë, të pezullohen apo të ndryshohen lidhur me aspektet material pa njoftim paraprak me shkrim (të paktën 30 ditë) Huadhënësve [dhe Autoritetit Kontraktues] dhe pa marrë miratimin e tyre, ose brenda një periudhe më të shkurtër që mund të përcaktohen më pas në lidhje me luftën dhe rreziqet e lidhura;
 - iv. që mbrojtja që u jepet Huadhënësve në bazë të policave nuk shfuqizohet nga asnjë veprim apo mosveprim nga ana e Shoqërisë Koncesionare apo e Nënkontraktorëve apo nën-Nënkontraktorëve të tij, për aq kohë sa për këtë mbrojtje konsulenti i sigurimeve ka rënë dakord se është i mundshëm në mënyrë të arsyeshme; dhe
 - v. që Autoriteti Konkurrues nuk është përgjegjës përpara siguruesve ose risiguruesve për pagimin e primeve të sigurimit apo për detyrime të tjera të Koncesionarit.
- b) Shoqëria Koncesionare merr dhe u vë në dispozicion Huadhënësve dhe Autoritetit Kontraktor letërgarancitë nga siguruesi/siguruesit dhe brokeri, me formën dhe

përmbajtjen e pranueshme për Huadhënësit [dhe Autoritetin Kontraktor], ku trajtohet, ndër të tjera, njoftimi që i bëhet Autoritetit Kontraktues në rast se siguruesit dhe brokerat marrin dijeni për fakte që mund të prekin mbulimin sipas policës, konfirmimi i pagimit të primit dhe cdo ndryshim i mbulimit, marrjes ose shoqërisë së sigurimit.

c) Çdo policë e bërë në bazë të kësaj shtojce:

- v. mbahet pranë siguruesve dhe risiguruesve të tillë me reputacion, sipas aprovimit të marrë nga Huadhënësit dhe/ose Autoritetit Kontraktues;
- vi. ka formë dhe përmbajtje në përputhje me detyrimet e Shoqërisë Koncesionare sipas kësaj shtojce, sipas rinovimit që mund të merret nga Huadhënësit dhe/ose Autoritetit Kontraktues dhe
- vii. nuk përfshin asnjë dispozitë për vetësigurim ose për fond të mbajtur në vetësigurim me përjashtim për aq sa parashikohen shumat e zbritshme të përcaktuara në këtë shtojcë.

d) Shoqëria Koncesionare u vë në dispozicion Huadhënësve dhe Autoritetit Kontraktor informacionet që mund t'i kërkohen në mënyrë të arsyeshme (si, ndër të tjera, dokumentet origjinale të policës dhe provë që dëshmon pagimin e primeve).

e) Nëse në çdo moment dhe për çdo arsye sigurimi që kërkohet të mbahet në bazë të kësaj shtojce nuk është i vlefshëm dhe në fuqi, pa cënuar të drejtat e Autoritetit Kontraktor Autoriteti Kontraktor ka të drejtë që prej atij momenti të sigurohet me shpenzimet e Shoqërisë Koncesionare.

f) Nëse Autoriteti Kontraktor konsideron në mënyrë të arsyeshme që, si pasojë e një ndryshimi me rëndësi material në ekspozimin e identifikuar ndaj riskut, ndonjëri prej kushteve, vlerave dhe shumave të zbritshme të sigurimit të marrë në bazë të kësaj shtojce është i pamjaftueshëm ose i papërshtatshëm, Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë që Shoqëria Koncesionare të marrë sigurime të ndryshuara dhe/ose shtesë sipas nevojës për të mbuluar ndryshimin me rëndësi materiale në fjalë.

SHTOJCA 2

a) (Draft)

Dispozita të Marrëveshjes së Monitorimit Koordinimit të Shërbimit të Operimit

Palët bien dakord:

Krijimi dhe mirëmbajtja e Infrastrukturës së Monitorimit, Koordinimit, referuar Shërbimit të Operimit realizohet nga Enti Kombëtar i Operimit Rrugor.

Shërbimi i Operimit të Rrugës Milot – Balldre do të realizohet nga Shoqëria Koncesionare nga fillimi i shërbimit të operimit deri në Datën e Përfundimit të Kontratës.

Shërbimi i Operimit që do të realizohet dhe sigurohet nga shoqëria koncesionare përfshin operimin dhe mirëmbajtjen e Infrastrukturës së Operimit përfshirë kabinat, sistemin e portave të automatizuara për lejimin e hyrje daljeve në Rrugë, sensorët e trafikut dhe elementet e tjera matëse, sistemin elektronik për mbledhjen e Tarifave dhe të monitorimit të trafikut, serverat e nevojshëm për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave të trafikut dhe të arkëtimeve përkatëse, si dhe çdo element tjetër të nevojshëm (“**Infrastruktura e Operimit**”) për realizimin e shërbimit të mundësimit të aksesit në Rrugë të Përdoruesve, arkëtimin e Tarifës, kontrollin e trafikut dhe ofrimin e ndihmës për Përdoruesit, parandalimin e shkeljeve, duke përfshirë reagimin në rast ndërhyrjesh urgjente (“**Shërbimi i Operimit**”).

I. Detyrimet e Shoqërisë Koncesionare

Shoqëria Koncesionare ka përgjegjësinë për mirëmbajtjen e Infrastrukturës së Operimit të ndërtuar prej saj, përfshirë çdo element tjetër të nevojshëm për realizimin e Shërbimit të Operimit dhe kontrollin e trafikut të Rrugës.

Shoqëria Koncesionare duhet të ngrejë dhe të mirëmbajë sistemin e operimit për arkëtimin e Të Ardhurave nga Tarifa. Shoqëria Koncesionare do të sigurojë që sensorët e trafikut dhe elementet e tjera raportuese të sistemit të operimit, të dërgojnë të dhënat në sistemin e monitorimit, që do të ketë Enti Kombëtar i Operimit Rrugor dhe persa i perket Sistemit Inteligent të Transportit (SIT) t'i dërgojë këto të dhëna dhe te Qendra Kombëtare e Monitorimit të Trafikut. Sistemi i Entit Kombëtar të Operimit Rrugor dhe sistemi i Qendres Kombëtare të Monitorimit të Trafikut veprojnë në mënyrë të pavarur nga sistemi i monitorimit të Shoqërisë Koncesionare.

Sistemi i operimit i Shoqërisë Koncesionare duhet të garantojë “back-up” të të dhënave në fund të çdo Dite si edhe të jetë i mbrojtur nga ndërhyrjet kibernetike.

Shoqëria Koncesionare do të sigurojë që sensorët e trafikut do të jenë funksionalë 24 orë në ditë, 7 ditë të javës.

Shërbimi i Operimit nga Shoqëria Koncesionare do të kryhet me staf të kualifikuar duke ofruar një shërbim cilësor dhe profesional, që stimulon kënaqësinë e Përdoruesve të Rrugës dhe për rrjedhojë frekuentimin e saj.

Shoqëria Koncesionare do të realizojë Shërbimin e Operimit në përputhje me Kontratën e Koncesionit dhe Procedurat e Bashkërendimit të Operimit, si dhe me Planin e Operimit të Rugës.

Shoqëria Koncesionare duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar/minimizuar incidentet e Evazionit të Tarifës.

Tarifa e Toll do të derdhen në llogarinë e Entit Kombëtar të Operimit Rugor.

Shoqëria Koncesionare do të paguajë për Shërbimin e Monitorimit Koordinimit të Shërbimit të Operimit të realizuar nga Enti Kombëtar i Operimit Rugor, Tarifën për EKORR në përputhje me parashikimet e VKM Nr. 684, datë 6.11.2024 “Për krijimin e shoqërisë aksionare “Enti Kombëtar i Operimit Rugor”sha”.

II. Detyrimet e Entit Kombëtar të Operimit Rugor (EKORR)

Enti Kombëtar i Operimit Rugor ka Përgjegjësinë për Monitorimin dhe Koordinimin e Shërbimit të Operimit.

Enti Kombëtar i Operimit Rugor do të mbikëqyrë të gjitha operacionet e pagesave në rrugët e menaxhuara nga operatorë të ndryshëm si dhe do të bëjë:

- Mbikqyrjen e përputhshmërisë me rregulloret dhe marrëveshjet.
- Sigurimin e integritetit dhe sigurisë së të dhënave.
- Menaxhimin e mosmarrëveshjeve midis operatorëve.
- Auditimin e mbledhjes dhe shpërndarjes së të ardhurave.

III. Sistemi i Unifikuar i Mbledhjes së Tarifave

Për të shmangur përsëritjet e stacioneve të tarifimit në daljet dhe hyrjet e autostradave të lidhura midis tyre (p.sh., midis Autostradës 1 dhe Autostradës 2), do të zbatohet një sistem i unifikuar i mbledhjes së tarifave.

IV. Sistemi i Shpërndarjes së të Ardhurave

Sistemi qendror i Entit Kombëtar të Operimit Rugor do të menaxhojë gjithashtu shpërndarjen automatike dhe të drejtë të të ardhurave të mbledhura të tarifave midis operatorëve bazuar në të dhënat e përdorimit të Rrugëve përkatëse.

V. Rrjeti i Komunikimit

Një infrastrukturë e sigurtë e komunikimit do të mundësojë shkëmbimin e të dhënave në kohë reale midis stacioneve të tarifave dhe bazës qendrore.

Ky draft i shtojcës 2 (dy) do të plotësohet nga palët, brenda afatit të percaktuar në Kontratën e Koncesionit dhe do të miratohet prej tyre pasi të merret dhe mendimi i Ministrisë të Financave.

SHTOJCA 3

Lista e miratuar e përdoruesve të përjashtuar

Këto kategori automjesh kur udhëtojnë për punë zyrtare janë të përjashtuar nga detyrimi për të paguar Tarifën e Përdorimit të Rrugës.

Lista e përdoruesve të përjashtuar për Autoritetin Kontraktor:

1. Automjetet e Policisë Rrugore
2. Autoambulancat
3. Automjetet e Forcave Zjarrfikëse
4. Automjetet Ushtarake, Nato

Lista e përdoruesve të përjashtuar për Palët e Treta të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor:

1. Personat që gëzojnë statusin e invalidit, në bazë të Ligjit Nr. 7889/1994 “*Për statusin e invalidit*”, të ndryshuar, dhe përdorin Automjete vetëm për nevojat e tyre personale e jo për veprimtari private, përjashtohen plotësisht ose pjesërisht në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Lista e përdoruesve të përjashtuar për EKORR gjatë kohëzgjatjes së monitorimit nga ky Ent:

1. Automjetet e personelit të EKORR angazhuar për Shërbimet e Monitorimit dhe Koordinimit.

Lista e përdoruesve të përjashtuar për Koncesionarin dhe Shoqërinë Koncesionare:

1. Automjetet e personelit të ngarkuar me Shërbimet e Mirëmbajtjes dhe të Operimit.

SHTOJCA 4

Pagesat e Autoritetit Kontraktor gjatë Periudhës së Garancisë.

Tabela e mëposhtme tregon të Ardhurat Bazë (Ab), të cilat kanë kuptimin e të ardhurave të cilat e lejojnë projektin të ketë një rrjedhë paraje pozitive dhe të qëndrueshme.

Në rast se për periudhën e parë-vjeçare gjatë Periudhës së Operimit dhe të Mirëmbajtjes, (“Periudha e Garancisë”) do të ketë rënie të nivelit të të Ardhurave Bazë, nën vlerat e treguara në kolonën me emërtesën “Të ardhurat bazë”, përkatësisht pasqyruar për çdo vit në tabelën e mëposhtme nga viti deri në vitin e-të, Autoriteti Kontraktor aplikon garanci trafiku sipas specifikimeve të bëra në kolonën kolonën “Garancia” (G) nëpërmjet Pagesave për Rakordim të Deficitit të të Ardhurave, që Autoriteti Kontraktor mund t’i bëjë Shoqërisë Koncesionare për çdo Vit të Kontratës përgjatë Periudhës së Garancisë.

Vlerat janë me milion Euro dhe janë pa TVSH.

Nr.	Viti (V)	Te Ardhurat Baze (Ab)	Garancia (G)
Periudha e plotësimit të kushteve paraprake dhe Periudha e Ndërtimit			
1.	1.		
Periudha e ndërtimit			
2.	2.		
3.	3.		
4.	4.		
Periudha e Operimit dhe Mirëmbajtjes			
5.	5.		
6.	6.		
7.	7.		
8.	8.		
9.	9.		
10.	10.		
11.	11.		
12.	12.		
13.	13.		
14.	14.		
15.	15.		
16.	16.		
17.	17.		
18.	18.		
19.	19.		
20.	20.		
21.	21.		
22.	22.		
23.	23.		
24.	24.		

25.	25.		
26.	26.		
27.	27.		
28.	28.		
29.	29.		
30.	30.		
31.	31.		
32.	32.		
33.	33.		
34.	34.		
35.	35.		

DRAFT

SHTOJCA 4/1

Pagesat e Suficitit të të Ardhurave nga Shoqëria Koncesionare.

Në rast se Shoqëria Koncesionare gjatë Periudhës së Operimit do të ketë tejkalim të nivelit të shumave të Të Ardhurave Bazë përkatësisht pasqyruar për çdo vit të Periudhës së Operimit në tabelën e mëposhtme, Shoqëria Koncesionare do t'i paguajë Autoritetit Kontraktor Pagesë të Suficitit të të Ardhurave, që është pagesa që Shoqëria Koncesionare mund t'i bëjë për çdo Vit Autoritetit Kontraktor gjatë Periudhës së Operimit, nëqoftëse tejkalohen Të Ardhurat Bazë, dhe e barabartë me vlerën që del nga aplikimi i formulës si vijon: diferenca që del nga Të Ardhurat nga Tarifa të arkëtuara për atë Vit minus Të Ardhurat Bazë të parashikuara për të njëjtin Vit, e shumëzuar me (..... përqind).

Për të shmangur çdo keqkuptim, nëse Të Ardhurat nga Tarifa janë të barazvlefshme me Të Ardhurat Bazë, apo nëse diferenca që del nga Të Ardhurat nga Tarifa minus Të Ardhurat Bazë është një numër negativ, Shoqëria Koncesionare nuk do të bëjë asnjë Pagesë të Suficitit të të Ardhurave.

Tabela e mëposhtme tregon nivelin e shumave të Të Ardhurave Bazë tejkalimi i të cilave sjell aplikimin e Pagesës së Suficitit të të Ardhurave të Shoqërisë Koncesionare ndaj Autoritetit Kontraktor sipas formulës së mësipërme.

Nr.	Viti (V)	Të ardhurat bazë (Ab)
Periudha e plotësimit të kushteve paraprake dhe Periudha e Ndërtimit		
1.	Viti i parë	
2.	Viti i dytë	
3.	Viti i tretë	
Periudha e Operimit dhe Mirëmbajtjes		
1.		
2.		
3.		
4.		
5.		
6.		
7.		
8.		
9.		
10.		
11.		
12.		
13.		
14.		
15.		
16.		
17.		
18.		
19.		
20.		
21.		

22.		
23.		
24.		
25.		
26.		
27.		
28.		
29.		
30.		
31.		
32.		

Vlerat janë në monedhën Euro dhe janë pa TVSH.

DRAFT

SHTOJCA 5

Detyrat Kryesore të Inxhinierit të Pavarur

Roli i Inxhinierit të pavarur

Inxhinieri i pavarur (IP) kontraktohet nga Autoriteti Kontraktor (AK) për të menaxhuar dhe përmirësuar aspekte të Kontratës së Koncesionit, kryesisht në lidhje me verifikimin e përmbushjes nga Shoqëria Koncesionare të kërkesave teknike, ekonomiko- financiare dhe ligjore të Autoritetit Kontraktor.

Në përgjithësi, roli i Inxhinierit të Pavarur duhet të zgjerohet për të mbuluar funksione për cilat Autoriteti Kontraktor nuk është plotësisht i pajisur.

Inxhinierit të Pavarur konsulent i kërkohet të ofrojë ekspertizë në të gjitha aspektet e koncesionit në përputhje me dispozitat e Kontratës. Për këtë arsye dhe në mbështetje të funksioneve që duhet të kryejë Inxhinieri i Pavarur duhet të sigurojë personel të mjaftueshëm, i cili duhet të zotërojë njohuritë e duhura të fushës. Personeli i Inxhinierit të Pavarur duhet të përfshijë por pa u kufizuar specialitetet e mëposhtme:

- Drejtues Projekti
- Kryeinxhinier
- Inxhinier të kontrollit të cilësisë
- Inxhinier të materialeve
- Inxhinier Gjeolog
- Inxhinier gjeoteknik
- Inxhinier strukturist
- Inxhinier për sinjalistikën, trafikun dhe mbrojtjen e sigurisë
- Inxhinier mjedisor
- Specialist informatike (IT)
- Inspektor
- Inxhinier Gjeodet
- Inxhinier terreni
- Ekonomist
- Jurist

Roli i Inxhinierit të Pavarur është certifikimi i pavarur i punës konform kërkesave dhe që çdo punë bëhet nëpërmjet sigurimit të cilësisë/kontrollit të cilësisë të Shoqërisë Koncesionare, sic mund të jetë e nevojshme herë pas here, në përputhje me udhëzimet e Autoritetit Kontraktor për të konfirmuar dhe/ose korrigjuar ecurinë.

Inxhinieri i Pavarur mbikëqyr dhe kontrollon, nëpërmjet Sistemeve të veta të Cilësisë, ecurinë e Shoqërisë Koncesionare. Inxhinieri i Pavarur kryen auditim të kontrollit të cilësisë sipas nevojës (në bazë të variancës statistikore të ecurisë së Shoqërisë Koncesionare), për të konfirmuar dhe certifikuar përputhshmërinë me Standardet.

Nëse certifikata e Inxhinierit të Pavarur thotë se ka mosplotësim për punën e Shoqërisë Koncesionare, atëherë Sistemet e Cilësisë të Shoqërisë Koncesionare duhet të diktojnë që puna të korrigjohet/përsëritet.

Më me hollësi, Inxhinieri i Pavarur ndërmerr funksionet e mëposhtme:

I. Funksione të përgjithshme

1. Kryen kontrolle të përgjithshme, auditon dhe asiston në prova ose hetime në lidhje me Punimet ose Shërbimet, duke pasur në çdo moment liri të pakufizuar për të hyrë në çdo territor ose punishte ku prodhohen materiale, në varësi të ndjekjes së të gjitha procedurave përkatëse të sigurisë;

2. Mbikëqyr në aspektin teknik, ekonomiko-financiare dhe ligjore plotësimin nga Shoqëria Koncesionare të dispozitave të Kontratës së Koncesionit, me përshtatjet përkatëse që lejon Kontrata, dhe informon menjëherë Autoritetin Kontraktor dhe Shoqërinë Koncesionare nëse konstatohet mosplotësim;

3. Ka liri të pakufizuar hyrjeje në Territorin e Projektit në çdo moment të arsyeshëm gjatë të gjithë Periudhës së Kontratës në mënyrë që të kryejë funksionet e tij;

4. Ka të drejtë të hyjë në çdo pronë, që përdor Shoqëria Koncesionare për realizimin e Punimeve dhe Shërbimeve, për të kontrolluar ndërtimin, rehabilitimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Projektit dhe për të ndjekur plotësimin e detyrimeve nga Shoqëria Koncesionare;

5. Ka të drejtë të hyjë në çdo moment në çdo pronë të përdorur nga Shoqëria Koncesionare si objekt trajnimi ose punishte dhe në vendet ku përgatitet puna ose nxirren materialet për Projektin, për të ndjekur plotësimin e detyrimeve nga Shoqëria Koncesionare;

6. Ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet ku diskutohet ecuria mujore ose me shpeshtësi tjetër në lidhje me Punimet dhe/ose Shërbimet dhe të marrë njoftim në kohën e duhur për këto mbledhje nga Shoqëria Koncesionare;

7. Ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë kopje të të gjitha skicave, lidhjeve, specifikimeve dhe shtojcave, pas çdo modifikimi që u bën Shoqëria Koncesionare;

8. Vepron në përputhje me KREU 5Neni 47 dhe KREU 5Neni 48 të Kontratës për eliminimin e Defektit të Shoqërisë Koncesionare.

9. Ka të drejtë t'i kërkojë Shoqërisë Koncesionare të largojë nga Territori i Projektit çdo agjent ose punëmarrës të Shoqërisë Koncesionare ose çdo Nënkontraktor të cilitdo nivel, sipas rastit, që, sipas mendimit të Inxhinierit të Pavarur, bën shkelje ose është i paaftë ose tregon pakujdesi në kryerjen siç duhet të detyrave në lidhje me Projektin, ose prania e të cilëve konsiderohet e padëshirueshme në Territorin e Projektit;

10. Konsultohet me Palët për çdo çështje që ka të bëjë me Punimet dhe Shërbimet;

11. I jep raporte ose informacione Autoritetit Kontraktor dhe Shoqërisë Koncesionare kur kjo parashikohet nga Kontrata;

12. Shqyrton shfuqizimin ose ndryshimin me ndikim negativ të të gjithave ose disave prej Dokumenteve të Projektit dhe jep kundërshtimin e vet për këtë nëse është nevoja;

13. Sa herë i kërkohet të japë vendim, opinion ose pëlqim apo të shprehë bindjen ose aprovimin e tij ose të kryerje veprime të tjera që mund të prekin të drejtat dhe detyrimet e Palëve të përfshira ("**Konstatim**"), nëse nuk parashikohet ndryshe, Inxhinieri i Pavarur e bën këtë

Konstatim sapo ta ketë të mundur dhe në çdo rast brenda afatit të parashikuar në Kontratën e Koncesionit dhe/ose në kërkesat e Autoritetit Kontraktor dhe/ose Shoqërisë Koncesionare sipas çështjes në fjalë dhe i komunikon komentet që mund të ketë në lidhje me këtë Konstatim brenda afatit përkatës;

14. Jep vlerësim mospranues për raportet që janë mbështetur në informacione ose të dhëna të gabuara ose që nuk janë në përputhje me këtë Kontratë;

15. Ka të drejtë të shikojë, auditojë dhe marrë kopje të evidencave të Shoqërisë Koncesionare në çdo moment;

16. Ndryshon adresën pasi i ka njoftuar Palët e përfshira.

II. Funksione të veçanta në lidhje me aspektet e kërkesave të Autoritetit Kontraktor dhe Kontratën e Koncesionit:

Sistemi i menaxhimit të cilësisë

1. Aprovon dhe jep komente për manualin e kontrollit të cilësisë për ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen.

2. Mbikëqyr dhe auditon Sistemin e menaxhimit të Cilësisë të Shoqërisë Koncesionare dhe planet e lidhura të cilësisë, përfshirë edhe ato të projektuesve, Nënkontraktorëve dhe furnitorëve të tij, në intervalet që i konsideron të arsyeshme Inxhinieri i Pavarur.

3. Shqyrton dokumentacionin e cilësisë në përputhje me standardin e kërkuar.

4. Aprovon dhe komenton për Sistemet përkatëse të Cilësisë të hartuara nga Shoqëria Koncesionare përpara fillimit të çdo pjese të Punimeve ose Shërbimeve dhe përditësimet e tyre sipas dispozitave të Kontratës gjatë Kohëzgjatjes së Kontratës.

5. Merr pjesë në kontrollet zyrtare dhe të parashikuara me grafik të niveleve të shërbimit që zhvillohen dhe që realizohen nga Njësia e Zbatimit të Projektit.

Operimi dhe Mirëmbajtja e Rrugës

1. Aprovon dhe jep komente për projekt-versionin e hollësishëm të:

- manualit të kontrollit të cilësisë për operimin dhe mirëmbajtjen,
- manualit të mbrojtjes së shëndetit dhe jetës për operimin dhe mirëmbajtjen,
- manualit të operimit dhe mirëmbajtjes, dhe planet e operimit dhe te mirembajtjes,
- manualit ose manualeve të kontrollit dhe monitorimit,
- Planit të Menaxhimit Mjedisor.

2. Merr kopje të konfirmimit të pëlqimit të Autoritetit Përkatës të autostradës që Shoqëria Koncesionare të përdorë një rrugë devijimi në oraret dhe datat e propozuara për shkak të mbylljes së Rrugës.

3. Miraton (së bashku me policinë) gamën e shërbimeve në rast aksidenti.

4. Aprovon ose komenton për Planin në kundërpërgjigje të Ngjarjeve të Forcës Madhore ose situata të tjera të rënda.

5. Merr raportet dhe evidencat e Shoqërisë Koncesionare për Ngjarjet e Forcës Madhore ose situatave të tjera të rënda.

6. Konsultohet me Shoqërinë Koncesionare në lidhje me zgjidhjen përfundimtare të Ngjarjeve të Forcës Madhore ose situata të tjera të rënda, në varësi të llojit të tyre.

7. Aprovon projekt-versionin e hollësishëm, versionin përfundimtar dhe përditësimet e përvitshme të Planit të Mirëmbajtjes gjatë dimrit të Shoqërisë Koncesionare si dhe Planin e Operimit nga Enti Përgjegjës i Operimit.

8. Bie dakord dhe jep aprovimin për shfrytëzimin e teknologjive të ngjashme ose të përmirësuara që duhen përdorur për matjen gjeodezike të Rrugës.

9. Merr raporte tremujore nga Shoqëria Koncesionare ku përshkruhen me hollësi punimet e realizuara në tremujorin e fundit dhe programet e mirëmbajtjes që propozohen për të ardhmen.

10. Bie dakord për mënyrën e raportimit të parametrave të gjendjes së shtresave të rrugës.

11. Këshillon për hetimet shtesë që duhen kryer në lidhje me kushtet ekzistuese gjeoteknike dhe rreziqet urgjente të mundshme.

12. Identifikon bashkërisht me Shoqërinë Koncesionare riparimet e perhershme të kanaleve kulluese që duhen kryer nën përgjegjësinë e Autoritetit Kontraktor përpara stinës së ardhshme të shirave.

13. Aprovon kohën shtesë të nevojshme për riparimet strukturore sipas justifikimit të Shoqërisë Koncesionare.

14. Aprovon ndryshimet që i bëhen programit të mirëmbajtjes parandaluese të Shoqërisë Koncesionare në rast se nuk arrihen objektivat e parashikuara.

15. Shqyrton dhe aprovon justifikimin e paraqitur nga Shoqëria Koncesionare për devijimin nga afatet e kundërpërgjegjjeve për shkak të kushteve të ashpra të motit.

Sistemet e kontrollit, monitorimit dhe menaxhimit

1. Këshillon për kohën e lejuar për riparimet e defekteve në rastet kur këto riparime janë të nevojshme dhe nuk mund të përfundohen brenda afatit kohor të dakordësuar të Palëve.

2. Jep këshilla dhe orientime për kontrollet e strukturave në lidhje me përmbushjen e standardeve të Praktikës së Mirë të Industrisë, si edhe sistemin e menaxhimit të strukturave.

3. Aprovon projekt-propozimin e hollësishëm për zhvillimin dhe shfrytëzimin e sistemeve të menaxhimit të inventarit dhe infrastrukturës.

4. Aprovon/konfirmon demonstrimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit të inventarit dhe infrastrukturës.

5. Aprovon programin e kontroll – monitorimit për vitin e ardhshëm

Punimet Kapitale dhe Riparimet Kapitale

1. Bashkërendon dhe mbikëqyr Punimet Kapitale dhe/ose Riparimet Kapitale, që merr përsipër Autoriteti Kontraktor dhe/ose nënkontraktori i Autoritetit Kontraktor gjatë Periudhës së Koncesionit, të cilave duhet t'u bëjë vend Shoqëria Koncesionare.

2. Jep rekomandime (shitesë) për standardet e projektimit që duhen përdorur në propozimet e reja si edhe në përgatitjen e të gjitha projekteve kryesore përfundimtare të elementeve të Punimeve Kapitale nga Shoqëria Koncesionare.

3. Aprovon paketën e plotë të standardeve të projektimit për secilin element të Punimeve që ka përpiluar Shoqëria Koncesionare përpara fillimit të çdo projekti teknik kryesor përfundimtar.

4. Aprovon shmangiet nga standardet dhe normat e konfirmuara të projektimit, si edhe nga projektet paraprake dhe/ose të hollësishme, që mund të jenë me përfitim për Autoritetin Kontraktor dhe për Projektin sa i takon sigurisë rrugore, efikasitetit të shfrytëzimit, ekonomisë në ndërtim dhe mirëmbajtjes, programit të ndërtimit, jetëgjatësisë së përgjithshme, përmbushjes së standardeve të reja ndërkombëtare dhe të harmonizimit me BE, të industrisë, në përputhje me Kontratën.

5. Konfirmon miratimin e tij për propozim-projektin me shkrim me t'u arritur marrëveshja për këtë.

6. Shqyrton dhe aprovon shtesat dhe ndryshimet në propozim-projektin e pranuar të paraqitura nga Shoqëria Koncesionare si shtojca përpara fillimit të punës për aspektet e Punimeve që preken nga shtojca në fjalë.

7. Kontrollon efektin që kanë objektet e përkohshme tek struktura e përhershme (por nuk kontrollon objektet e përkohshme).

8. Shqyrton dhe pranon (ose refuzon) projektin e plotë përfundimtar për elementet e Punimeve Kapitale që duhet të përfshijnë evidencat të plota të projektit të aprovuar.

9. Kërkon dhe përdor manualin e projektimit si tekst të plotë mbështetës dhe dokument efikas pune.

10. Komenton dhe aprovon programin e punës për projektet teknike të paraqitura nga Shoqëria Koncesionare për të gjitha elementet që përbëjnë Punimet kapitale.

11. Shqyrton propozim-projektet e paraqitura, në konsultim me Autoritetin Kontraktor. Pas përfundimit të shqyrtimit, Inxhinieri i Pavarur:

- aprovon materialin e paraqitur,
- jep aprovim të kushtëzuar që kërkon bërjen dhe përfshirjen e rishikimeve në skicat e punës, ose
- refuzon pjesërisht ose plotësisht materialin nëse konstaton se projekti teknik nuk i përmbush kërkesat teknike të Autoritetit Kontraktor dhe/ose kriteret e projektimit të parashikuara në Kontratë ose Ligj.

12. Shqyrton skicat teknike të punës të paraqitura. Pas përfundimit të shqyrtimit, Inxhinieri i Pavarur:

- aprovon materialin e paraqitur,
- refuzon pjesërisht ose plotësisht materialin nëse konstaton se projekti teknik nuk i përmbush kërkesat teknike të Autoritetit Kontraktor dhe/ose kriteret e projektimit ose me komentet e bëra nga Inxhinieri i Pavarur si pjesë e aprovimit të kushtëzuar të propozim-projektit.

13. Monitoron Punimet në përputhje me Kontratën e Koncesionit.

14. Aprovon shmangien nga standardet dhe normat në lidhje me specifikimet teknike që është me përfitim për Autoritetin Kontraktor sa i takon sigurisë rrugore, efikasitetit të shfrytëzimit dhe jetëgjatësisë.

15. Merr dhe aprovon planin për menaxhimin e ndërtimit të Punëve Kapitale për të gjitha aspektet e Punimeve Kapitale.

16. Aprovon programin e hollësishëm për projektimin dhe ndërtimin e Punimeve për çdo aspekt të Punimeve Kapitale të paraqitur nga Shoqëria Koncesionare.

17. Aprovon raportet mujore të ecures dhe përditësimet e programit sipas kërkesave.

18. Merr pjesë në procesin vjetor të konsultimeve dhe aprovimeve në lidhje me realizimin e Punimeve Kapitale në bazë të datave të paracaktuara të fillimit dhe përfundimit (ose datave të kushtëzuara të fillimit dhe data përkatëse të përfundimit, sipas rastit).

Menaxhimi dhe vlerësimi i ecures

1. Monitoron dhe raporton për ecurinë e Shoqërisë Koncesionare kundrejt kërkesave kontraktore në bazë të Relacioneve mujore/Relacioneve vjetore të ecures, Manualit të operimit dhe Mirëmbajtjes, planit të ndërtimit të Rrugës, Sistemeve të Cilësisë dhe Planit të Menaxhimit Mjedisor që japin informacionet e nevojshme për drejtimin.

2. Ndërmerr auditime të Sistemeve të Cilësisë dhe disa auditime teknike të punimeve faktike.

3. Ndërmerr auditime teknike të Shërbimeve dhe Punimeve të monitoruara nga Njësia e dedikuar e kontrollit të cilësisë e Shoqërisë Koncesionare.

4. Ka të drejtë të rrisë, me shpenzimet e Shoqërisë Koncesionare, nivelin ose shpeshtësinë e monitorimit, auditimit, testimit dhe inspektimit të rrugës dhe respektimit nga Shoqëria Koncesionare të detyrimeve të veta në bazë të kësaj Kontrate, në atë nivel që Autoriteti Kontraktor ose Inxhinieri i pavarur e konsideron të përshtatshëm, sipas Kontratës së Koncesionit.

Kthimi

1. Mund të udhëzohet nga Autoriteti Kontraktor të kryejë një inspektim të Rrugës për të konstatuar nëse Shoqëria Koncesionare po i përmbush apo jo kërkesat e kësaj Kontrate dhe në veçanti nëse do të përmbushen kërkesat për kthimin brenda Datës së Përfundimit të Kontratës.

2. Shqyrton dhe aprovon planin e vlerësimit për kthimin përpara fillimit të çdo pune nga Shoqëria Koncesionare.

3. Konsultohet me Shoqërinë Koncesionare në lidhje me përditësimin e planit të vlerësimit përkthimin sipas nevojës për të reflektuar ndryshimet e kushteve të aktiveve të projektit ose të metodikës së vlerësimit të përcaktuara pas inspektimit të Rrugës nga Autoriteti Kontraktor ose nga personi i caktuar prej tij.

4. Shqyrton dhe aprovon procedurat e hollësishme të testimit dhe inspektimit në përputhje me kërkesat e Kontratës.

5. Bashkërendon me Shoqërinë Koncesionare të gjitha aspektet e planit të punimeve rinovuese për kthimin.

6. Merr në dorëzim dokumentacionin nga Shoqëria Koncesionare ku bëhet e ditur se Shoqëria Koncesionare i ka përmbushur udhëzimet dhe i ka përmbushur dhe përfunduar detyrimet për çdo ndreqje siç e kërkon Ligji në lidhje me ato fusha ku është dashur të merren masa ndreqëse për shkak kontaminimi apo derdhjeje lënde djegëse.

7. I asiston Shoqërisë Koncesionare në kryerjen e vrojtimit përfundimtar për kthimin në mënyrë që të përcaktohen se çfarë punimesh ndreqëse kanë mbetur pa u bërë.

Detyra të tjera:

- b) 1. Certifikon që Trualli Shtesë dhe/ose Trualli Ekstra kërkohet nga Shoqëria Koncesionare për realizimin e detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate.
2. Aprovon dhe komenton programin fillestar të Punimeve të Shoqërisë Koncesionare (ose shtesat dhe ndryshimet në të).
3. Kryen procedurën e dorëzimit teknik pas përfundimit paraprak.
4. Kontrollon dhe vërteton se janë përfunduar Punimet e nevojshme për shfrytëzimin pa rrezik të Rugës.
5. Vlerëson rezultatin e procedurës së dorëzimit teknik dhe konstaton nëse Shoqëria Koncesionare i ka përmbushur të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktor për Punimet sipas Projekt Zbatimit, ose informon Shoqërinë Koncesionare për çdo kundërshtim.
6. Konsulton Shoqërinë Koncesionare me qëllim arritjen e një marrëveshjeje për masat që kërkohet të merren në mënyrë që të arrihet përmbushja e kërkesave të Autoritetit Kontraktor sipas Projekt Zbatimit në rast se ka kundërshtim.
7. Kryen procedurën e dorëzimit teknik pas përfundimit përfundimtar.
8. Kontrollon dhe vërteton se Punimet janë përfunduar dhe janë përmbushur plotësisht.
9. Përcakton se çfarë shtesash dhe ndryshimesh duhen bërë në Manualët e operimit dhe Mirëmbajtjes në rast se Palët nuk merren vesh për shtesat dhe ndryshimet e duhura.
10. Përcakton shtesat dhe ndryshimet e duhura në Programin e Riparimeve Kapitale në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe Shoqërisë Koncesionare.
11. Konstaton nëse ka ndodhur ndonjë defekt, shkelje dhe/ose mosplotësim dhe afatin e ndreqjes në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe Shoqërisë Koncesionare në lidhje me defektet e identifikuar dhe të nevojshme për t'u ndrequr.
12. Vendos për Truall Shtesë alternativ të ngjashëm nëse Autoriteti Kontraktor dhe Shoqëria Koncesionare nuk mund të merren vesh.
13. Informohet dhe vepron sipas nevojës në përputhje me Kontratën e Koncesionit sa u takon Shkaqeve të Lehtësimit si dhe kompensimit përkatës.
14. Vlerëson dëshmitë që jep Shoqëria Koncesionare sa u takon Shkaqeve të Lehtësimit si dhe kompensimit përkatës.
15. Informohet dhe vepron sipas nevojës në përputhje me Kontratën e Koncesionit sa u takon Shkaqeve të Lehtësimit nga detyrimi si dhe kompensimit përkatës.
16. Informohet dhe vepron sipas nevojës në përputhje me Kontratën e Koncesionit sa u takon ngjarjeve të forcës madhore.

17. Vlerëson dëshmitë që jep Shoqëria Koncesionare sa u takon Ngjarjeve të Forcës Madhore.

18. Njoftohet me shkrim për pasojat e mundshme të një Ndryshimi Cilësues të Ligjit që është bërë ose do të bëhet shumë shpejt.

19. Njoftohet për vonesë të panevojshme për kërkesën e Shoqërisë Koncesionare për të marrë përfitime pas hyrjes në fuqi të Ndryshimit Cilësues të ligjit.

20. I vihet në dispozicion një shpjegim i plotë dhe i hollësishëm dhe dëshmi në lidhje me Ndryshimin Cilësues të Ligjit dhe përfitimet e kërkuara, kohëzgjatjen e çmuar të vonesës në fjalë, çdo informacion përkatës që ka të bëjë me Ndryshimin Cilësues të Ligjit dhe humbjen e pritur të të ardhurave ose rritjen e kostove që vjen nga Ndryshimi Cilësues i Ligjit.

21. Ofron marrje vendimi në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe Shoqërisë Koncesionare në lidhje me një Ndryshim të Shoqërisë Koncesionare të kërkuar në përputhje me parashikimet te Neni 50 (*Ndryshime të kërkuara nga Shoqëria Koncesionare*) të Kontratës së Koncesionit

22. Jep opinion për arsyeshmërinë e propozimeve të Autoritetit Kontraktor në Njoftimin për Ndryshim në përputhje me parashikimet te Neni 49 (*Ndryshime të kërkuara nga Autoritetit Kontraktor*) të Kontratës së Koncesionit.

23. Jep opinion për pretendimet e Nënkontraktorëve dhe çdo dokument që lidhet me to.

24. Ofron opinion nëse i kërkohet nga Shoqëria Koncesionare për zbatimin e rehabilitimeve të parashikuara.

25. Realizon funksione të tjera të parashikuara nga Kontrata e Koncesionit.

SHTOJCA 6

Pasqyra e Aktiviteteve të Shërbimit të Mirëmbajtjes

Manuali i Mirëmbajtjes përfshindhe pasqyrën e aktiviteteve të mëposhtme:

Nr .	Emërtimi i Procesit	Periodha në të cilën aplikohet mirëmbajtja dhe riparimi	Afati kohor për evidentimin dhe koha e nevojshme ndërhyrjen	Volumi i kryer në njësinë kohës	Koeficienti për çdo (orë vonesë nëse veprimi kërkohet me orë, dhe ditë nëse veprimi kërkohet me ditë, dhe muaj nëse veprimi kërkohet në muaj) vonesë.
I	Aktivitete të Planit Operacional të Mirëmbajtjes				
a	Plani operacional i mirëmbajtjes dhe disponueshmerisë	Përmirësohet çdo vit	2 javë	1	
b	Plani i sigurimit të cilësisë	Përmirësohet çdo vit	2 javë	1	
c	Plani i Menaxhimit Mjedisor	Përmirësohet çdo vit	2 javë	1	
d	Manual i mbrojtjes së jetës dhe shëndetit	Përmirësohet çdo vit	2 javë	1	
II	Aktivitete të mirëmbajtjes rutinë				
a	Kositjet anësore të vegjetacionit të rrugës	Aktivitete të përgjithshme të planifikuara por jo më pak se 1 herë në vit.	Evidentimi - ____ orë Ndërhyrja – ____ orë	Sipas rastit deri në ____ km	3% të shumës ditore për 1 km. Të aplikohet në çdo km të seksionit i cili nuk plotëson përputhshmëri në.
b	Pastrimet horizontale dhe vertikale të vegjetacionit	Aktivitete të përgjithshme të planifikuara por jo më pak se 1 herë në vit.	Evidentimi - ____ orë Ndërhyrja – ____ orë	Sipas rastit deri në ____ km	3% të shumës ditore për 1 km. Të aplikohet në çdo km të seksionit i cili nuk plotëson përputhshmëri në.

c	Mirëmbajtja e bankinave dhe e kanaleve të kullimit, riparime dhe pastrime nga mbetjet inerte dhe mbeturinat	Aktivitete të përgjithshme të planifikuara sipas nevojës	Evidentimi - ____ orë Ndërhyrja – ____ orë	Sipas rastit deri në ____ml	2% të shumës ditore për 1 km të aplikohet në çdo km të seksionit i cili nuk plotëson përputhshmeri në
d	Pastrimet nga dëbora dhe ngrica, hedhje skorje dhe largim mbetjesh të ngurta	Aktivitete të përgjithshme të planifikuara gjatë reshjeve dhe ngricave	Evidentimi - ____ orë Ndërhyrja – ____ orë	E gjithë rruga	3% të shumës ditore për 1 km. Të aplikohet në çdo km të seksionit i cili nuk plotëson përputhshmëri në.
e	Mirëmbajtja e sinjalistikës rrugore, dëmtimet e tabelave, guardreil, vijëzimet	Aktivitete të përgjithshme të planifikuara sipas nevojës. Zëvendësimi i sinjalistikës vertikale dhe guardreleve është domosdoshmëri që pas kontrollit vizual të zëvendësohet brenda 24 orëve.	Evidentimi - ____ orë Ndërhyrja – ____ orë		2% të shumës ditore për 1 km të aplikohet në çdo km të seksionit i cili nuk plotëson përputhshmeri në.
f	Pastrimi i sipërfaqeve asfaltike nga mbetjet inerte kafshët e ngordhura, aksidentet etj	Aktivitete të përgjithshme të planifikuara 2 herë në vit	Evidentimi - ____ orë Ndërhyrja – ____ orë	E gjithë rruga	3% të shumës ditore për 1 km. Të aplikohet në çdo km të seksionit i cili nuk plotëson përputhshmëri në.
g	Inspektim dhe monitorim i urave dhe mbikalimeve për Soletat Fugat e diletacionit Traret Elastomeret Pilat – shpatullat	Aktivitete të përgjithshme të planifikuara 2 herë në vit	Evidentimi - ____ orë Ndërhyrja – ____ orë	E gjithë vepra	

	Erozioni i shpatullave				
III	Aktivitete të Riparimeve Periodike				
a	SIPERFAQET E PJERRËTA				
	Mirëmbajtja e rrëshqitjeve vogla	Detyrë mujore dhe riparimi i tyre në kuadrin e mirëmbajtjes rutinë pasi janë rrëshqitje të vogla	Evidentimi - ____ orë Ndërhyrja – ____ orë	1000 m2	
	Mirëmbajtja nga erozioni	Sa herë është e domosdoshme por jo më pak se 1 herë në vit.	Evidentimi - ____ orë Ndërhyrja – ____ orë	1000 m2	
	Mirëmbajtja e sipërfaqeve pjerrëta me gjeogride	Sa herë është e domosdoshme por jo më pak se 1 herë në 3 vite.	Evidentimi - ____ orë Ndërhyrja – ____ orë	100 m2	
b	TOMBINO DHE BOKSE				
	Inspektimi i tombinove dhe bokseve	1 herë në 3 vite inspektim mujor.	Evidentimi - ____ orë Ndërhyrja – ____ orë	1 Box/Tombino	
	Mirëmbajtja e tombinove dhe bokseve	Sipas nevojës Mirëmbajtje mujore, rutinë.	Evidentimi - ____ orë Ndërhyrja – ____ orë	1 Box/Tombino	
	MURET MBAJTËSE				
	Inspektim i mureve mbajtëse	1 herë në 1 vit	Inspektimi brenda ____ orëve	1 Mure	
	Mirëmbajtja e mureve mbajtëse	Sipas nevojës Detyrë mujore, rutinë.	Evidentimi - ____ orë Ndërhyrja – ____ orë	1 Mure	2% të shumës ditore për 1 km të aplikohet në çdo km të seksionit i cili nuk plotëson përputhshmëri në.
c	SHTRESAT RRUGORE ASFALTIKE				

	Valëzimet gjatësore të asfaltit	Aktivitete të përgjithshme sipas nevojës dhe ato të planifikuara 1 herë në vit	Evidentimi - ____ orë Ndërhyrja – ____ orë	100 ml valëzim	2.5% të shumës ditore për 1 km të aplikohet në çdo km të seksionit i cili nuk plotëson përputhshmëri në.
	Izolimi dhe mbushja e çarjeve	Aktivitete të përgjithshme të planifikuara 1 herë në vit	Evidentimi - ____ orë Ndërhyrja – ____ orë	100 ml çarje	2.5% të shumës ditore për 1 km të aplikohet në çdo km të seksionit i cili nuk plotëson përputhshmëri në.
	Rrudhosjet e asfaltit	Aktivitete të përgjithshme të planifikuara 1 herë në vit	Evidentimi - ____ orë Ndërhyrja – ____ orë	200 m2 zonë e rrudhosur	2.5% të shumës ditore për 1 km të aplikohet në çdo km të seksionit i cili nuk plotëson përputhshmëri në.
	Gropat në trupin e rrugës dhe dëmtime në skaje të shtresës asfaltike	Aktivitete të përgjithshme të planifikuara 1 herë në vit	Evidentimi - ____ orë Ndërhyrja – ____ orë	50 m2 gropa	2.5% të shumës ditore për 1 km të aplikohet në çdo km të seksionit i cili nuk plotëson përputhshmëri në.
	Riparim i sipërfaqeve asfaltike mbi ura	Aktivitete të përgjithshme të planifikuara 1 herë në vit	Evidentimi - ____ orë Ndërhyrja – ____ orë	100 m2 gropa	2.5% të shumës ditore për 1 km të aplikohet në çdo km të seksionit i cili nuk plotëson përputhshmëri në.
d	URAT DHE MBIKALIMET				
	Riparimi i soletave beton / armë	1 herë në 1 vit	Evidentimi - ____ orë Ndërhyrja – ____ orë	1 riparim	2.5% të shumës ditore për 1 km të aplikohet

					në çdo km të seksionit i cili nuk plotëson përputhshmeri në.
	Riparimi / Zëvendësimi i fugave	1 herë në 1 vit	Evidentimi - ____ orë Ndërhyrja - ____ orë	1 karrexhatë	2.5% të shumës ditore për 1 km të aplikohet në çdo km të seksionit i cili nuk plotëson përputhshmeri në.
	Riparimi i trareve të betonit	1 herë në 1 vit	Evidentimi - ____ orë Ndërhyrja - ____ orë	1 riparim	2.5% të shumës ditore për 1 km të aplikohet në çdo km të seksionit i cili nuk plotëson përputhshmeri në.
	Riparimi / zëvendësimi i mbështetjeve (elastomerët)	1 herë në 1 vit	Evidentimi - ____ orë Ndërhyrja - ____ orë	1 mbështetje	2.5% të shumës ditore për 1 km të aplikohet në çdo km të seksionit i cili nuk plotëson përputhshmeri në.
	Riparimi i n/strukturës	1 herë në 1 vit	Evidentimi - ____ orë Ndërhyrja - ____ orë	1 riparim	2.5% të shumës ditore për 1 km të aplikohet në çdo km të seksionit i cili nuk plotëson përputhshmeri në.
e	GUARDRAIL				
	Riparim/Zëvendësim i vijëzimeve	Sipas nevojave	Evidentimi - ____ orë Ndërhyrja - ____ orë	1 km	2.5% të shumës ditore për 1 km të aplikohet në çdo km të seksionit i cili nuk plotëson përputhshmeri në.

					në.
	Riparim/Zëvendësim i guardreil	Sipas nevojave	Evidentimi - ____ orë Ndërhyrja – ____ orë	100 ml	2.5% të shumës ditore për 1 km të aplikohet në çdo km të seksionit i cili nuk plotëson përputhshmeri në.

Shkeljet bazë mbi të cilat do të përlogariten penalitetet për çdo njësi vonese në kryerjen e shërbimeve dhe/ose punimeve të aplikueshme nga Autoriteti Kontraktor do të jenë në masën 1,000.00 (një mijë) Lekë/Ditë për çdo Km, i cili shumëzohet me koeficientin e shprehur në përqindje në kolonën përkatëse, si më sipër:

Penaliteti për vonesat, në rast të shkeljeve të mësipërme, do të përlogariten e aplikohen nga Autoriteti Kontraktor në 6 mujorin e dytë të shkeljeve të vazhdueshme, dhe pasi të jenë vlerësuar si shkelje nga Inxhinieri i Pavarur.

SHTOJCA 7

Informacioni i kërkuar rreth Koncesionarit

DRAFT

SHTOJCA 8

Dokumentacioni i Ofertës

DRAFT

SHTOJCA 9

Të Dhënat e Vëna në Dispozicion nga Autoriteti Kontraktor

DRAFT

SHTOJCA 10

Projekt-Ideja, skicat, planimetritë dhe Grafiku i Punimeve

DRAFT

SHTOJCA 11

Territori i Projektit

DRAFT

SHTOJCA 12

Garancia e Kontratës

DRAFT